


Prof.Dr.Hfz. Hajredin Hoxha

Kiraetet e Kur'anit

{ndërmjet pikëpamjes hebreje dhe islame
Abdul Fettah el Kadi dhe Ignaz Goldziheri sy më sy}



KIRAETET E KUR'ANIT

(ndërmjet pikëpamjes hebreje dhe islame
Abdul Fettah el Kadi dhe Ignaz Goldziheri sy më sy)

Prof. Dr. Hfz. Hajredin HOXHA

SHKUP

2022

Titulli në origjinal:

القراءات القرآنية بين النظرة اليهودية والإسلامية
الشيخ عبد الفتاح القاضي مع الأستاذ إغناز غولد تسيهر
وجهاً لوجه – دراسة تحليلية نقدية

*El-kiraât el-kur'anijeh bejne en-nadhreti
el-jehudijjeti ve el-islamijeh – Esh-Shejhu
Abdul Fettah El-Kadi mea el-Ustadh Ignaz
Goldziher vexhhen li-vexhh – Dirasetun
tahlilijjetun nakdijjeh*

Autor:

تأليف: أ.د. خيرالدين خوجة

Prof. Dr. Hfz. Hajredin Hoxha

Përkthyes:

Dr. Sedat Islami

Ligjërues në Fakultetin e Studimeve
Islame në Prishtinë

Lektore gjuhësore:

Ph.D. (C) Melihate ZEQIRI

Ligjëruese në Fakultetin e Studimeve
Islame në Prishtinë

Redaktor teknik:

Autori & Përkthyesi

Botues:

AUTORI

Tirazhi:

500 copë

Shtypi:

FOCUS PRINT - SHKUP

Shkup:

2022

Katalogizimi i librit gjendet në bibliotekën kombëtare në Shkup.
ISBN: ©Të gjitha të drejtat e botimit, ribotimit, përkthimit apo
shpërndarjes në çfarëdo formati qoftë, i takojnë vetëm autorit, përveç
në rastet kur individët ose institucionet përkatëse marrin leje me
shkrim nga autori.

<https://www.drhafezi.net/>

KIRAETET E KUR'ANIT

(ndërmjet pikëpamjes hebreje dhe islame)

Abdul Fettah el Kadi dhe Ignaz Goldziheri sy më sy

Prof. Dr. Hfz. Hajredin HOXHA

Ky punim është version i plotësuar i botimit paraprak. Me këto plotësime është botuar në revistën shkencore të Universitetit Islamik në Gazza të Palestinës.

IUG Journal of Islamic Studies (Islamic University of Gaza-Palestine) / CC BY 4.0

Përmbledhje

Studimi mëton të prezentojë dyshimet dhe gënjeshttrat më të spikatura, përkitazi me leximet dhe dialektet kur'anore të përmendura në parathënien e librit *Doktrinat e interpretimit Islam*, të orientalistit hungarez, profesorit Ignaz Goldziher, me përgjigjet dhe zhvlerësimin shkencor të tyre të bërë nga Hoxha Abdul Fettah el Kadi në librin *Leximet e Kur'anit nga perspektiva e orientalistëve dhe ateistëve*. Në trajtimin e këtyre dyshimeve dhe përgjigjeve përkitazi me to, autori ka ndjekur metodologjinë përshkruese, analitike dhe kritike. Problematika e studimit sillet rreth mohimit të shpalljes kur'anore dhe konsideratës se leximet e Kur'anit janë thjeshtë përzgjedhje e lirë personale, duke u thirrur kinse në natyrën e kaligrafisë arabe dhe lëshimet e lexuesve dhe shumëzuesve të mus'hafit dhe se kjo nuk ka lidhje me drejtësinë, besnikërinë dhe saktësinë e Sahabeve¹ -Zoti qoftë i kënaqur me ta!, - në pranimin dhe përcjelljen e leximeve me *tevatur*² tek brezat e mëvonshëm. Studimi ka vërtetuar se pretendimet e lartpërmendura, përkitazi me leximet e Kur'anit janë thjeshtë gënjeshttra dhe se Sahabet dhe Lexuesit³ e Kur'anit janë dalluar për drejtësi dhe besnikëri të rrallë. Po kështu, studimi ka argumentuar se si referencë për leximet e Kur'anit është shpallja hyjnore dhe mënyra e pranimit të tyre të drejtpërdrejtë nga Pejgamberi ﷺ dhe përcjelljes së tyre me

¹ Shokët e Pejgamberit Muhammed ﷺ. Të këtyllë konsiderohen vetëm ata që e kanë besuar dhe e kanë parë fizikisht Pejgamberin Muhammed ﷺ si dhe kanë vdekur myslimanë. Përkthyesi.

² *Tevatur* - përcjellje e vazhdueshme, e pashkëputur, konsekuente, e besueshme. Transmetimet e përcjella kësisoj kanë saktësinë më të madhe dhe nuk dyshohet në to. Përkthyesi.

³ Dijetarë, të cilëve iu referohet në leximet e Kur'anit. Në kapitullin e tretë, autori ofron një përmbledhje biografike të tyre. Përkthyesi.

përgjegjësinë dhe saktësinë më të madhe të mundshme tek të tjerët. Studimi përbëhet nga katër kapituj, të paraprirë me një parathënie dhe pasuar me një përmbyllje. Në kapitullin e parë flet për biografinë e dy personaliteteve bazë të studimit dhe veprimtarisë së tyre. Në kapitullin e dytë bëhet diagnostikimi dhe analizimi i llojit dhe natyrës së dyshimeve të hedhura përkitazi me leximet e Kur'anit. Kapitulli i tretë sjell kriteret që duhen përmbushur, që një lexim të jetë i saktë dhe korrekt. Po kështu ofrohen edhe biografi përmbledhëse të dhjetë lexuesve më të njohur të Kur'anit. Kapitulli i katërt dhe i fundit është rezervuar për zhvlerësimin shkencor të këtyre dyshimeve dhe konfirmimin se ato nuk janë gjë tjetër pos gënjeshtër e shpifje të pabaza. Fare në fund, bëhet përmbledhja e rezultateve më të spikatura dhe më të rëndësishme të studimit.

Fjalët kyçe: *leximet e Kur'anit, Ignaz Goldziher, Abdul Fettah el-Kadi, orientalistët, dyshimet.*

الملخص

تهدف هذه الدراسة إلى عرض أهم الشبهات والأكاذيب في حق القراءات القرآنية التي جاء ذكرها في مقدمة كتاب: (مذاهب التفسير الإسلامي) للمستشرق المجري / الهنغاري الأستاذ إغناز غولد تسيهر، مع ردود وتفنيذ الشيخ عبد الفتاح القاضي لها في كتابه (القراءات في نظر المستشرقين والملحدّين). سلك الباحث المنهج الوصفي التحليلي النقدي. تتمحور إشكالية هذه الدراسة حول إنكار الوحي القرآني المنزل واعتبار القراءات القرآنية وتنوعها ضرباً من الحرية والاختيار الشخصي المحض؛ بسبب طبيعة الخط العربي وسهو القراء والنسّاخ، ولا علاقة لصدق الصحابة - رضوان الله عليهم - ودقتهم وأمانتهم في تلقيها وروايتها بالتواتر إلى من بعدهم. أثبتت الدراسة بطلان هذه الشبهات والأكاذيب المنارة عن القراءات القرآنية مؤكدة عدالة الصحابة وأمانة القراء، وأن العمدة في القراءات القرآنية هو الوحي الإلهي المنزل والتلقي والسماع والمشاهدة والرواية الصحيحة المتواترة. اشتملت الدراسة على مقدمة وأربعة مباحث وخاتمة. المبحث الأول فيه ذكر لحياة كل من الشخصيتين وجهودهما. والمبحث الثاني جاء فيه نوع الشكوك والعبارات التشكيكية وطبيعتها في حق القراءات. (تشخيص الحالة). والمبحث الثالث فيه ضوابط القراءة الصحيحة مع تعريف موجز بالقراء العشرة مع رواّتهم. والمبحث الرابع ففيه العلاج والردود لتلك الشبهات والأكاذيب جملة وتفصيلاً، مع خاتمة ونتائج الدراسة.

كلمات مفتاحية: القراءات القرآنية، إغناز غولد تسيهر، عبد الفتاح القاضي، المستشرقون، الشبهات.

Qur'anic Readings / Dialects from the Jewish and Islamic Perspective – Sheikh Abdal Fattah al Qadi v.s. professor Ignac Gold Tsiher

Abstract:

This study aims to present the most important suspicions and lies regarding the Qur'anic different readings/dialects that were mentioned in the book: (**Doctrines of Islamic Interpretation**) by the Hungarian Orientalist Professor Ignaz Gold Tsiher, with the responses and refutations of Sheikh Abdel Fattah Al-Qadi in his book (The Qur'anic Readings in the Views of Orientalists and Atheists). The researcher utilized the Descriptive Analytical Critical Methodology. The problem of this study revolves around denying the revealed Qur'anic revelation, thus considering the Qur'anic readings/dialects as a form of freedom and purely personal choice due to the nature of Arabic calligraphy, omissions of readers and copyists, with no relationship to the truthfulness, accuracy, and honesty of the companions may God be pleased with them, in receiving and narrating them in succession to generations after them. The study proved the invalidity of these suspicions and lies raised about the Qur'anic readings, the companions and the reciters, confirming the fairness and honesty of the companions and the reciters, confirming that the principal in the Qur'anic readings is the revealed divine revelation, the direct oral recitation, the direct hearing with continuous collective narration. The study contains an introduction, four sections and conclusion. In the first section, the life and efforts of each of the two scholars are mentioned. The second section came to diagnose and analyze the type and the nature of suspicious ideas regarding the Qur'anic readings/dialects. The third section contains the conditions of the correct reading with a brief definition of the ten

reciters with their narrators. Finally, the treatment and responses with main findings of the study.

Keyword: *Qur'anic Readings/Dialects, Ignac Gold Tsiher, Abdel-Fattah Al-Qadi, Orientalists, Suspicious.*

PËRMBAJTJA

Përmbledhje	5
المخلص	7
Abstract.....	8
HYRJE.....	11
Rëndësia e studimit.....	12
Shkaqet e përzgjedhjes së këtij studimi	13
Objektivat e studimit.....	13
Pyetjet kërkimore.....	14
Metodologjia e ndjekur në studim	14
Studimet paraprake.....	14
Historiku i veprave që kanë demantuar shpifjet e Goldziherit	16

Kapitulli I

BIOGRAFIA E HOXHËS DR. ABDUL FETTAH KADI

1. PËRMBELDHJE BIOGRAFIKE RRETH HOXHËS ABDUL FETTAH EL-KADI.....	20
1.1. Studime të pakta rreth hoxhës dr. Abdul Fettah Kadi...20	
1.2. Mësuesit e hoxhës dr. Abdul Fettah Kadi.....21	
1.3. Shkollimi.....22	
1.4. Nxënësit më të dalluar të tij.....22	
1.5. Singjeriteti dhe përkushtimin i tij në edukim dhe arsimim	23

1.6. Virtytet dhe tiparet	23
1.7. Postet që ka ushtruar.....	26
1.8. Disa nga arritjet e Hoxhës	27
1.9. Vdekja e Hoxhës.....	28
2. KONTRIBUTI I HOXHË DR. ABDUL FETTAH KADIUT NË SHKRIME.....	30
3. BIOGRAFIA DHE VEPRIMTARIA E GOLDZIHERIT.	46

Kapitulli II

KLASIFIKIMI I DYSHIMEVE TË GOLDZIHERIT DHE VOKABULARI I TIJ DYSHUES PËRKITAZI ME KIRAETET DHE KURRATË - LEXUESIT E KUR'ANIT

NATYRA E DYSHIMEVE TË GOLDZIHERIT DHE LLOJET E TYRE.....	52
VOKABULARI DYSHUES I GOLDZIHERIT PËRKITAZI ME KIRAETET KUR'ANORE	60
VLERËSIMI I PERSONALITETIT TË GOLDZIHERIT SIPAS KRITEREVE SHKENCORE DHE AKADEMIKE..	62

Kapitulli III

SHKENCA E KIRAETEVE, DISIPLINAT E SAJ, DALLIMET NDËRMJET KIRAETEVE DHE RIVAJETEVE, DHJETË LEXUESIT DHE TRANSMETUESIT E TYRE

Kiraeti mutevatir.....	69
------------------------	----

Kiraeti sahih	70
Përmbledhje biografish të dhjetë lexuesve	73

Kapitulli IV

KUNDËRPËRGJIGJET E HOXHËS ABDUL FETTAH KADI NDAJ DYSHIMEVE DHE GËNJESHTRAVE TË GOLDZIHHERIT

NATYRA E KUNDËRPËRGJIGJEVE AKADEMIKE DHE IDEOLOGJIKE TË DR. ABDUL FETTAH KADI.....	86
KUNDËRPËRGJIGJET E DR. ABDUL FETTAH KADI NDAJ SHPIFJEVE DHE AKUZAVE TË GOLDZIHHERIT	87
Dyshimi i parë dhe kundërpërgjigjia e tij	87
Dyshimi i dytë dhe kundërpërgjigjia e tij	91
Dyshimi i tretë dhe kundërpërgjigjia e tij.....	93
 PËRFUNDIME	 123
BURIMET DHE REFERENCAT	127
PËRMBAJTJE.....	137

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

HYRJE

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Falënderimet i takojnë Allahut, Zotit të botëve, ndërsa përshëndetjet me salat e selam qofshin për të dërguarin e mëshirshëm, Muhammedin, familjen, shokët dhe të gjithë ata që i përmbahen udhëzimit të tij deri në kiamet!

Sigurisht se marrja me interpretimin e Kur'anit dhe shkencat, që kanë të bëjnë me leximin dhe recitimin e tij është prej angazhimeve më të vyera e më të çmuara që një besimtar mund ta bëjë për faktin se ato i shërbejnë librit më me vlerë, Kur'anit Fisnik.

Përgjatë analizimit të materialeve që orientalistët kanë ofruar në fushat e studimeve islame, e veçmas në fushën e studimeve kur'anore, vërehet mungesë e madhe e objektivizmit, sikur që vërehen edhe mangësi të shumta metodologjike, duke filluar nga citimi shkel e shko i burimeve dhe referencave për të vazhduar më pas me lajthitje dhe shtrembërime të qëllimshme dhe me ngatërrim ndërmjet të vërtetave dhe të pavërtetave me rastin e

prezentimit të koncepteve, perceptimeve, metodologjive dhe analizave.

Duhet theksuar me këtë rast se metodologjia e orientalistëve në studimet e tyre, klasikë a bashkëkohorë qofshin ata, karakterizohet nga mungesa e objektivizmit shkencor e akademik. Orientalistët janë fokusuar në çështje të ndjeshme, të cilat provokojnë debat dhe në mesele dytësore, për të cilat nuk ka një mendim apo konsensus tek dijetarët myslimanë. Këtë e kanë bërë që para perëndimorëve Islamit ta paraqesin të gjymtuar, të shëmtuar, pra, t'i indoktrinojnë ata dhe t'ua helmojnë mendjet në mënyrë që çdo gjë islame të refuzohet apriori.

Rëndësia e studimit

Për shkak të rëndësisë fetare e shkencore që kiraetet¹ e Kur'anit paraqesin, orientalistët, arabë e të huaj, i janë rrekur atyre përgjatë gjithë historisë së tyre. Sigurisht, ky interesim dhe përkushtim i tyre për kiraetet nuk ka ardhur si rezultat i dashurisë së tyre për Kur'anin apo si gatishmëri për t'i dalë në mbrojtje atij; jo, si instrument në duart e kolonizuesve dhe misionarëve të krishterë që kanë qenë e janë, e kanë bërë thjeshtë për shërbimin e tyre, pra, për qëllime të ulëta e aspak fisnike². Nëpërmjet hedhjes së dyshimeve në vlerën dhe pozitën e Kur'anit³, orientalistët në fakt kanë qenë ushtarë të cilët, i janë bashkuar dhe iu kanë shërbyer atyre që kanë dashur të pushtojnë tokat e myslimanëve dhe të përvetësojnë paligjshëm pronat dhe pasuritë e tyre.

Orientalistë ka shumë, por në mesin e tyre si më të njohur janë veçuar: *Theodor Noldeke*, *Joseph Shacht*, *Regis Blachere*, *Louis*

¹ Leximet e Kur'anit. Gjatë përkthimit do t'i referohemi në original, pra, kiraete. Përkthyesi.

² Shih: Al Humejd, *Ehdaf el-istisbrak ve vesailubu*, f. 5-15.

³ Shih: Ebu Shehbe, *Difaun an es-Sunneh*, f. 10-50.

Massignon, Ignaz Goldziher, Maksim Rodinson, Montgomery Wat, etj. Në islamistikë, në përgjithësi, dhe në fushën e studimeve kur'anore e profetike në veçanti, spikasin më shumë emrat e *Theodor Noldeke* dhe *Ignaz Goldziher*. Në përfundim, këta të dy janë bërë referencë për studimet kur'anore, e veçmas *Goldziheri*, përkushtimi i madh i të cilit për studimet kur'anore vërehet në volumin e madh të veprave që ka përgatitur me këtë tematikë.

Shkaqet e përzgjedhjes së studimit

Dr. Abdul Fettah Kadi është një personalitet, të cilit nuk i është kushtuar vëmendje shkencore që e meriton. Ky ka qenë motivi që na ka shtyrë t'i qasemi studimit të veprimtarisë së tij. Si një autoritet i pakontestuar në fushën e kiraeteve dhe si një ndër themeluesit e Fakultetit të Kur'anit në Universitetin Islamik në Medinë, ai meriton më shumë se që është bërë deri më tani për të. Vepra e tij, nuk guxon të mbulohet nga pluhuri i harresës. Studimi vjen për të ringjallur kujtimin për këtë dijetar, që aq shumë ka bërë për Kur'anin dhe aq shumë ka luftuar për t'i zhvlerësuar akuzat dhe dyshimet e hedhura për të. Është edhe shenjë mirënjohje ndaj tij për kontributin që ka dhënë, por edhe për të gjithë dijetarët tjerë që kanë kaluar jetën duke i shërbyer Kur'anit dhe shkencave të tij.

Objektivat e studimit

Studimi mëton të ndriçojë të vërtetën përkitazi me kontributin e dy personaliteteve në fushën e studimeve kur'anore. I pari është dijetar mysliman, nami i të cilit ka marrë dhenë në botën islame, dhe i cili tërë jetën e ka kaluar duke i shërbyer Kur'anit, si mësues, autor dhe avokat i tij. Pra, ua ka mësuar të tjerëve leximin e Kur'anit, ka shkruar për Kur'anin dhe e ka mbrojtur atë nga përbaltja e dashakëqijve. Ndërsa i dyti është bërë i njohur në

perëndim, për akuzat dhe dyshimet që ka hedhur përkitazi me Kur'anin duke u munduar t'ia zbehë vlerën atij, të vë në pikëpyetje drejtësinë dhe korrektësinë e Sahabëve, ta vë në dyshim besnikërinë e lexuesve të njohur nëpërmjet të cilëve na janë përcjellë format e leximit të Kur'anit. I pari është hoxha i madh, dr. Abdul Fettah el Kadi ndërsa i dyti është orientalisti hungarez Ignaz Goldziher.

Pyetjet kërkimore

- 1) Cila është pozita shkencore e Hoxhë Dr. Abdul Fettah Kadiut në studimet kur'anore?
- 2) Cila është e vërteta shkencore dhe ideologjike që fshihet prapa personalitetit të profesor Ignaz Goldziherit?
- 3) Cilat janë dyshimet që Goldziheri ka hedhur përkitazi me kiratet e Kur'anit?
- 4) A ia doli Hoxha Abdul Fettah Kadi t'i zhvlerësojë dhe demantojë shkencërisht akuzat dhe dyshimet e Goldziherit?

Metodologjia e ndjekur në studim

Në këtë studim kemi ndjekur metodologjinë përshkuese, analitike, kritike dhe krahasuese.

Studimet paraprake

Ekzistojnë dy studime me vlerë sa i përket mendimit dhe kontributit të hoxhës Abdul Fettah Kadi. I pari është i vjetër, ndërsa i dyti është bërë tash viteve të fundit. I pari është punim autorial i hoxhës dhe profesorit tim të dashur në Universitetin Islamik, imamet të Xhamisë së Kubasë në Medinën e Ndritur, dr.

Abdul Aziz Kariut. Ai ka bërë një punim të çmuar rreth jetës dhe veprës së hoxhës Abdul Fettah Kadi, për çka Allahun e lusim ta shpërblejë me të mira. Ky punim është publikuar në revistën e studimeve kur'anore, organ i Fakultetit të Kur'anit, në vitin 1403/1983. Studimi vë në pak pozitën që dr. Kadi kishte në shkencat kur'anore dhe kontributin që kishte dhënë, në themelimin e institucioneve në Egjipt dhe Arabi Saudite për Kur'anin dhe shkencat e tij. Pavarësisht vlerave të rralla që ka, punimi nuk është marrë drejtpërdrejtë me kontributin e hoxhës në flakjen e dyshimeve rreth Kur'anit dhe leximeve të tij, veçmas dyshimeve të Goldziherit. Mund të themi se punimi megjithëkëtë është një referencë bazë për jetën dhe mendimin e hoxhës dr. Abdul Fettah Kadi, *Allahu e mëshiroftë!* Ndërsa studimi i dytë është me titull *Hoxha Abdul Fettah Kadi dhe kontributi i tij në studimet kur'anore: studim historik dhe analitik* (الشيخ العلامة عبد الفتاح بن عبد الغني) me autor hulumtuese Vefa bint Muhammed Mensur Ebu-l-Ajnejn. Autorja në fakt me të ka fituar titullin magjistër në shkencat e tefsirit pranë Fakultetit të Shkencave Islame, në Universitetin Ndërkombëtar Medina, në Malajzi në vitin 2018. Studimi ka vlerë të veçantë për faktin se është përkufizuar në kontributin e hoxhës Abdul Fettah Kadi në studimet kur'anore.

Pavarësisht kësaj, gjatë shfletimit të kësaj teze të magjistraturës, kam vënë re se si hulumtuesja i është shmangur meselesë së kiraeteve të Kur'anit. Në fakt ka bërë një aludim më pak se një faqe, por që është i pamjaftueshëm. Hulumtuesja në faqet 174-175, ka përmendur veprën e hoxhës rreth leximeve të Kur'anit (القراءات القرآنية في نظر المستشرقين والملحدین) por duke mos u marrë me të dhe duke mos e analizuar siç ka vepruar me veprat tjera të tij. Këtu qëndron vija ndarëse ndërmjet këtij punimi dhe studimit tonë. Hulumtueses i takojnë meritat për referenca të rëndësishme, sa i përket jetës dhe veprimtarisë së Hoxhës, për takime e intervista

me dijetarë e shkollarë të ndryshëm, nga nxënësit dhe studentët e Hoxhës, të cilët kanë folur për të dhe veprimtarinë e tij. Hulumtuesja krahas kësaj, ka publikime në bashkautorësi me mentorin e saj¹ edhe punime tjera të hoxhës bashkë me komentaret e tyre, si: *Essirru el-mesun fi rivajeti Kalun an tarik esh-Shatibijeh* (السر المصون في رواية قالون من طريق الشاطبية), pastaj libri *En-nadhmü el-xham li-kiraeti el-Imami Nafi* (النظم الجامع لقراءة الإمام نافع), libri *El-feraid el-hisan fi addi aji el-Kur'an* (الفرائد الحسان في عدّ آي القرآن).

Historiku i veprave që kanë demantuar shpifjet e Goldziherit

Dijetar dhe studiues të shumtë myslimanë janë marrë me shpifjet, të cilat Goldziheri i ka publikuar në veprën *Doktrinat e interpretimit islam*. Më poshtë keni një përmbledhje të këtyre veprave dhe hulumtimeve:

Nr.	Titulli i librit	Autori	Viti
1)	<i>El-lebexhat ve el-kiraat</i> (اللهجات والقراءات)	<i>Dr. Abdul Vehhab Hamude</i>	1948
2)	<i>Tarih el-Kur'an ve garaibu resmih</i> (تاريخ القرآن وغرائب رسمه)	<i>Mubammed Tabir bin Abdul Kadir Kurdi</i>	1953

¹ Këto mbase mund të jenë edhe pjesë të punimit të saj. Shih: Ebu el-Ajnejn dhe Xhadullah, *Mexbeletu el-ulum el-islamije edduelije*, Universiteti Ndërkombëtar Medina, Malajzi, <http://ojs.mediu.edu.my/index.php/IISJ/article/view/1903>, shfletuar më 01.03.2021.

3)	<i>Resm el-mus'haf el-uthmani ve eham el-musteshbrikine</i> (رسم المصحف العثماني وأوامر المستشرقين)	<i>Dr. Abdul Fettah Shelebi</i>	1960
4)	<i>El-kiraat fi nadhri el-musteshbrikine ve el-mulhidine</i> (القراءات في نظر المستشرقين والمحدثين)	<i>Dr. Shejh Abdul Fettah Kadi</i>	1972
5)	<i>Dirasat fi menabixh el-mufessirine</i> (دراسات في مناهج المفسرين)	<i>Dr. Ibrahim Abdurrahman Halife</i>	1979
6)	<i>El-kiraat: abkamuba ve masdaruba</i> (القراءات: أحكامها ومصدرها)	<i>Dr. Shaban Muhammed Ismail</i>	1986
7)	<i>El-abruf es-seb'ah ve menziletu el-kiraat minha</i> (الأحرف السبعة ومنزلة القراءات منها)	<i>Dr. Hasan Dijauddin Atar</i>	1988
8)	<i>Edb-dhahiretu el-istishrakijjetu ve etheruba fi ed-diirasat el-islamije</i> (الظاهرة الاستشراقية وأثرها في الدراسات الإسلامية)	<i>Sasi Salim Haxh</i>	1991
9)	<i>El-kiraat el-kur'anije ve siletuba bi el-lebexhat el-arabije</i>	<i>Reshad Muhammed Salim¹</i>	1995

¹ Xhebel, *Err-rreddu ala el-musteshbrik el-jehudij Goldziber fi metainibi ala el-kiraat el-kur'anijeh*, f. 9.

	(القراءات القرآنية وصلتها باللهجات العربية) (العربية)		
10)	<i>Err-rreddu ala el-musteshbriki el-jehudij Goldziber fi metainihi ala el-kiraat el-kur'anije</i> (الرد على المستشرق اليهودي جولد تسيهر في مطاعنه على القراءات القرآنية)	<i>Dr. Muhammed Hasan Hasan Xhebel</i>	2002
11)	<i>El-kiraat el-kur'anije bejne en-nadhreti el-islamije ve el-jehudije</i> (القراءات القرآنية بين النظرة الإسلامية واليهودية - الشيخ عبد الفتاح القاضي مع الأستاذ غولد تسيهر وجهاً لوجه)	<i>Dr. Hajredin Hoxha</i>	2021

Studimi përbëhet nga gjithsej katër kapituj, të paraprirë me një hyrje dhe të përmbyllur me një pasthënie, në të cilën janë përkshkruar rezultatet e tij.

Kapitulli I:
BIOGRAFIA E HOXHËS
DR. ABDUL FETTAH KADI

Në këtë kapitull, do të trajtojmë çështje me rëndësi nga jeta dhe veprimtaria e hoxhës sonë, duke filluar me edukimin dhe përgatitjen profesionale të tij, kontributin shkencor, postet e ushtruara, sukseset e arritura dhe, sigurisht, një pjesë nga biografia e tij e ndritur dhe tiparet e tij të çmuara.

1. PËRMBELDHJE BIOGRAFIKE RRETH HOXHËS ABDUL FETTAH KADI

1.1. Studime të pakta rreth hoxhës dr. Abdul Fettah Kadi

Për jetën e Shejhut kanë shkruar disa nga nxënësit dhe simpatizantët e tij, por janë shumë pak, kështu që është e pamundur të gjesh një biografi komplete në një burim të caktuar. Megjithatë, Allahu i madhëruar ka bërë që disa nga nxënësit e devotshëm të hoxhës, si nga ata të hershmit si nga këta të mëvonshmit, t'i rreken kësaj pune dhe ta trajtojnë jetën dhe veprimtarinë e tij.

Kjo gjë ka diktuar nevojën e hulumtimit për detaje të jetës së tij, në forume të ndryshme kur'anore në internet. Prej atyre që kanë shkruar për jetën e tij, version me të kompletuar dhe më të hollësishëm ka sjellë një nga profesorët e mi, dr. Abdul Aziz el-Karij¹, i cili dekada më parë, në revistën e Fakultetit të Kur'anit Fisnik, shkroi për jetën e tij. Po ashtu, më ka rënë të lexoj edhe biografinë e shkurtër të publikuar nga Universiteti Ummul Kura, në Mekkë, për çka i falënderoj shumë!

Nxënës tjetër i hoxhës, që ka trajtuar biografinë dhe veprimtarinë e tij është hoxha dhe lexuesi i njohur i Kur'anit, Ibrahim el-Ahdar, po kështu imam në xhaminë Kuba, në Medinë. Në fakt hoxha

¹ Profesor i Tefsirit Tematik në Fakultetin e Kur'anit, në Universitetin Islamik, në Medinë. Njëherësh Imam dhe ligjërues në xhaminë Kuba, po ashtu në Medinë. Hulumtuesi ka pasur fatin që ta ketë profesor në periudhën 1990-1994, në Universitetin Islamik, në Medinë.

Ibrahim nuk ka shkruar ndonjë vepër, por biografinë dhe veprimtarinë e hoxhës i ka trajtuar në formë të një interviste, të zhvilluar me nxënësin e vet, dr. Abdullah bin Muhammed bin Selman Xharullah. Është ky i fundit, ai që ka përgatitur për botim biografinë e dr. Abdul Fettah Kadiut dhe këtë në një vepër të zgjeruar¹. Shpërblimi dhe mirësitë e Allahut qofshin mbi të, mbi hoxhën e tij dhe mbi hoxhën tonë!

Ne, në këtë studim, do t'i referohemi veprës së parë, veprës së nxënësit të parë të hoxhës, dr. Abdul Aziz Kariut, njëherësh profesor dhe hoxhë yni. Do t'i referohemi edhe veprës së dytë por më pak, sikur që do t'i referohemi dhe punimeve tjera.

Dr. Abdul Aziz Kariu ka hapur biografinë e hoxhës dr. Abdul Fettah Kadiu me këto fjalë: *“Dr. Abdul Fettah Kadiu, dijetar i madh dhe i rrallë, i pashoq në kohën e vet. Ka lindur në Demenbur, Egjipt, më 25 shaban 1325 h./ 14 tetor 1907. Hapat e parë në dije i hodhi në vendlindje, ku mësoi Kur’anin përmendësh, për të vazhduar më pas me Shkencën e Kiraeteve dhe Texhvidin, të cilat i mësoi nga dijetarët më në zë të asaj kobe, në Aleksandri dhe Kajro.”*

1.2. Mësuesit e hoxhës dr. Abdul Fettah Kadi

Ka mësuar tek dijetarë të shumtë, si:

- 1) Ali Ijade, tek i cili mësoi Kur’anin përmendsh.
- 2) Mahmud Muhammed Gazzal dhe Mahmud Muhammed Nasruddin, nga të cilët mësoi texhvidin dhe dhjetë llojet e kiraeteve (leximeve të Kur’anit Fisnik).
- 3) Hemmam Ibn Kutb Ibn Abdul Hadi dhe Hasen Subhi, nga të cilët mësoi dhjetë kiraetet.
- 4) Mahmud Abdud Daim.
- 5) Mahmud Sheltut (Shejhu i Ez’herit).
- 6) Dr. Abdullah Draz.

¹ Revista Dija, nr. 9, shaban 1433 h.

- 7) Jusuf Dexhvi.
- 8) Ahmed Mekki.
- 9) Mahmud el-Hidr Husejn (Shejhu i Ez'herit), e shumë të tjerë, *Allahu i pastë mëshiruar!*

1.3. Shkollimi

Në fillim, në Aleksandri, ndoqi Institutin e Ez'herit, ku fitoi diplomën e shkollës së mesme, për të vazhduar më pas studimet në Kajro, në Universitetin e famshëm të Ez'harit dhe në vitin 1935 arriti gradën e asaj që sot njihet si doktoratë.

1.4. Nxënësit më të dalluar të tij

Dr. Kadiu ka mësuar një numër të madh nxënësish, ndër të cilët më pas do të dalin emra të mëdhenj në fusha të ndryshme të shkencave islame, si:

- 1) Dr. Musa Shahin Lashin.
- 2) Dr. Ali AbduRrahman el-Hudhejfi.
- 3) Shejhu Ibrahim el-Ahdar – njëri nga nxënësit më të dalluar të tij, njëherësh një nga ish-imamët e xhamisë së Pejgamberit ﷺ.
- 4) Shejhu Muhammed Sadik el-Kamhavi.
- 5) Dr. Muhammed Salim Muhajsin – autor i veprave të njohura në kiraete dhe fusha të tjera.
- 6) Dr. Sha'ban Muhammed Ismail.
- 7) Shejhu Rizk Halil Habbeh.
- 8) Mahmud Halil Husari.
- 9) Dr. Abdul Aziz el-Kariij – ish-dekan i Fakultetit të Kur'anit Fisnik dhe Studimeve Islame, në Universitetin Islamik të Medinës.
- 10) Shejhu Seid Ibn Ahmed Ibn Muhammed Isa es-Senedij, etj.

1.5. Singëriteti dhe përkushtimi i tij në edukim dhe arsimim

“Të gjithë ata që kanë mësuar prej tij e kanë dashur dhe kanë qenë fort të lidhur me të. Kur i kam pyetur disa prej ish-nxënësve të tij për sekretin e kësaj lidhje, më kanë thënë se çështjen që dikush nuk mund ta shpjegonte për ditë të tëra, ai e shpjegonte për disa minuta duke e bërë të qartë dhe të kuptueshme. Personalisht këtë e kam interpretuar si rezultat i dy gjërave: singëritetit të hoxhës dhe nijetit të pastër të tij, sepse kush ka nijet të pastër, ka bërëqet në vepra, dhe thellësisë së tij në këtë shkencë, si jo kur ai ka kaluar tërë jetën ndërmjet mësimit, veprave, mësimdhënies, hulumtimit e verifikimit. Hoxha kishte një metodë shumë tërheqëse. I mbante lidhjet me studentët, interesohet për gjendjet dhe problemet e tyre, i qortonte nëse nuk e vizitonin në shtëpi, e po të kishte mundësi për shkak se vuante nga shëndeti i dobët, do t’i vizitonte vet. Të gjithë e trajtonin si prind. Për dallim prej tij, disa profesorë dallohen për vrazhdësi e raporte të ftohura me studentët. Ata nuk mund t’i takosh vetëm se gjatë kohës së ligjëratës. Fakti se arsimimi është profesion edukativ, i cili kërkon forcimin e lidhjeve ndërmjet profesorit dhe studentëve nuk paraqet ndonjë rëndësi për ta. Ata janë larg, madje shumë larg, të parëve tanë, të cilët dalloheshin për raporte të mira dhe afërsi me nxënësit dhe studentët..”¹

1.6. Virtytet dhe tiparet

Dr. Abdullah bin Muhammed bin Sulejman Xharullah ka përmendur tipare dhe virtytet të shumta të hoxhës, prej të cilave ne do t’i veçojmë disa:

Hoxha Abdul Fettah Kadi është veçuar për talent dhe tipare që nuk janë parë tek bashkëkohësit e tij, hoxhallarë apo të tjerë qofshin, dhe as tek gjeneratat që kanë pasuar. Dallohej veçmas

¹Shih: Abdul Aziz Kariu “*El-alametu esb-Shejh Abdul Fettah Kadi ve etheruhu fi eddirasat el-kur’anijë*” revista e Fakultetit të Kur’anit Fisnik, Universiteti Islamik, në Medinë, f. 309-320; “*Alimu-d-dunja ve Shejhu el-mukri’ine Abdul Fettah Kadi – siretun atiretun ve tarihun mexhid*”, revista Dija’, f. 46-81; Mersafi, *Hidajetu el-kari ila texhvidi kelami el-Bari*, f. 658-663.

për leximin, shqiptimin e rrallë, fuqinë e ndjeshmërisë kur'anore, tipare këto që i jepnin epërsi në njohjen e shprehjeve të ndryshme nëpërmjet fjalës së Allahut. Ishte i mahnitshëm dhe shumë tërheqës për këdo që e dëgjonte duke lexuar. Po ta dëgjoje duke lexuar, shpjeguar a folur, do të krijonte përshtypjen se në fakt një engjëll është duke lexuar. Hoxha Ahdari ka thënë: Hoxha ynë, Kadiu, që bekuar e begatuar me bukuri të shprehjes e recitimit. Thuajse lulet e kopshteve të leximit dhe mentorimit të lexuesve patën lulëzuar në zemrën dhe gjuhën e tij. Ditët buzëqeshnin e kënaqeshnin, ndërsa dëgjonin prezentimin e bukur që i bënte Kur'anit... Salahu, djali i tij i madh, rrëfen: Kam marrë pjesë në të gjitha hytbet, që babai i ka mbajtur në xhamitë e Demenhurit dhe Kajros. Njerëzit qanin prej fuqisë së tyre këshilluese e qanin edhe më shumë, kur iu printe në namazin e xhumasë dhe ju lexonte Kur'anin.

Tipar tjetër që e dallonte hoxhën ishte edhe përkujdesja për dukjen. Vishte rrobat më të mira, parfumohej dhe kurrë nuk dilte pa çallmën e Az'harit dhe uniformën e dijetarëve. Çdokush që ka pasur nderin të shoqërohet me të a të jetë mysafir i tij, ka dëshmuar për bujarinë dhe mikpritjen e tij. Shtëpia e tij ishte e hapur për vizitorë dhe gumëzhinte nga nxënësit, studentët dhe hoxhallarët. Derën e shtëpisë e linte të hapur dhe thoshte se sa herë që e gjeni të hapur, hyni e nuk keni nevojë të kërkoni leje. Madje edhe kur qe shtyrë në moshë, refuzonte ta reduktonte orarin e takimeve me studentë e miq, pavarësisht këshillave mirëdashëse që i jepeshin me këtë qëllim.

Tipar tjetër i tij ishte modestia dhe thyerja e mendimit, sa herë që i bëhej e qartë se e vërteta ishte ndryshe. Nuk bezdisej nga mendimi tjetër e aq më pak ta refuzonte. Ishte zemërgjerë. Duke na folur për këtë tipar, hoxha tunizian Ebu Abdullah Munir Mudhafferit thotë: Ajo që më bënte ta dua me gjithë shpirt Hoxhën është qëndrimi respektues i tij, karshi mendimeve tona të ndryshme. Më ka rënë disa herë të mos kam ndarë mendim të

njëjtë me të dhe të mos e gjej kurrë të bezdisur nga kjo. Në mesele dytësore nuk ndihej keq nëse dikush nuk mendonte sikur ai dhe aq më pak ta shtynte dikë të mendonte sikur ai. Madje, nga modestia, ndonjëherë kërkonte prej meje, që të hulumtoja për mendimin më të saktë për një mesele, që kishte mendime të ndryshme rreth saj. Ishte dijetar i madh, e donte argumentin bindës. Ky është karakter i dijetarëve që e pasojnë argumentin dhe nuk imitojnë. Disa lexues (ar. *kurra*) nuk e kanë pritur mirë qasjen e tij, për t'u çliruar nga zgjedha e imitimit, madje e kanë marrë si pretekst për ta sulmuar e për t'ia ulur vlerën. Kështu veprojnë vetëm ata që janë pushtuar nga fanatizmi dhe imitimi i verbër.

Përveç këtyre tipareve, hoxha dallohej dhe për aspektin e adhurimit. Ishte shumë i devotshëm. Nuk i interesonin pozitat dhe as që jepej pas funksionarëve e pushtetarëve. Hoxha Abdul Azizi rrëfen për të e thotë: Kemi qëndruar bashkë për tetë vite dhe nuk mbaj mend të më ketë thënë as edhe një herë të vetme: eja të shkojmë tek ky apo ai pushtetar. Ishte devotshmëria ajo që e kishte penguar, të mos incizonte leximin e Kur'anit për radion, sepse urrente që nga i njëjti kanal të dëgjohej Kur'ani dhe gjëra tjera. Qëndrimin në Medinë e shihte si mirësi të veçantë, për të cilën duhej falënderuar dhe treguar edukatë të lartë. Jo rrallë lutej: Allahu im! Na pajis më kulturë e moral të lartë në qytetin e Pejgamberit Tënd! Qante shpesh e thoshte: Nuk e di nëse e meritoj të qëndroj këtu apo jo!

Këto qëndrime, lutje e këta lot sigurisht se flasin për dashurinë e tij të madhe për fenë e Allahut, për të Dërguarin e Tij, e inshaAllah edhe për pranimin e veprave të Hoxhës sonë!

Do theksuar se hoxha nuk e merrte vet pagën. E merrte ndonjëri nga studentët dhe ia dorëzonte gruas së hoxhës. Ai nuk e dinte as sa e kishte rrogën dhe as kur e merrte atë¹.

¹ Shih: Revista *Dija'*, f. 53-57.

Kjo është një mirësi që Allahu ia jep vetëm robërve të Tij të zgjedhur. Këto tipare dhe ky moral kur'anor duhet të na karakterizojnë neve, profesorëve dhe studentëve në universitetet tona islame. Ende më bën të ndihem keq, kur e kujtoj qëndrimin e njërit prej profesorëve, i cili në amfiteatrin e ligjëratave i drejtohet studentëve se raportet e tyre me të nuk duhej ta tejkalonin amfiteatrin. Sa fjalë të pavenda dhe sa qëndrim të shëmtuar që ka treguar ky profesor. Këto raporte diplomatike dhe në distancë, për pasojë kanë sjellë një gjeneratë studentësh dhe profesorësh për të cilët duhet thurur elegji. A thua vallë do të kenë fund ndonjëherë këta njerëz dhe këto sjellje?! A nuk marrin mësim të tillët nga praktika dhe sjelljet brilante të hoxhës Abdul Fettah Kadi, që të sillen mirë me studentët e të japin maksimumin nga koha, pasuria, energjia dhe çdo gjë tjetër, vetëm e vetëm që misionin e tyre edukativ ta kryejnë me sukseset më të larta të mundshme!

1.7. Postet që ka ushtruar

- 1) Menjëherë pas diplomimit, u emërua mësues në institutin e mesëm të Az'harit, në Kajro.
- 2) U emërua shejh (hoxhë) i leximeve të Kur'anit në Departamentin e Kiraeteve, në Fakultetin e Gjuhës Arabe në Az'har.
- 3) Kontrollor i përgjithshëm në institutet ez'heriste.
- 4) U emërua shejh nga Az'hari në Institutin e Az'harit në Desuk dhe Demenhur.
- 5) U emërua përfaqësues i përgjithshëm i instituteve të Az'harit dhe, më pas, edhe drejtor i përgjithshëm, funksion ky në të cilin mbeti deri në pensionim.
- 6) Që nga themelimi i Akademisë për Hulumtime Islame, në vitin 1950, ishte angazhuar në të, një herë si anëtar, ndërsa nga viti 1957 e deri në vdekje si udhëheqës i saj.

- 7) Ishte anëtar e më pas edhe Kryetar i Këshillit të Testimit të Lexuesve të Kur'anit, pranë Radios së Republikës së Egjiptit.
- 8) Me kërkesë të ish-myftiut të Arabisë Saudite, Shejh Abdul Aziz Ibn Bazit, do të transferohet në Medinën e Ndritur për të dhënë mësim atje. Do të mbetet në krye të Departamentit për Lexime, në Fakultetin e Kur'anit Fisnik dhe Studimeve Islame deri në v. 1403¹.

1.8. DISA NGA ARRITJET E HOXHËS

1.8.1. Themelimi i institutit për kiraete në Kajro

Ky institut është themeluar, në vitin 1945. Fillimisht ishte pjesë e fakultetit të gjuhës arabe në Az'har. Studimet zgjasnin tetë vite njëri prej të cilëve ishte për texhvidin, tre vitet pasuese ishin ekuivalente me shkollën e mesme, ndërsa katër vitet tjera ishin profesionale dhe quheshin *Tebassus el-kiraat*. Nga ky institut kanë dalë gjenerata të tëra të cilat kanë memorizuar Kur'anin, kanë përvetësuar kiraetet e tij dhe e kanë shërbyer atë, ashtu siç meriton të shërbehet libri i Zotit. Krahas hoxhës sonë, në këtë institut kanë dhënë mësim dhe emra tjerë të njohur, si: hoxha Amir bin Sejjid Uthman, Abdul Aziz Zejjat, Ibrahim bin Ali Shehateh Semenudi, etj.

1.8.2. Fakulteti i Kur'anit Fisnik në Medinë

Themelimi i këtij fakulteti, marrë parasysh faktin se ka qenë i pari i llojit të vet në nivel universitar, ka pasur rëndësinë dhe vlerën e pakontestueshme. Kontributi në fushën e studimeve kur'anore është i pamohueshëm. Pas Allahut të madhëruar, meritat për themelimin e këtij fakulteti i përkasin hoxhës dhe dijetarit të

¹ Shih detaje nga referencat e mëparshme.

mirënjohur, Abdul Aziz bin Bazit¹, atëbotë Kryetar i Qendrës për Hulumtime, Fetva, Dave dhe Udhëzim, dhe njëherësh Rektor i Universitetit Islamik të Medinës. Fakulteti e filloi punën me 20 studentë, të përzgjedhur për nga aspekti i nivelit të lartë në memorizimin dhe leximin e Kur'anit me texhvid. Prej tyre vetëm pesë ishin nga Saudia. Të tjerët ishin të huaj. Hoxha ynë qëndroi për katër vite ku me mbështetjen dhe përkrahjen e madhe të hoxhës Bin Baz vendosi planprogramet dhe kurrikulat mbi bazën e të cilave zhvillohej mësimi. Edhe autori i këtyre rreshtave ka pasur fatin ta shoqërojë hoxhën në këtë projekt. Hoxhës i ishte lënë mundësia që të përzgjidhte edhe kuadrin mësimdhënës, të cilët ai i kishte përzgjedhur me shumë kujdes. Ishin nga Egjipti, të gjithë ishin emra të shquar dhe të dalluar në këtë fushë. Detyrat që morën përsipër i kryen me besnikëri e përgjegjësinë më të madhe, duke ndërtuar kështu një sistem të mirëfilltë edukimi dhe një qendër të jashtëzakonshme për kohën, për studimin e Kur'anit dhe shkencave të tij. Studimet kur'anore kanë nevojë për një rimëkëmbje, për angazhime të reja, për kontribut të ri, në mënyrë që rezultatet e arritura e të ngela në dorëshkrime të shohin dritën e botimit sikur që ka nevojë për shkrime e hulumtime të reja, të cilat librarinë kur'anore do të pasuronin më shumë.²

1.9. Vdekja e hoxhës

Dr. Abdul Fettah Kadi vdiq, në Kajro, pas një sëmundje të shkurtër që e kishte goditur, në Medinë. Ka vdekur ditën e hënë,

¹ Dijetari i madh, Bin Bazi, ka vdekur më 14 maj 1999.

² Shih referencat paraprake. Shih edhe: Ismail, *Mukaddimetu el-vafi*, f. 27-35; Ebu El-Ajnejn, *Esb-Shejh el-Alameh Abdul Fettah bin Abdul Gani el-Kadi ve xhubuduhu fi eddirasat el-kur'anije*, f. 49-61. Ky studim është i çmuar pasi e trajton fare pak kontributin e hoxhës dhënë në fushën e kiraeteve.


me muharrem 1403 h., ose më, 1 nëntor 1982. Është varrosur, në Kajro¹.

E lusim Allahun ta mëshirojë hoxhën tonë dhe ta shpërblejë për shërbimin që i ka bërë Librit të Tij!

Gjatë hulumtimit kam gjetur një foto kolektive, të një numri dijetarësh dhe lexuesish nga Egjipti, në mesin e të cilëve janë edhe hoxha dr. Abdul Fettah Kadi, hoxha Mahmud Abdul Halik Xhadu dhe hoxha Abdurrafi Ridvan Sherkavi, qofshin nën mëshirën e Allahut!



¹ Shih revistën e Fakultetit të Kur'anit Fisnik dhe Studimeve Islame, nr. 1, f. 309-320.



Hoxha dhe profesori im, lexuesi Mahmud Abdul Halik Xhadu(ne mes), hoxha dhe lexuesi Abdurrafi Ridvan Sherkavi, hoxha dhe prof. dr. Mahmud Sibevejhi, Allahu i pastë mëshiruar!

2. KONTRIBUTI I HOXHË DR. ABDUL FETTAH KADIUT NË SHKRIME

Sa i përket kontributit të hoxhës në shkrimin e veprave dhe recensimin e tyre, dr. Abdul Azizi na ofron një përmbledhje të tyre duke i përmendur titujt me nga një përshkrim të shkurtër. Dr. Abdul Azizi nuk ka ofruar ndonjë foto të librave se si duken ato, mbase për shkak se në kohën e tij nuk ka ekzistuar interneti dhe se kjo mundësi që sot neve na ofrohet nuk ka qenë më parë. Këtë e kemi bërë ne. Secilit libër ia kemi vënë edhe një foto përkatëse.


Ndërsa përshkruan veprat e hoxhës, dr. Abdul Azizi bën këtë hyrje, përkitazi me profesionalizmin e hoxhës dhe dijet e shumta të tij:

Shejh dr. Abdul Fettah Kadiu ishte i njohur për zgjuarsinë e tij. Ai kishte një metodë dhe stil të lartë shpjegimi, kishte memorie të fortë dhe ishte i njohur për dije në fusha të ndryshme, fetare e shkencore, si: kiraete dhe shkenca kur'anore, fikh dhe usul, tefsir

dhe hadith, gjuhë dhe letërsi arabe etj. Ai ishte mësues i dalluar dhe shquhej për elokucencë dhe rrjedhshmëri në të folur¹. Kur fliste, të folurit e tij mund ta kuptojë shumë shpejt. Prej tij dolën mijëra studentë, nga dy prej universiteteve më me famë në botë, atij të Ez’herit dhe atij të Medinës.


Veprat e hoxhës janë diku 25 sosh dhe pothuajse të gjitha kanë për tematikë Kur’anin, shkencat e tij, shkencën e kiraeteve, mbrojtjen e këtyre shkencave etj. Por, ka edhe vepra të tjera me tematik fetare.

Në vazhdim do të prezentojmë këto vepra ose shumicën e tyre, pasi që disa nuk kemi pasur mundësi t’i kemi e dokumentojmë, andaj do ta përshkruajmë vetëm atë që kemi e për tjetrën Allahu nuk i ngarkon robërit përtej mundësive që kanë.

Nr.	Libri
1.	<p><i>El-vafî fî sberhi-sh-shatibijeh fî-l-kiraat es-sebë</i></p>  <p>Është një komentim përmbledhës i veprës “Lamije” të Imam Shatibiut, e njohur si Shatibijeh. Ka gjithsej 1173 vargje. Për rëndësinë që ka flet fakti se shumë dijetarë, si Sehavi, Xha’beriu, Ebu Shameh, Ibnul Kasih, Musuliu, Sujuti etj., e kanë komentuar atë.</p>


¹ Ndërsa po përgatisnim këtë studim, përveç materialeve tekstuale, kemi hulumtuar edhe në materiale tjera, audio dhe video. Në njërin prej këtyre ligjëratave, tanimë të ngarkuare dhe në internet, hoxha flet aq bukur dhe me zë aq të ëmbël saqë të mahnit. Konsiderojmë se është e dobishme nëse dëgjohet. Ja dhe linku: <https://www.youtube.com/watch?v=sCdnVw3xbrA>

2. *El-ijdah li metni-durreh fil kiraati-th-thelath el-mutemmimeti lil kiraat el-ashr*



Një komentim përmbledhës, po kështu i veprës së njohur të Ibnul Xhezeriut *Ed-durretu-l-mudijeh*, e cila trajton leximet e tre imamëve Ebu Xha'fer Medeniut, Ja'kub Hadremiut dhe Halef Ibni Hisham el-Kufiut. Vepra ka 240 vargje. Vepra nuk është komentuar shumë nga dijetarët e mëparshëm, kështu që kontributi i dr. Kadiut në këtë drejtim është shumë i rëndësishëm, ngase sjell para nesh një pjesë të trashëgimisë sonë shkencore, të panjohur hollësisht më parë. Libri ka 130 faqe të formatit të mesëm.

3. *El-budur ez-zabire fil kiraat el-ashereh el-mutevatireh min tarikat esh-shatibijeh ve-d-durreh*



Është një prej veprave më të mira të Shejhut dhe më e dobishmja për studentët e lëmit të kiraeteve. Në këtë vepër, ai i ka mbledhur të dhjetë leximet nga veprat shatibijeh dhe durreh, si dhe i ka renditur sipas radhitjes kur'anore, duke bërë shpjegim fjalë për fjalë, duke filluar me *usul*¹ e pastaj me *fersh*². Në fakt, ai nuk ishte i pari në përdorimin e kësaj metodologjie, pasi që para tij, dijetari i madh Safaksiu,

¹ Për qëllim janë rregullat, të cilat lexuesi i ndjek ndërsa lexon.

² Rregullat e veçanta përkitazi me disa fjalë të caktuara në Kur'an ose ekzekutimi ndryshe i disa fjalëve nga disa lexues, si p.sh., fjala *Malik* që lexohet edhe *Melik*.

kishte bërë një vepër të ngjashme, ku kishte mbledhur shtatë leximet dhe i kishte radhitur kësisoj në një vepër të njohur, titulli i së cilës ishte “*Gajthu-n-nefi fi-l-kiraat es-seb’e*”. Libri ka 360 faqe.

4.



Sherhu Minbati Mulil-Birr fima zadehu kitabu-n-neshri fi-l-kiraati-l-asbr ala-shatibjeh ve-durreh

Minhatu Mulij-l-Birr është një poemë e Shejhut Muhammed Ibn Muhammed Hilal el-Ebjari, e cila ka 140 vargje.

Ajo fillon me këtë varg:

قال محمد هلالي راجياً - إلهه عفواً عميماً كافياً

حمداً لمولانا مصلياً على - محمد والآل ما تال تالا

وهالك ما للكل نشر زاده - عما بدرة وحرز سرده

Muhammed Hilali thotë duke e lutur

Zotin e vet për falje të përgjithshme e të mjaftueshme

Falënderime Zotit tonë ndërsa salavate për

Muhammedin dhe familjen sa lexuesi të lexojë

Ja, këtu e keni tërë atë që Neshri ia ka shtuar

asaj që në Durreh dhe Hirz është parashtruar.



5. *En-Nadhmü el-xhami li kiraeti-l-Imami-n-Nafjü*

Imam Nafiu është imami i njohur i Medinës në kiraete, në kohën e imam Malikut. Ishte i njohur në këtë fushë, madje më kompetenti në kohën e tij, aq sa kur Imam Maliku pyetej për diç nga kjo lëmi, pyetjen e adresonte tek ai duke thënë: Për çdo dije, pyeten të zotët e saj. Është lexuesi i parë në radhitjen e veprave Shatibijeh dhe Durreh. Vepra ka 294 vargje dhe fillon me këtë varg:



بمحمد منشي العالمين أبتدي - ثم الصلاة والسلام الأبدى
على رسول الله خير الخلق - ومرشد الورى لنور الحق
وآله وصحبه الأعلام - وقارئ القرآن بالأحكام

*Me falënderimin për Krijuesin e botëve filloj,
Pastaj salate dhe selam
për të Dërguarin e Allahut, krijesën më të mirë çoj
Udhëzuesin e njerëzve në dritën e së vërtetës
Për familjen dhe shokët e tij të shquar
Për atë që Kur'anin sipas dispozitave e ka lexuar*

<p>6.</p>		<p><i>El-kiraat esh-shadh-dheb ve tev-xhibuha min lugatil arab</i></p> <p>Në këtë libër autori trajton leximet e disa imamëve: Ibn Muhajsin Muhammed Ibn AbduRahman el-Mekki (vd. 132 h.); Jahja el-Jezidi Ebu Muhammed Jahja Ibn Mubarek el-Basriij (vd. 202 h.); A'mesh Ebu Muhammed Sulejman Ibn Mehran Kufiu (vd. 148 h.).</p>
<p>7.</p>	<p><i>Sherbu Es-sirru-l-mesun fi rivajeti Kalun min esh-Shatibijeh</i></p> <p>Është një poezi për sqarimin e asaj që Kaluni dallon nga Versha. Është botuar në shtypshkronjën Abdul Hamid Hanefi, në Kajro.</p>	
<p>8.</p>	 <p><i>Sherbu sirr-ri-l-mesun</i></p> <p>Komentim i veprës paraprake.</p>	

9. *El-feraid el-hisan fi addi aji-l-Kur'an*

Është një përmbledhje prej 130 vargjesh, nga ajo që njihet si bahru-rrexhez, me një stil të ëmbël dhe të lehtë. Vepra hapet me këtë varg:



*E falënderoj Zotin tim dhe lutem përberë;
Për të Dërguarin e Allahut, nurin e
udhëzimin.*

Mendimet e dijetarëve rreth ajeteve të


Kur'anit

Po i sjell në formë të një poezie

perla të bukura e kam titulluar

shpresoj tek Allahu të më jetë pranuar

10.




Nefaisul bejan sberhu feraidil hisan

Është komentim i veprës paraprake.
Ka 56 faqe të formatit të vogël.

11. *Beshiru-l-jusri sberhu nadhimeti-z-zehri fi ilmi-l-fevasil*

Fjala është për librin ‘En-nudhum’ të imam Shatibiut, që ka për tematikë numërimin e ajeteve kur’anore. Quhet edhe ‘Ilmu-l-fevasil’. Në fakt, ky libër është një version i shkurtuar i librit ‘El-bejan’ të Ebu Amr Daniut. Ka gjithsej 297 vargje nga Bahru-t-Tavili, të cilat fillojnë me këtë varg:



بدأت بحمد الله ناظمة الزهر

لتجني بعون الله عينا من الزهر

وعُدت بري من شرور قضائه - ولُدت به في السر والجهر من أمري

بحي مرید عالم متکلم - سمیع بصیر دائم قادر وتر

Nadhimete Zehrin me falënderim për Allahun e fillova

që me ndihmën e Tij, një buqetë lule të na ofrojë

Kërkova mbrojtje tek Allahu nga dëmi i asaj që ka caktuar

dhe u strehova tek Ai për çështjen time në vetmi e publik

U strehova tek i Gjalli, Ai që dëshiron, Dijetari, Folësi

Dëgjuesi, Shikuesi, i Përbershmi, i Forti dhe i Vetmi

12. *Taribu-l-Mus'hafi-sh-sherif*

Titulli flet edhe për përmbajtjen. Libri trajton historinë e



Mus'hafit në kohën e sahabëve [Allahu qoftë i kënaqur me ta!], sikurse që flet për shkrimin, pikësimin dhe vokalizimin e tij, për kushtet që duhet t'i plotësojë shkruesi i Kur'anit, shtëpitë botuese, për renditjen e ajeteve kur'anore, kapitujt përkitazi me shkaqet e shpalljes së ajeteve. Autori përmend edhe mendime të


ndryshme të dijetarëve duke i diskutuar ato, si dhe duke përvetësuar atë që, në bazë të dëshmive, del se është më i vërteti.

Këtë aspekt ndoshta e gjejmë më të theksuar tek çështja e kopjeve të Kur'anit në kohën e Uthmanit r.a., të cilat u shkruan në shtatë dialekte – lexime (ar. kiraetet.). Libri, tash në botimin e tij të dytë, ka gjithsej 168 faqe të formatit të vogël.

13. *Sherhu el-mukaddimeti el-xhezerijeh*

Libri El-mukaddimetu el-xhezerijeh është shumë i njohur në Texhvid. Përdoret shumë nga ata që i qasen mësimi përmendsh të Kur'anit. Si libër i është atribuar shejhut tonë, mirëpo a është ende në dorëshkrim apo është botuar, këtë nuk mund ta dimë, pasi që nuk kam mundur ta gjej ndonjë kopje të tij.

14. *Min ulumi-l-Kur'an*



Është një libërth tërheqës, në të cilin autori trajton disa çështje që kanë të bëjnë me Kur'anin, si: domethënia e Kur'anit, emrat e tij, ajetet mekase dhe medinase, shkrimi dhe kodifikimi i tij, radhitja, ajetet e qarta dhe të paqarta, shembujt kur'anorë, betimet e tij, ajetet që sipërfaqësisht duken kundërthënëse, metodat, tregimet etj. Libërthi shquhet për metodën e tij tërheqëse, të qartë dhe të kuptueshme. Është ndër më të mirët e këtij lloji, veçanërisht për fillestarët.


15.



Tarihu-l-Kurr-rra'i-l-asbr ve ruvatihim ve tevaturu kiraatihim ve menhexhu kul-lin fi-l-kiraah

Është libër i formatit të mesëm dhe ka gjithsej 46 faqe.

16. *Ebbath fi kiraat el-Kur'ani-l-Kerim*



Në këtë libër autori trajton 13 çështje të rëndësishme, që kanë të bëjnë me leximet – kiraetet, të cilat, siç i ka numëruar vetë ai në parathënie, janë:

- 1) Hadithet që flasin për shpalljen e Kur'anit në shtatë germa.
- 2) Çka nënkuptojnë shtatë gerrat?
- 3) Urtësia e shpalljes së Kur'anit në shtatë germa.
- 4) Çfarë mund të përfitohet nga hadithet e transmetuara me

këtë tematikë?


- 5) Leximet e shtatë imamëve dhe lidhjet e tyre me shtatë gerrat.
- 6) Leximet e dhjetë imamëve si pjesë e shtatë germave.
- 7) Tevaturi (saktësia maksimale) e leximeve të dhjetë imamëve.
- 8) Kriteri i leximit mutevatir (të saktë).
- 9) Ndarja e leximit autentik.
- 10) Dispozita e mohimit të leximit të vërtetuar sipas tevaturit.
- 11) Shkaku pse leximet i atribuohen sahabiut ose lexuesit.
- 12) Leximet janë alternativa të lexuesve – sqarimi përkatës.
- 13) Mendimi ynë.

Ky libër, megjithëse është i vogël, është përplot dituri. Ai në fakt përfaqëson mendimin e shejhut për çështjet në fjalë, të cilat, siç e dimë, janë të diskutueshme tek dijetarët. Mendimi ose opinionin e shejhut është se këto janë çështje alternative dhe se nuk kanë karakter obligues, veçse për autorët apo

	<p>koleksionuesit e tyre. Libri, që është botuar në Kajro nga AbduRahman Muhammedi, ka gjithsej 31 faqe të formatit të mesëm.</p>
<p>17.</p>	<p><i>El-kiraat fi nadhari el-musteshbrikin vel mulbidine</i>¹</p> <div data-bbox="310 469 671 1002" data-label="Image"> </div> <p>Ky është një ndër librat më të mirë të punuar nga shejhu. Në të, shejhu demanton një nga një akuzat e Goldziherit, i cili, në mënyrë të qëllimshme, tenton të njollosë kiraetet, e me këtë t'ia ulë vlerën Kur'anit. Gjatë diskutimit të shpifjeve dhe akuzave të pabaza të Goldziherit, mund të vërehet lehtë dituria e thellë që ka dr. Abdul Fettah Kadiu. Ai sjell shembuj të shumtë për të dëshmuar pavërtetësinë e asaj që pretendon Goldziheri dhe të ngjashmit me të. Libri, në botimin e dytë nga shtëpia botuese ed-Dar, në Medinën e Ndritur, ka gjithsej 203 faqe të formatit të vogël.</p> <p>Njëherësh, ky është libri tek i cili do ta fokusojmë studimin tonë.</p>


¹ Një ndër librat më të mirë të hoxhës, në të cilin iu kundërpërgjigjet orientalistëve në përgjithësi e Goldziherit në veçanti. Ne i jemi referuar shumë gjatë këtij studimi.

18. *Esbab en-nuzul ani-s-sababeti ve-l-mufessirine*



Është libër i formatit të madh. Konsiderohet si më i miri i llojit të vet. Shejhu i ka vënë vetes obligim që të mos sjellë në këtë libër asnjë transmetim përveçse që të jetë i saktë, në përputhje me kuptimin dhe synimet e ajeteve, në harmoni me synimet e përgjithshme të besimit islam, në një vijë me rregullat dhe kriteret e vëna nga dijetarët etj. Shejhu ndonëse sjell edhe burimet e transmetimeve, megjithatë nuk bën ndonjë studim kritik të tyre. Libri ka gjithsej 256 faqe.

19. *Erxbuzetul mirath*



Poezia që trajton shkencën e Feraidit, shkencën që ka të bëjë me ndarjen e trashëgimisë. Ka 158 vargje dhe hynë në tipin e poezive të Bahru-rr-rixhazit. Është hapur me këtë poezi:

الحمد لله القديم الباقي - مقدر الآجال والأرزاق


ثم الصلاة والسلام أبدا - على النبي العربي محتدا

Falënderimi i takon Allahut, të Parit të Gjithmonshëm

Përcaktuesit të exheleve (afateve) dhe furnizimeve


Pastaj, bekimet dhe përshëndetjet qofshin përherë

Për pejgamberin arab, pandërprerë

<p>20.</p>	<p><i>Sherhu erxhuzetil mirath</i></p> <p>Është komentim i veprës paraprake, me të cilin autori ka synuar t’ua lehtësojë fillestarëve këtë shkencë. Megjithatë, autori nuk i ka përfshirë të gjithë kapitujt e kësaj shkence, madje ata më kompleksët i ka braktisur fare. Libri është botuar në Kajro dhe ka 139 faqe të formatit të vogël.</p>
<p>21.</p>	<p><i>Es-sjamu fedailuhu ve abkamuhu</i></p>  <p>Është një libër që flet për agjërimin, por që shquhet për një metodë shumë tërheqëse. Autori përmend mendimet e dijetarëve dhe argumentet e tyre. Për herë të parë është botuar nga Akademia e Hulumtimeve Islame, në Az’har, në vitin 1392 h. Ka 175 faqe të formatit të vogël.</p>

Këto ishin veprat autoriale të hoxhës, siç mund të vërejmë, janë shumica absolute për dhe rreth Kur’anit. Krahas tyre, hoxha ka bërë edhe recensimin e disa veprave, si:

<p>22.</p>	<p><i>Tabbiru-t-tejsir fi kiraat el-eimmeti-l-ashr</i></p> <p>E ka recensuar dhe ka dhënë shënime me vlerë, në bashkëpunim me Shejh Muhammed Sadik Kamhavin, që njëherësh është dhe student i tij. Është botuar nga Darul va’ji, në Halep, në vitin 1393 h. Ka 206 faqe.</p>
-------------------	--

<p>23.</p>		<p><i>Sherhu telbisil fevaid ve takribu el-mutebaidi ala ukajleti etrabil kasaid</i></p> <p>Fjala është për librin e famshëm të Shatibiut në lidhje me shkrimin e Mus’hafit. Ka 298 poezi. I përket llojit të poezive Bahru-l-besit. Fillon me këtë varg:</p> <p>الحمد لله موصولا كما أمر - مباركا طيبا يستنزل الدررا</p> <p><i>Falënderimi, pandarë, ashtu edhe siç ka urdhëruar, i takon Allahut të bekuar, të mirë, i Cili sjell furnizimin.</i></p>
<p>24.</p>	<p><i>Delilul hajran shebu mevridi-dh-dham’an</i></p> <p>Fjala është për poezinë ‘<i>Meuridu-dh-dham’an fi ilmi resmi-l-Kur’an</i>’, e cila ka 454 vargje, të tipit Bahru-r-rrixhz. Vargjet janë përpiluar nga Ebu Abdullah Muhammed Ibn Muhammed Ibn Ibrahim el-Emevijj esh-Sherishijj, i njohur me emrin Harraz. Ndërsa ai që i komentoj këto poezi është dijetari Ibrahim Ibn Ahmed el-Margani nga Tunizia. Shejh Abdul Fettah Kadiu e ka recensuar këtë libër dhe ka dhënë shënime me vlerë për të. Libri ka 479 faqe dhe është botuar në Kajro, nga Daru-l-Kur’an¹.</p>	

Shumica e veprave të hoxhës janë të përfshira si burime dhe referenca në kurrikula e programe studimore në Az’har dhe vende tjera islame².


¹ El-Kari, El-Alametu esh-Shejh Abdul Fettah el-Kadi ve etheruhu fi eddirasat el-kur’anijeh, f. 309-320.

² Në universitetin Ummu el-Kura në Mekke p.sh.

Se hoxha ynë kishte qëllime të pastra dhe të çiltra në përpilimin dhe shkrimin e këtyre veprave, përveç tjerash, flet edhe fakti i botimit të tyre tani nga Instituti për Kur'anin dhe Shkencat e tij Imam Shatibiu. Janë përmbledhur të gjitha veprat në shtatë vëllime dhe janë botuar nën mbikëqyrjen e nxënësit të tij, hoxhës dr. Abdul Aziz Abdul Fettah Kariu, *Allahu i shpërbleftë me të mira, të gjithë!*



Shejbu duke përcjellë leximin e boxhës Ali bin Mushrif el-Amerij. (Revista Dija)



Hoxha dhe profesori im prof. dr. Abdul Aziz Abdul Fettah kariu, nxënësi i Hoxhës Abdul Fettah Kadi, njëberësh profesor yni. Allahu na faltë neve dhe prindërit tanë, hoxhallarët dhe mësuesit tanë!

3. BIOGRAFIA DHE VEPRIMTARIA E IGNAZ GOLDZIHHERIT

Në këtë pjesë do ta trajtojmë biografinë e personalitetit të dytë, objektiv të studimit. Është i pamohueshëm fakti se ky personalitet, për të cilin do të flasim ka një pozitë të lartë dhe të respektueshme në botën e orientalistikës. Lartësimi i figurës së tij në mesin e evropianëve më ka provokuar që të merrem më shumë me të, për të parë nëse vërtetë është ashtu siç e trumbetojnë. Detajet që do t'i shpalosim në këtë studim janë shokuese.

Ignaz Goldziheri (Ignác (Yitzhaq Yehuda) Goldziher) ka lindur më 22 qershor 1850, në Székesfehérvár, Hungari. Rrjedh nga një familje hebreje¹. Ka qenë orientalist i njohur dhe themelues i mendimit bashkëkohor islam në Evropë. Familja e tij kishte famë dhe autoritet. Që nga fëmijëria është interesuar për librat e shenjtë të krishterëve dhe hebrenjve. Është shkolluar në Budapest, Berlin, Leipzig dhe Leiden, dhe këtë me bursë që merrte nga ministri hungarez i bujqësisë Baron Eötvös. Referuar disa burimeve, ai kishte fituar titullin doktor në të njëzetat e tij. Pastaj ishte kthyer në Budapest ku më 1872, ishte emëruar asistent në Universitet. Por, nuk do të qëndronte gjatë, sepse Ministria e Arsimit do ta dërgonte jashtë vendit në një ekspeditë me karakter shkencor. Kështu shkoi në Vjenë, Leiden, e pastaj në Kajro ku qëndroi për një kohë, për të vazhduar më pas me Sirinë dhe Palestinën. Ka qëndruar tërësisht tetë muaj, nga shtatori i vitit 1873 deri në prill të vitit 1874. Ishte studentë i vetëm evropian në

¹ Nuk ka qenë sionist, as ai dhe as familja e tij, me dëshminë se në vitin 1920, kur qe thirrur nga njëri prej miqve të afërt të tij, Max Nordau, për t'iu bashkuar në atë që më vonë do të quhej Universiteti Hebre (Hebrew University), ai kishte refuzuar me arsyetimin se nuk do ta linte Hungarinë, vendlindjen e të parëve të tij. Kështu shkruan gazeta Haretz, ndërsa kujton përvjetorin e vdekjes së tij.

Az'har që prezentonte në mexhliet e dijetarëve dhe në faljen e namazit të xhumasë.

Sipas disa burimeve, Goldziheri kishte përjetuar disa ndryshime shpirtërore e ideologjike, të cilat i kishin shkaktuar jo pak stres e telashe. Këtë mbase për shkak të keqardhjes së madhe që ndiente për shtrembërimet e shumta që kishin ndodhur në librin e tij fetar, në Teurat (Dhiatë e Vjetër). Aq shumë dëshironte që të paktën mësimet e fesë së tij, të ishin në një nivel me mësimet e Islamit. Ishte bindur se Islami është fe më ndryshe; e gjallë, aktive, bashkëvepruese me çdo kohë e rrethanë, e përhershme. Siç kanë përmendur biografët e tij, përshtypja e tij për Islamit ishte se, Islami është një version i avancuar i fesë hebreje dhe të krishterë. Mund të konstatojmë se thellë në shpirt, ai ndiente se feja hebreje dhe e krishterë qenë deformuar e shtrembëruar dhe se vetëm Islami është version origjinal i mesazhit hyjnor. Këtë mund ta gjejmë dhe në një prej shkrimeve të tij ditore në gazetën gjermane¹: *“Gjatë kohës së studimeve, pata arritur të depërtoj thellë në shpirtin e Islamit, aq thellë sa që brendapërbrenda besoja se jam mysliman. U pata bindur dhe pata zbuluar se feja e vetme që arrin mendjet filozofike t'i bind me kredon dhe principet e veta është Islami. Qëllimi im kryesor ishte që fenë hebreje ta ngriti në këtë nivel racionalizmi dhe qartësie. Përvoja ime e gjatë në islam më ka mësuar se, Islami është feja e vetme në mësimet e së cilës nuk ka besëtytni dhe ide regresive. Islami është i ndërtuar mbi mësimet hyjnore...”*²

Dëshmitar i këtyre dyshimeve dhe kësaj gjendje të çrregulluar shpirtërore, madje pak para vdekjes së tij është edhe njëri nga nxënësit e tij të afërt, Bernard Helleri, i cili e kishte vizituar ndërsa në duar i kishte gjetur dy libra, në njërin dorë biblën ndërsa në tjetrën një libër të letërsisë në gjuhën arabe.

Goldziheri i qe drejtuar Hellerit me këto fjalë: “Nuk e di nëse është e drejtë të thellohem në letërsinë arabe, kur nesër do të

¹ *Tagebuch*, edited by Alexander Scheiber, Leiden: Brill, 1978, pg: 59.

² Encyclopædia Britannica, 11th Edition - <https://www.britannica.com>

qëndroj para Zotit dhe do të më pyesin: A ke vepruar me besnikëri?”¹

Përgjigja jonë: “Jo, për Zotin, jo, nuk je treguar besnik. Nuk e ke besuar Zotin e vërtetë, nuk e ke besuar në Muhamedin, pejgamberin e fundit, nuk e ke përqafuar Islamin, pavarësisht që e ke mësuar dhe e ke kuptuar se vetëm ai është i vërtetë. Pavarësisht, të gjitha këtyre, t’i zgjodhe të trasosh rrugën e refuzimit, mohimit, rrugën e shtrembër duke devijuar vet dhe duke i devijuar të tjerët.”

Sa i përket qëndrimeve politike, Goldziheri ka qëndrime më objektive. Ai kishte dalë kundër kolonizuesve francezë dhe anglezë. Sipas të dhënave, ai jo vetëm që kishte dalë kundër porse edhe përkrahte ringjalljen e lëvizjes islame të kryesuar nga aktivisti Xhemaluddin Afgani. Këtë më së miri e gjejmë në kujtimet e tij, në të cilat me tone të ashpra shprehet kjo revoltë dhe ky mospajtim me këto politika pushtuese. Ja çfarë thotë: *“Evropa ka shkatërruar çdo gjë të mirë në lindje. Arabët i ka munduar deri në vdekje, siç ka bërë Franca - aludon në pushtimin e Algjerisë dhe vendeve tjera afrikane ku kanë vrarë e masakruar miliona...”* Goldziheri nuk u ndal këtu. Guximi për ta shprehur këtë mospajtim ishte vërtetë për t’u lavdëruar. Gjatë qëndrimit në Kajro, ai madje dilte në ambiente publike, tregje më saktësisht, dhe kundërshtonte hapur pushtimin evropian... Referuar disa burimeve, Goldziheri ndante mendimin se liria e çifutëve duhet të ndodhë nëpërmjet integritit të tyre në shoqërinë evropiane, jo duke pushtuar një vend tjetër dhe duke grabitur e përvetësuar paligjshëm pronat dhe pasuritë e popullit të tij, siç kanë vepruar hebrenjtë që nga viti 1948 e këndej. Nga e tërë Evropa kanë mësyre Palestinën duke okupuar e pushtuar çdo ditë toka të reja brenda këtij shteti islam.

¹ <https://www.haaretz.com/jewish/.premium-this-day-islamic-studies-pioneer-dies-1.5289548>

Në fakt, nuk është i vetmi Goldziheri që mendon kështu. Se shteti sionist është hegjemonist dhe ka politika të tilla janë deklaruar edhe fraksione hebreje, të cilat i përmbahen mësimëve të Teuratit, si fjala vjen lëvizja *Neturei Karta* (sq. Rojtarët e qytetit) të cilët kundërshtojnë ashpër qeverinë dhe shtetin aktual sionist. Ata kanë bindjen se pushtimi i Palestinës është në kundërshtim me mësimet e Teuratit dhe vullnetin hyjnor. Zoti, i hidhëruar me ta, ka caktuar që ata të jetojnë të shkapërderdhur nëpër botë, jo të bashkohen në një vend të caktuar. Kjo për shkak se ata kanë thyer besën, kanë vrarë pejgamberët dhe kanë bërë e vazhdojnë të bëjnë krime e masakra, dhe këtë para syve të botës mbarë. Për më keq, bota vazhdon t'i mbështet dhe këtë në emër të kinse të drejtave, barazisë, paqes, civilizimit etj. Ja si shprehet në njëjës Goldziheri: *“Kur u ktheva nga Palestina, në Hungari ndjeja se po kthehem në shtëpinë time...”*¹

Në vitin 1889, në një prej traktateve të tij kishte shkruar se hebraizmi është nocion fetar i cili nuk ka të bëjë asesi me territor gjeografik apo vend të caktuar ku banojnë hebrenjtë. Sa i përket nënshtetësisë sime, unë, gjeografikisht, jam transdanubian, me përkatësi fetare jam hebre.



Godziheri ka vdekur në Budapest, në nëntor të vitit 1921, duke lënë pas vete vepra të shumta, prej të cilave do të veçojmë ato më të rëndësishmet që kanë lidhje me studimet islame:

¹ Për më shumë shih referencat e mëparshme, por edhe këtë përmbledhje biografike: : https://en.wikipedia.org/wiki/Ign%C3%A1c_Goldziher

- 1) Historiku i letërsisë shiite (*Zur Literaturgeschichte der Shi'a*), 1874.
- 2) Kontributi i dijetarëve në historinë e letërsisë arabe (*Beiträge zur Geschichte der Sprachgelehrsamkeit bei den Arabern*), 1871-1873.
- 3) Historiku i miteve hebreje dhe zhvillimi i tyre (*Der Mythos bei den Hebräern und seine geschichtliche Entwicklung*), Leipzig 1876, përkthyer në anglisht, më 1877 dhe botuar në Lodër.
- 4) Studime islame (*Muhammedanische Studien*), Halle, 1889-1890, dy vëllime.
- 5) Traktate në të kuptuarit e gjuhës arabe (*Abhandlungen zur arabischen Philologie*), Leiden 1896-1899, dy vëllime.
- 6) Shpirti i natyrës (*Buch v. Wesen d. Seele*), 1907.

Këto ishin disa nga veprat më të rëndësishme të tij, në të cilat mendojmë se është akumuluar i tërë munda dhe ideja e tij, përkitazi me Islamit dhe studimet rreth tij.

Në kapitullin vijues, duke iu referuar librit të tij *Doktrinat e interpretimit të Islamit*, do të trajtojmë vlerën që Goldziheri ka vjellë ndaj Kur'anit dhe kiraeteve të tij. Do të shohim po ashtu edhe kundërpërgjigjet që ka marrë nga dijetari i kohës sonë, hoxha i madh, dr. Abdul Fettah Kadi.



Kapitulli II:

**KLASIFIKIMI I DYSHIMEVE TË
GOLDZIHERIT DHE VOKABULARI I TIJ
DYSHUES PËRKITAZI ME KIRAETET
DHE KURRATË - LEXUESIT E
KUR'ANIT**

NATYRA E DYSHIMEVE TË GOLDZIHERIT DHE LLOJET E TYRE

Për kohë të gjatë jemi marrë me dyshimet e Goldziherit, të cilat i ka parashtruar për kiraetet e Kur'anit në dy kapitujt e librit të tij *Doktrinat e interpretimit të Islamit*, përkatësisht në faqet 3-72. Pas shqyrtimit dhe analizimit të tyre në detaje dhe pas përfshirjes së një pjese të tyre në kuadër të planprogrameve të studimeve master¹, kemi ardhur në përfundim se klasifikimi i tyre mund të bëhet si më poshtë:

- 1) Dyshime mbi besueshmërinë e revelatës kur'anore të shpallur me kiraete të ndryshme, krahasimin e tyre me tekstet e dhiatës së vjetër dhe mbështetjen në burime hebreje².
- 2) Kritikë e akuza përkitazi me besueshmërinë e elementit historik, përkatësisht periudhës historike të shpalljes, tubimit dhe shumëzimit të Kur'anit³.
- 3) Kritika dhe akuza përkitazi me shokët e Pejgamberit ﷺ dhe besueshmërinë e tyre në përcjelljen e Kur'anit. Tre nga Sahabet e apostrofuara prej tij janë: Ubej bin Ka'bi r.a., Abdullah bin Mes'udi r.a., dhe Zejd bin Thabiti r.a.⁴
- 4) Dyshime përkitazi me çështje të kredos islame⁵ dhe provokimin e debateve ndërmjet Ehlu Sunnetit dhe disa grupeve fetare, si mu'tezilitët, shiitët⁶, etj.

¹ Në Fakultetin e Studimeve Islame, në Universitetin Hamad bin Halife, në Katar, si profesor vizitor, në vjeshtën e vitit 2017.

² Shih librin e tij *Medhabib et-tefsir el-islamij*, f. 12; 32; 36; 53, ku edhe pretendon se shtatë hurufet janë të ngjashme me gjuhët e Teuratit, i cili sipas tij është shpallur në shumë gjuhë.

³ Po aty, f. 46, 47.

⁴ Po aty, f. 18, 19, 45.

⁵ Shih: *Medhabib et-tefsir el-islamij*, f. 22, 23.

⁶ Po aty, f. 14, 44.

- 5) Dyshime përkitazi me aspekte gjuhësore dhe gramatikore, nëpërmjet shpalosjes së dallimeve ndërmjet basrasëve dhe kufasëve¹.
- 6) Dyshime përkitazi me çështje të fikhut, si: lejimi i martesës mut'ah, justifikimi i mes'hit të këmbëve në abdes².
- 7) Mbështetja në kiraete të refuzuara, të cilat nuk përputhen me resmin uthman³ dhe nuk janë mutavatire.
- 8) Mbështetja në transmetime *ahad* dhe *shadh* të cilat ndeshen me transmetimet *tevatir*⁴.
- 9) Mbështetja në disa tekste të rralla të disa dijetarëve myslimanë, veçmas në tefsiret e Taberit dhe Zemahsherit, pastaj thirrja në Kadi Shurejhun, Dahhakun, Seid bin Musejjibin⁵.
- 10) Mbështetja në interpretimet personale të disa Sahabëve, të cilat i kishin shkruar në kopjet personale të Kur'anit për ta pasur të qartë kuptimin e ajetit. Goldziheri këto interpretime i ka marrë si kiraete të Sahabëve.⁶
- 11) Dyshime përkitazi me hadithet e Pejgamberit ﷺ duke i përshkruar si të papërputhshme dhe kontradiktore ndërmjet vete, madje gjithnjë sipas tij, edhe më kontradiktore se Kur'ani. Po ashtu edhe mbështetja te disa prej qëndrimeve të Pejgamberit ﷺ, si p.sh., mërzia për humbjen e romakëve të krishterë përballë persianëve zjarrputistë. Këtë e ka bërë duke iu referuar një kiraeti

¹ Po aty, f. 41, 42, 43, 46, 47.

² Po aty, f. 14, 23.

³ Resmi Uthman është forma dhe mënyra e përvetësuar nga halifeja Uthman bin Affani r.a., dhe e miratuar nga Sahabet për shkrimin e fjalëve të Kur'anit dhe përshkrimin e germave të tij në mus'hafet të cilat i dërgoi gjithandej botës së atëhershme islame. Përkthyesi.

⁴ Po aty, f. 22, 23, 58.

⁵ Po aty, f. 27, 28, 29.

⁶ Po aty, f. 37, 38, 39.

ahad, i cili i atribuohet Aliut r.a. dhe Ebu Seid Hudriut r.a., dhe sipas të cilit, ajetet 2 dhe 3 nga kaptina Rrum lexohen: “وَهُمْ مِنْ بَعْدِ غَلَبِهِمْ” - “Kanë triumfuar bizantinët!” dhe “غَلَبَتِ الرُّومُ” - “por ata pas thyerjes së tyre, me siguri do të munden”¹. Për ta dokumentuar kinse qëndrimin e tij, ka hulumtuar për kiraete shadhe, si këto që i përmendëm, pas të cilave ka dalë me konstatimin e tij të marrë: “...dy lexime dhe dy interpretime të një fjalisë të vetme nga fjalët e Zotit (Kur’ani), e të cilat janë kundërtë në mes vete sa s’bën”².

- 12) Përpjekje e dështuar për t’i mbrojtur dhe justifikuar sektet dhe grupet devijante dhe idetë e qëndrimet e tyre. Këtë e ka bërë me pretekstin se në librin e tij, çdokush mund ta gjejë atë që kërkon. Këtë e ka bërë duke ngre paralele ngjashmërie ndërmjet dallimeve në kiraete me dallimet e sekteve hebreje dhe të krishtera me tekstet e librave të tyre të shtrembëruar (versionet e shumta të Biblës). Shih për këtë qëllim edhe e ka hapur librin e tij me një thënie të një teologu të krishterë, Peter Werenfels³, e madje ka shkuar aq larg sa që konsideron se përkthimet e Dhiatës së Vjetër janë më cilësore gjuhësisht dhe metodikisht se kiraetet kur’anore⁴.
- 13) Thirrja e padenjë dhe larg kriterëve shkencore e akademike në dijetarët myslimanë. Këtë mund ta gjejmë tek thirrja e

¹ Ndërsa sipas leximit mutevatir është: “وَهُمْ مِنْ بَعْدِ غَلَبِهِمْ سَيَغْلِبُونَ” - “...por ata pas thyerjes së tyre, me siguri do të fitojnë.” Dr. Abdul Fettah Kadiu ka shpjeguar se leximi i lartëpërmendur nuk është i pranueshëm nga dhjetë Imamët, e madje nuk është as nga leximet shadhe që i atribuohen katër Imamëve tjerë, dhe rrjedhimisht refuzohet. Shih: *El-kira’at fi nadhari el-mustesbrikine*, f. 122.

² Po aty, f. 30, 31, 44.

³ Po aty, f. 1, 31.

⁴ Shih këtë në librin *Medbahib et-tefsir*, f. 5-72.

tij, në mendimet dhe qasjet e Imam Sujutit, *Allahu e pastë mëshiruar!*¹

- 14) Mbështetja në referenca dytësore dhe jo të besueshme, si fjala vjen librin *El-hajevan* të Xhahidhit², pastaj kërkimit dhe hulumtimit për transmetime dhe rrëfime të çuditshme e të refuzuara në disa referenca historike dhe gjeografike, si libri *Mu'xhem el-buldan* të Jakut Hameviut, *Itkan* të Sujutit, *Tedhkiretu el-Hufadh* të Dhehebiut, etj. Goldziheri i referohet disa rrëfimeve fyese dhe përbuzëse që i bëhen Kur'anit dhe leximeve të tij, si p.sh., rrëfimi për një përqeshës e fytes të Kur'anit nga radhët e kurdëve në Irak, i cili ajetin kur'anor: “الأعراب أشد كفرةً ونفاقاً” – “*Beduinët janë mohuesit dhe hipokritët më të mëdhenj (se tjerët)...*”³ e lexon duke e ndërruar fjalën -arab me -kurd: “الأكراد أشد كفرةً ونفاقاً” – “*Kurdët janë mohuesit dhe hipokritët më të mëdhenj (se tjerët)...*” Kur ky tallës e përqeshës që ndaluar nga ky veprim i gabuar, kishte thënë: Allahu nuk ka shkuar në Sharizor (vendbanimin e tij) që ta dijë gjendjen e kurdëve atje!⁴ I pastër nga të metat është Allahu! Sa fjalë të rëndë që ka thënë! Padyshim, një fjalë e tillë konsiderohet mëkat i madh, që njeriut ia humb përkatësinë islame. Pra, i tillë konsiderohet të ketë dezertuar nga feja, sepse kështu gjykohet tallja me fenë dhe mësimet e saj.
- 15) Fokusimi tek rastet e kurrave apo lexuesve të njohur për lexime të refuzuara nga komuniteti mysliman. Goldziheri i është referuar Ibën Shenbudhit⁵ dhe Ibën Mukle Ebi Bekir

¹ Po aty, f. 32.

² Po aty, f. 62.

³ Kur'ani: Teube: 97.

⁴ *Medhabib et-tefsir*, f. 63.

⁵ Ibën Shenbudhi ka qenë Imam i irakianëve në kiraet. Ka vdekur në vitin 328 h. Ai nuk ka ndjekur linjën tevatur në kiraet, prandaj leximet e tij janë shadhe dhe të papranueshme.

Attarit¹, të cilët për leximet e tyre të gabuara janë ndëshkuar e madje publikisht janë penduar dhe kanë shpallur se nuk i mbrojnë më ato lexime. Leximet e tyre në fakt nuk kanë qenë as *shadhe* sepse nuk kanë pasur asnjë transmetim, kanë qenë thjeshtë shpifje e sajime².

- 16) Akuzimin e qeverive dhe pushtetarëve të asaj kohe se, duke mos lejuar leximet e gabuara, ata kinse po penguan të drejtat e njerëzve (për t'u shprehur)³.
- 17) Në metodologjinë e Goldziherit vërehet çekuilibër i madh. Njëherë e gjen tek hedh dyshime e akuza duke u shërbyer me transmetime të pasakta, siç do të shohim në pjesën në vazhdim kur të flasim për vokabularin e tij dyshues, e herën tjetër e gjejmë tek ngrit në qiell metodologjinë e dijetarëve myslimanë, veçmas lexuesve të dalluar për mjeshtërinë dhe profesionalizmin e të cilëve nuk ngurron të flet në shkallën superiore. Vërtetë, shumë kundërthënës! Ja disa prej frazave dhe shprehjeve që ka përdorur për lexuesit e njohur të Kur'anit: “*lexues të besueshëm*”; “*të pranuar*”; “*lexues ekspertë*”; “*leximet e lexuesve në të cilat mbështetet*”⁴; “*Kur'ani ofron kriter të saktë të përdorimit arab dhe jo anasjelltas*”⁵; “*e ka lexuar një grup prej lexuesve të besueshëm*”⁶; “*lejimi i vërtetimit të ndonjë tefsirin / interpretimi në mus'hafë edhe nëse nuk e beson për Kur'an*”⁷; “*nuk ka pajtuar askush prej lexuesve të besueshëm*”⁸, etj.

¹ Attari është pjesë e shkollës së Ibën Shenbudhit. Ka vdekur në vitin 354 h. Shih: *El-kira'at fi nadhari el-muestesbrikinë*, f. 180.

² *Medhabib et-tefsir*, f. 65, 66, 67.

³ Po aty, f. 64, 65.

⁴ *Medhabib et-tefsir*, f. 64, 66.

⁵ Po aty, f. 6.

⁶ Po aty, f. 68.

⁷ Po aty, f. 10.

⁸ Po aty, f. 37.

- 18) Goldziheri ka dhe një problem tjetër. Ofiqet dhe titujt që iu jepen dijetarëve të pranuar, i përdorë edhe për lexuesit, të cilët nuk janë të pranuar dhe madje as të njohur. P.sh., i referohet Dahhak bin Muzahimit për një lexim duke e cituar si një prej lexuesve të besueshëm¹ dhe të pranuar ndërsa ai as nuk është i njohur dhe aq më pak të jetë lexues i besueshëm e i pranuar.
- 19) Mbështetje e parezervë e të gjithë atyre që kanë kundërshtuar Ehlu Sunnetin dhe kanë ndjekur rrugë tjetër në fushat fetare e politike. Qasja e tij plot dhembshuri karshi dijetarëve që kanë përvetësuar qasje të ndryshme ose thënë më mirë të refuzuara duke u shfaqur si prind i dhembshur, si vendstrehim dhe çerdhe e ngrohtë për ta, dhe këtë pavarësisht se prej cilave fusha shkencore kanë ardhur. Kur u bë ujku i mëshirshëm me kopenë?! Kushdo që e shfleton historinë e kupton se këtu prapa këtij imazhi të dhembshurisë fshihet ujku i vërtetë. A nuk janë kolonizuesit francezë, britanikë e amerikanë, ata që me pretekste të këtilla të dhembshurisë e ndërhyrjes kinse në emër të vlerave e humanizmit kanë pushtuar vendet islame! A nuk janë ata që me parimin djallëzor “përçaj e sundo” vazhdojnë ta bëjnë një gjë të tillë edhe sot e kësaj dite. Goldziheri ka përdorur këtë metodologji për ta mbjellë farën e përçarjes në mesin e myslimanëve dhe për të hedhur dyshime në burimet e tyre kryesore, Kur’an dhe Sunnet, dhe këtë gjatë tërë jetës dhe në të gjitha veprat e veta².
- 20) Justifikimin dhe arsyetimin e leximeve të dobëta dhe të papranuara, duke iu referuar aspekteve gjuhësore dhe

¹ Po aty, f. 47.

² *Medhabib et-tefsir*, f. 37.

retorike e duke injoruar me apo pa qëllim¹ mënyrat dhe metodat e retorikës kur'anore. P.sh., duke iu referuar ajetit 9 nga kaptina Huxhurat: “وَإِنْ طَائِفَتَانِ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ اقْتَتَلُوا فَأَصْلِحُوا” “بَيْنَهُمَا”, ai mundohet ta dokumentojë kinse shpërputhjen që ekziston ndërmjet rregullave të gramatikës së arabishtes dhe ajeteve kur'anore. Më saktë, fjalën **iktetelu**, që ka ardhur në shumës, e lexojnë ndryshe, gjegjësisht *ikteteleta* (اقتلتنا) sipas Ibën Ebi Ables ose *iktetela* (اقتلنا) sipas leximit të Ubejd bin Umejrit, për faktin se, gjithnjë sipas tij, përemri i shumësit në fjalën **iktetelu** është në gjininë mashkullore, përderisa bëhet fjalë për **taifetani** që është në gjininë femërore duhet të jetë shumës i gjinisë femërore, pra kështu siç e kanë lexuar Ibën Ebi Able apo Ubejd bin Umejri².

- 21) Tallja me leximet kur'anore duke i konsideruar se janë material zbavitës. Goldziheri i referohet disa rrëfimeve fantastike në shkresën e poetit Ebu el-Ala el-Mearri drejtuar shokut të vet, Ibën Mensurit: “Xheneti dhe xhehenemi sikur janë dy shokë, që ecin në xhennet dhe bisedojnë me njëri-tjetrin duke u çuditur e pyetur për fatin

¹ Po aty, f. 65, 66, 67. Ka justifikuar dhe mbrojtur madje ata që njiheshin për kiraete shadhe, si Ubejd bin Umejrin, Ibën Ebi Ablen, Ibën Shenbudhin, etj.

² Dijetarët dhe mufessirët e mëdhenj kanë shpjeguar se sekreti i këtij përdorimi qëndron në kuptimet madhështore që fshihen në këto shprehje, por edhe në vet aspektin tekstual të tyre. Më qartë, është thënë se kur grupet përplasen ndërmjet vete është e vështirë t'i dallosh, prandaj edhe janë përmendur në shumës, përderisa në rastet kur bëjnë paqe, dallojnë andaj edhe është përmendur në dysi. Shih: El-kiraat fi nadhari el-musteshrikine, f. 199. Kështu ka thënë edhe Alusi: “Tu është referuar në shumës për shkak se secili grup në vete janë shumë, dhe, se kur fjalosen a kacafyten, përzihen, kështu që iu drejtohet të gjithëve në shumës ndërsa kur bëjnë paqe, dallohen, andaj ndahen në dy grupe dhe iu është referuar në dysi.” Shih: Tefsir Alusi, vëll. 26.

e poetëve në ferr (shumica e të cilëve janë në xhehenem).... Pastaj se si ata kishin parë në Firdeus, poetë nga periudha paraislamike, poetë idhujtarë, të cilët dëfreheshin me të mirat e Xhenetit, ngase Zoti i kishte falur për vargjet që kishin thurur për moralin e mirë dhe fenë e pastër. Ndërsa bisedonin dhe shëtisnin, dy shokët arrijnë tek një kopsht i bukur në të cilin shohin gjarpërinj që bisedonin me gaz e hare...!! Xhinët, në formë të gjarpërinjve, paskëshin prezentuar në mësimet e disa dijetarëve. Pas vdekjes së Hasan Basriut, ata shkuan në shtëpitë e lexuesve të Kur'anit, përkatësisht në shtëpitë e Ebu Omer bin Alaut dhe Hamza bin Habibit, prej të cilëve mësuan detaje interesante dhe të çuditshme të kirateve.”

Sigurisht, qëllimi i tij ishte të tallej e përqueshej me kiraetet dhe kuratë¹.

Në fund të këtij klasifikimi të dyshimeve më duhet të shtoj diçka. Allahu i mëshiroftë dhe i faltë dijetarët tanë të mëdhenj si Taberiu, Zehmasheriu, Jakut Hameviu, Xhahidhi, Sujuti, e të tjerë, të cilët hapën derën e transmetimeve shadhe, qoftë në fushën e kiraeteve qoftë në fusha tjera, të cilët, me gjithë qëllimin e mirë që kishin, ofruan material helmues për armiqtë dhe dashakëqijtë e Kur'anit, Sunetit dhe historisë e civilizimit islam. Mundi dhe angazhimi i tyre është keqpërdorur nga këta dashakëqij për ta sulmuar fenë dhe për t'i përbaltua mësimet e saja. Do të kishte qenë shumë me e rrugës sikur mos t'i përmendnin fare këto transmetime të pavlera, edhe nëse kanë ekzistuar praktikisht, sepse jo çdo gjë që dihet thuhet, dhe se kështu sikur po tërhiqe një paralele krahasimi e ngjashmërie ndërmjet tyre dhe ndërmjet transmetuesve të rrëfimeve të rremë e israilijateve.

¹ *Medhabib et-tefsir*, f. 70, 71, 72.

VOKABULARI DYSHUES I GOLDZIHERIT PËRKITAZI ME KIRATETET KUR'ANORE

Kushdo që e shfleton librin e Goldziherit, Doktrinat e interpretimit të Islamit, do të gjejë se shprehjet dhe fjalori që ka përdorur për të ngjallë dyshime, përkitazi me të vërteta islame e kur'anore dallojnë sipas tekstit kur'anor. Disa prej shprehjeve që ka përdorur: “*e vëmë re në formulimet e tij të ndryshme...*”; “*nuk është unik në detajet e tij...*”; “*transmetimi i fjalës së Zotit në forma të ndryshme...*”; “*përdoret në farzet e adhurimit sipas një sistemi jo uniform*”; “*kiraete që dallojnë goxha shumë, dallim ky që nuk është i parëndësishëm...*”; “*anohet kah tolerimi në dallimin e kiraeteve...*”¹

Përgjatë hulumtimit kam vënë re, se ai nuk ka mjaftuar thjeshtë me shprehjet që përmendëm më lartë, porse ka përdorur edhe të tjera, si: “*...angazhimi në ndreqjen e tekstit*”²; “*...kishte një lloj lirie konsekuente që pothuajse arrinte në limitin e lirisë individuale...*”; “*...liri sikur kejo nuk nxit dhe as nuk motivon besimin e fuqishëm në ruajtjen e tekstit hyjnor...*”; “*...ndërkohë që parregullsitë e shumta të tekstit kur'anor...*”; “*...lindi nevoja për ta vënë një pengesë të hekurt para lirisë që ekzistonte në trajtimin e tekstit hyjnor...*”; “*...në çështjen e tekstit kur'anor ka ndodhur po kështu një lloj kompromisi dhe marrëveshje ndërmjet lirisë individuale dhe kërkesave për ujdisje ndërmjet kiraeteve të ndryshme...*”; “*...përkufizimi në shtatë hurufe ka synuar që të ta stopojë këtë lirinë e leximit individual të Kur'anit që shkonte duke u zgjeruar...*”; “*...pra, këto janë dy lexime dhe dy interpretime të ndryshme të një fjale të Zotit, kundërbënëse ndërmjet vete sa nuk bën...*”; “*...ky përcaktim është absolutisht risi e gjeneratave të mëvonshme që nuk ka asfare lidhje në transmetimin e hershëm...*”; “*...u njohëm me dy shokët (e Pejgamberit*

¹ Shih: Xhebel, *Err-rredu ala el-musteshbriki el-jehudij Goldziher fi metainihi ala el-kiraat el-kur'anijeh*, f. 12-70.

² Pasi që ai konsideronte se teksti kur'anor karakterizohej për nga parregullsia. Këtë shpjegim e jep Xhebeli në punimin e vet kushtuar kiraeteve, f.15. Përkthyesi.

Muhammed ﷺ), *Abdullah bin Mes'udin dhe Ubej bin Ka'bin, të cilët janë burimi i ndryshimeve më të mëdha që kanë depërtuar në tekstin kur'anor...*"; "...kërkesa që kiraetet të përputhen me rregullat e gjuhës arabe është masa e thellë e kufizimit të lirisë dhe është kusht që në fakt nuk përkon me leximet e dy imamëve (Ibën Mes'udit dhe Ibën Ka'bit)..."; "...gjithnjë ka pasur emra që kanë qenë të pavarur në mendim..."¹; "...këtu, ai sunniti, kundërshtar i Zemahsberiut, solli dëshmi të mbledhura nga poezitë..."²; "...qarkullon një formë e këtillë e parregullsisë dhe paqëndrueshmërisë siç e gjejmë në tekstin kur'anor..."; "animi për ta unifikuar tekstin bazë është diçka e huaj për Islamin apo të paktën është gjë e parëndësishme..."; "...nuk ka tekst të unifikuar të Kur'anit..."; "...është pasion për unifikim i cili mund të jetë i pranuar..."; "...në një tekst i cili parimisht nuk ka qenë i pikëzuar³ dhe as që është bërë përpjekje për saktësi e korrektesë në pikëzim apo vokalizim....."; "...ajo që figuron në Eksod (kapitull në Bibël), 32/27, e që është burim i fjalëve të Kur'anit..."⁴; "...me një ndryshim të thjeshtë të vokaleve, përemrin e vetës së parë e kanë shndërruar në vetën e dytë..."⁵; "...kjo vrazhdësi dhe pagdhendësi ka fshirë leximin e Kesaiut në kaptinën Jusuf, ajeti 81: "إِنَّ ابْنَكَ سُرِقٌ"⁶; "...në ndërkohë që këta dy Sahabe nuk janë të vetmit, të cilët përmendën për futjen e shesave në tekstin e njohur të Kur'anit ..."; "...edhe pse tekstet profetike qysh në fillim dallohen për parregullsi më të madhe se teksti kur'anor..."⁷; "...synon

¹ Shih librin e Goldziherit *Doktrinat e interpretimit të Islamit*.

² Goldziheri, *Medhabib et-tefsir el-islamij*, f. 69; Tavili, *Fi ulum mel-kiraat – med'hal ve dirasetun*, f.19-85.

³ Në gjuhën arabe gerमत dallojnë ndonjëherë dhe sipas pikave që kanë sipër ose poshtë, p.sh., germa n (ن) ka pikën sipër, përderisa germa b (ب) ka pikën poshtë. Përkthyesi.

⁴ Referenca paraprake, f. 4-10.

⁵ Për qëllim është ajeti 12 nga kaptina safat.

⁶ Përkthehet: "Biri yt është vjedhur...". Në leximin e pranuar është: "إِنَّ ابْنَكَ سُرِقٌ" – "...biri yt ka vjedhur...". Përkthyesi.

⁷ Referenca paraprake, f. 44.

ndreqjen e tekstit bazë të cilin e kanë prishur (gabuar) shumëzuesit¹...shumëzuesi jovigilent...’’²

Siç mund të shohim, gjithçka për çka bëhet fjalë është gënjeshtër, sajësë, shpifje dhe trillim, gjëra këto që do të marrin përgjigjet konkrete nga hoxha dhe eksperti i kiraeteve, dr. Abdul Fettah Kadiu, *Allahu e pastë mëshiruar!*

VLERËSIMI I PERSONALITETIT TË GOLDZIHERIT SIPAS KRITEREVE SHKENCORE DHE AKADEMIKE

Për çudi, për Goldziherin që ka qëndruar vetëm disa muaj në tokat arabe (Palestinë, Siri dhe Kajro), thuhet se është arabolog i rryer. Në fakt, kjo e dhënë është ajo që vë në pikëpyetje dhe dyshim kompetencën dhe kapacitetin e tij për arabishten, veçmas për thellimin në shkenca të cilat kërkojnë njohuri të thella në arabishte dhe shkenca tjera, siç është Shkenca e Kiraeteve objekt studimi në këtë punim.

Në këtë përfundim kemi ardhur, derisa i kemi parasysh gjërat në vazhdim:

1. Tradita dhe zakoni.

Sipas disa burimeve që e kanë hiperbolizuar figurën e Goldziherit, ai për vetëm disa muaj – 8 muaj - kishte arritur ta përvetësonte arabishten në nivele shumë të larta. Kjo çështje, vështruar sipas asaj që është e njohur në tokat tona, në Evropën Juglindore, është e pamundur të arrihet për një periudhë kaq të shkurtër.

Dikush mund të pyet: përse nuk është e mundur një gjë e tillë?

¹ Kopjet e Kur’anit janë shumëzuar me dorë, pra janë shkuar nga njerëz të përzgjedhur për këtë punë. Janë këta pikërisht që sulmohen nga Goldziheri. Përkthyesi.

² Referenca paraprake, f. 46.

Përgjigjia jonë është se, duke qenë se edhe ne, autor i këtij punimi, vijmë nga Ballkani, dhe e njohim mirë historikun e popujve të Ballkanit dhe karakteristikat e tyre, dhe duke marrë parasysh përvojat e shumë dijetarëve, hoxhallarëve e intelektualëve që kanë mbaruar studimet gjithandej nëpër vendet arabe e islame, themi se ne nuk kemi ndëgjuar për raste të tilla, dhe është e pamundur që për një periudhë të tillë dikush të shndërrohet në referencë të gjuhës arabe, ashtu siç e konsiderojnë Goldziherin në Evropë.

Pastaj përvoja e autorit të këtij punimi që ka kaluar tri dekada të tëra në tokat arabe, gjashtë vite në Siri e katra tjera në Medinën e Resulullahit ﷺ, e pastaj edhe vite tjera si mësimdhënës universitar në Medinë, Katar dhe në vende tjera, në Azinë Juglindore, Malajzi, Brunei, them se kjo është e pamundur sepse, pavarësisht kësaj kohe të kaluar duke nxënë e duke dhënë dije, themi se ende gjejmë vështirësi për ta përsosur gjuhën arabe dhe për ta zotëruar deri në nivele mjeshtërie, e si mundet ai që për 8 muaj të jetë arabolog i madh!!

2. Goldziheri është figurë shkencore e hiperbolizuar.

Pyetje që lind vetvetiu në këtë kontekst:

Si pati mundësi që Goldziheri t'i shkruajë të gjitha ato vepra në gjermanisht, përveç një numri të vogël të tyre, dhe çfarë i dha atij aq kompetencë shkencore, që të hedh dyshime deri në këtë masë përkitazi me të vërtetat kur'anore dhe profetike?

Përgjigjia: pas shqyrtimit dhe analizimit kritik e shkencor, kemi ardhur në përfundim se kjo mund të ketë ndodhur për njërin prej dy shkaqeve, që nuk kanë të tretë:

- 1) Goldziheri ka jetuar, është edukuar dhe formuar duke iu referuar veprave të orientalistëve të mëhershëm gjermanë, si: Heinrich Leberecht Fleischer (1801 – 1888), Julius Wellhausen (1844 – 1918), Theodor Noldeke (1836 – 1930) të cilin e quante si mësues të madh në trajtimin e

çështjeve që kanë të bëjnë me kiraetet¹ dhe të cilin e kishte referencë të parë dhe të fundit në citimin e meseleve të diskutueshme, William Muir (1819 -1905).

Goldziheri po ashtu ka jetuar dhe është formuar duke iu referuar veprave të bashkëkohësve të tij gjermanë, si: Joseph Schacht (1902-1969), Carl Brockelmann (1868 – 1956), Regis Blachere (1900 -1973).

- 2) Këto dyshime dhe kritika janë bërë në përputhje me një metodologji dhe sistem të programuar, të mbështetur materialisht e të monitoruar nga qarqe shtetërore e qeveritare, ndryshe është e pamundur që deri në detaje të këtilla të trajtohen këto çështje nga një njeri i vetëm. Puna e Goldzisherit në këtë rast mund të ketë qenë ripërshkrimi i tyre, sipas një modeli dhe formulimi të ri të pranuar për ta. Kjo edhe mund ta ketë bërë të famshëm në mesin e tyre². Ka qenë e rrugës që të mos e bënte këtë, por ta ndiqte të vërtetën dhe ta pasonte atë por jo, ai zgjodhi rrugën e mosmirënjohjes ndaj dijes, refuzimit të të vërtetave, mohimit të qëllimshëm të tyre, që t'i shërbente kështu një kauze aspak shkencore dhe aq më pak humane.

Para se t'i trajtojmë shkencërisht dyshimet dhe kritikën e Goldzisherit, e shohim të rrugës të ofrojmë disa shpjegime me rëndësi të veçantë për disa prej koncepteve dhe botëkuptimeve, që kanë të bëjnë me kiraetet si shkencë, llojet e tyre, lexuesit më të njohur dhe transmetuesit e tyre.

¹ Goldziheri, *Medhabib et-tefsir el-islamij*, f. 7.

² Se Goldziheri ka gabuar dhe nuk ka qenë i saktë në përshkrimin e referencave të kërkuara, flet edhe Mustafa Sibai i cili në Holandë qe takuar me Shahtin, me të cilin kishte diskutuar gjatë përkitazi me atë se si Goldziheri kishte gabuar qëllimisht në shtrembërimin e teksteve, të cilat i merrte prej burimeve islame. Fillimisht Shahti e kishte mohuar një gjë të tillë, por pas dëshmimeve përkatëse e kishte pranuar se Goldziheri e kishte bërë një gjë të tillë...Shih: Vezan, *El-istishrak ve-l-musteshrikeune*, f. 96-97.

Kapitulli III:
SHKENCA E KIRAËTEVE,
DISIPLINAT E SAJ, DALLIMET
NDËRMJET KIRAËTEVE DHE
RIVAJETEVE, DHJETË LEXUESIT DHE
TRANSMETUESIT E TYRE

Ky kapitull ka rëndësi të veçantë, për faktin se në të parashtrihen disa mesele me rëndësi të veçantë sa i përket çështjes së kiraeteve e të cilat lexuesi i nderuar duhet t'i dijë.

1.

E shohim të rrugës të fillojmë me përcaktimin e kuptimit shkencor të kiraeteve, respektivisht asaj se çfarë nënkuptohet me Shkencën e Kiraeteve?

Në librin *It'hafu fudalai el-besher fi el-kiraati el-erbeati asher* këtë shkencë e ka definuar si më poshtë:

“Shkenca e Kiraetit është shkencë nëpërmjet së cilës mësohet për pajtimet dhe dallimet e transmetuesve të leximit të Kur'anit, përkatëzi me atë se kur dubet fshirë një fjalë e kur dubet vërtetuar, kur dubet vokalizuar e kur jo, kur dubet shkëputur e kur dubet lidhur, e gjëra tjera nga pikëpamja e dëgjimit, si: forma e shqiptimit, ndërrimi, zëvendësimi, etj.”

Ose mund të definohet si:

“Shkenca e mënyrës së interpretimit të fjalëve kur'anore dhe dallimit ndërmjet tyre duke ia atribuuar transmetuesit përkatës.”¹

2.

Sa i përket sqarimit të kuptimit të *kiraetit*, *rivajetit*, *tarikut*, dijetarët kanë dhënë këto shpjegime:

- 1) Kiraet quhet secili dallim në performim që i atribuohet një Imami për profesionalizmin dhe mjeshtërinë e të cilit janë të një mendimi *ruvatët* (transmetuesit).
- 2) Rivajet quhet çdo gjë që i atribuohet transmetuesit nga Imami.

¹ Benna, *It'hafu fudalai el-besher bi-l-kiraati el-erbeati ashere*, f. 6.

- 3) Tarijk quhet çdo gjë që i atribuohet një marrësi nga transmetuesit edhe nëse nuk është shumë kredibil¹.

3.

Ndërsa sa i përket llojeve të kiraeteve nga aspekti i transmetimit të tyre, Imami i njohur Muhammed bin Xhezeriu, në librin *Munxhid el-mukriine ve irshadu et-talibine* ka thënë: “Kapitulli II: Rreth Kiraetit mutevatir, sahih dhe shadh” për të vazhduar më pas me shpjegimet:

Kiraeti mutevatir

“Secili lexim që përputhet absolutisht me arabishten dhe me ndonjërin prej mus’hafëve të Uthmanit, qoftë edhe të supozuar por të përcjellë në mënyrë tevatir, atëherë për këtë lexim thuhet se është mutevatir dhe i pa mëdyshe në të.”

Shpjegimi i këtij definicioni:

- **“që përputhet absolutisht me arabishten”** qoftë edhe me ndonjë formë të gramatikës, si p.sh., leximi i Hamzait në rasën gjinore të fjalës “وَالْأَرْحَامُ” në ajetin e parë nga kaptina Nisa. Po kështu edhe leximi i Ebu Xha’ferit, pjesë e ajetit 14 nga kaptina Xhathije: “لِيُجْزَى قَوْمًا”.
- **“që përputhet me ndonjërin prej mus’hafëve të Uthmanit”** respektivisht prej kopjeve që Uthmani r.a., i kishte shpërndarë gjithandej nëpër vendet islame. P.sh., Ibën Kethiri ajetin 72 nga kaptina Teube e ka lexuar me një

¹ Xhadu, Sherhu ibrazi el-meani min Hirzi el-emani, 1/25; El-Kadi, *El-budur ez-zahire fi-l-kiraat el-ashr el-mutevatire*, f. 8-9; Hamid, *El-kiraat ve etheruba fi et-tefsir ve el-abkam*, 1/113; El-Xhezeri, *Enmeshru fi el-kiraat el-ashr*, 9-11.

shtesë të parafjalës *min* (من): “جَنَاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ” Kjo shtesë gjendet vetëm në kopjen e dërguar në Mekke.

“qoftë edhe të supozuar”, pra të atillë që është e mundshme sipas shkrimit Uthman, si p.sh., leximi i atyre që ajetin 4 nga kaptina Fatiha: “مَالِكِ يَوْمَ الدِّينِ”, respektivisht fjalën Malik e lexojnë me elif edhe pse në të gjitha kopjet është e shkruar pa të. Shkrimi ndonëse pa elif ofron mundësinë që të lexohet me të, ngjashëm siç është vepruar me emrat *Kadir* dhe *Salih* dhe të tjerë të cilët janë shkruar pa elif ndërsa janë lexuar me të.

- **“mutevatir”** transmetimi i përcjellë nga një grup i besueshëm tek tjetri deri në mbarim, i cili parasheh dijen pa kufizim të numrit. Ky është mendimi më i saktë edhe pse disa e kanë përcaktuar numrin duke mos ofruar një numër të caktuar. Disa thonë gjashtë, të tjerë dymbëdhjetë, të tjerët njëzet, disa të tjerë dyzet e ka të atillë që thonë se duhet të jenë shtatëdhjetë.

Në kohën tonë kiraetet që kanë përmbledhur këto tre shtyllat janë kiraetet e dhjetë Imamëve të cilat unanimitisht janë pranuar. Fjala është për Imamët: Ebu Xhaferi, Nafiu, Ibën Kethiri, Ebu Amri, Ja’kubi, Ibën Amiri, Asimi, Hamza, Kesaiu dhe Halefi. Sot nuk ka kiraet tjetër jashtë këtyre dhjetë kiraeteve, të cilit mund t’i thuhet mutevatir.

Kiraeti sahih

Ky lloj i Kiraetit ndahet në dy pjesë:

- 1) Kiraete që ka varg të saktë transmetuesish, pra i përcjell nga një transmetues i drejtë e i përpiktë tek tjetri deri në mbarim, dhe që përputhet me gjuhën arabe dhe shkrimin – *resmin*. Ky lloj ndahet në dy nënloje:

- Lloj që është përcjellë me të madhe dhe të cilin dijetarët e kanë pranuar unanimitisht sikur që me të janë veçuar disa transmetues dhe libra të pranuar. Të këtilla janë p.sh., shkallët e lexuesve sa i përket zgjatimit apo *medit* siç njihet në lëmin e Kiraetit. Ky lexim është i pranuar dhe prerazi dëshmohet për të se është i shpallur nga qielli, pra është një prej shtatë hurufeve¹ që i janë shpallur Pejgamberit ﷺ. Ky lloj i bashkëngjitet Kiraetit mutevatir edhe pse nuk e ka arritur nivelin e tij.
 - Lloj që ymeti nuk e ka pranuar dhe që nuk ka transmetues të shumtë. Shumë dijetarë e lejojnë leximin sipas tij, madje edhe në namaz, ndërsa të tjerë si Ebu Amër bin Salahu konsiderojnë se çdo lexim jashtë dhjetë kiraeteve është i ndaluar rreptësisht.
- 2) Kiraet që ka varg të saktë transmetuesish dhe që përputhet me arabishten por jo edhe me *resmin*. Të kësaj natyre janë shtesat apo heqjet e fjalëve apo edhe ndërrimet e tyre. Kështu është transmetuar p.sh., nga Sahabet e nderuar Ebu Derda r.a., Omeri r.a., Ibën Mes’udi r.a., e të tjerë. Ky lexim sot quhet *shadh* - i pazakonshëm, i çrregullt, për shkak se bie ndesh me shkrimin e mus’hafit rreth të cilit myslimanët janë unanimitë. Së këndejmi, ky lexim, edhe nëse ka varg të saktë transmetuesish, nuk lejohet të përdoret, aq më pak

¹ Sa i përket shtatë *hurufeve* dhe kuptimeve të tyre, dijetarët kanë dhënë mendime të shumta. Sujuti ka numëruar deri në dyzet mendime. Tre mendime merren si më të sakta: i pari: për qëllim është moskufizimi. Numri shtatë -siç përdoret në arabisht- ka ardhur për shtim, jo kufizim; i treti: shtatë dialektet e arabëve që t’i përfshijë të gjithë; i teti: shtatë aspekte të kuptimeve të përbashkëta me shprehje të ndryshme, p.sh., për fjalën *aja* janë përdorur shprehje të ndryshme, si: *ekbil*, *teala*, *helumme*, etj. Allahu e di më së miri! Shih: Salah bin Semir Muhammed Miftah “*El-abruf es-seb’ah ve ma jenbegi i’tikaduhu fiha*”, <https://www.alukah.net/>, shfletuar më 20. 5. 2022. Përkthyesi.

në namaz. Dijetarët e Bagdadit njëzëri janë deklaruar përkitazi me qortimin apo ndëshkimin që Imami Ibën Shenbudh duhej të merrte dhe me atë se ai duhej të pendohej nga leximi shadh që bënte dhe që ua mësonte të tjerëve. Imami Ebu Omer bin Abdul Berri pohon se ndalohet leximi me *kiraet shadh* me unanimitet -*ixbma'*, dhe se nuk lejohet falja e namazit pas imamit që lexon me kiraete të këtilla.

Ndërsa sa i përket leximit që përputhet me ndonjëren prej kuptimeve apo shkrimit por që nuk është i transmetuar nuk quhet *shadh* (i pazakonshëm, i çrregullt) por i sajuar. Kush e shpik atë qëllimisht konsiderohet se ka bërë kufër – ka dalë nga feja¹.

Sa varg të bukur ka thurur Ibën Xhezeriu ndërsa ka folur për këtë:

(فَكُلُّ مَا وافق وَجْهَهُ نَحْوٌ - وكان للرسم احتمالاً يَحْوِي)

(وصَحَّ إِسْنَاداً هُوَ الْقُرْآنُ - فهذه الثلاثة الأركان)

(وحيث ما يَخْتَلُ رُكْنٌ أَثْبِتَ - شذوذُهُ لو أنه في السبعة)

Çdo lexim që me **gramatikën** përputhet dhe që në një ose formë tjetër brenda **resmit** përfshihet,

dhe që **varg transmetuesish** të saktë ka llogarite për Kur'an se këto janë tre shtylla, tjera nuk ka

E kurdo që një shtyllë çrregullim pëson, konstatoje për shadh edhe nëse brenda shtatëshit figuron²

¹ El-Xhezeri, *Munxhid el-mukri'ine ve murshid ettalibine*, f. 18-19; El-Xhezeri, *Ennesbru fi el-kiraat el-ashr*, f. 9-13; Benna, *Ithafu fudalai el-besher bi-l-kiraati el-erbeati ashere*, f. 48-55; Xhadu, *Sherhu ibrazji el-meani min Hirzi el-emani*, 1/20-21; El-Kadi, *El-kiraat esh-shadheb ve tevxbihuba fi lugati el-arab*, 5-8.

² El-Xhezeri, *Metnu Tibet ennesbri fi-l-kiraati el-ashri*, f. 32.

4.

Përmbledhje biografish të dhjetë lexuesve.

Në vazhdim do të ofrojmë një përmbledhje të shkurtër të biografive, të dhjetë lexuesve dhe transmetuesve më të njohur të tyre.

1) **NAFIU**

Ebu Ruvejm Nafië bin Abdurrahman bin Ebi Nuajm el-Lejthi. Me origjinë është nga Asfahani. Ka qenë i pashëm. Llogaritet njëri prej Imamëve të kurrave (lexuesve) në kohën e vet. Kishte aromë misku edhe pse nuk parfumohej. Ka lindur në vitin 70 sipas hixhretit, ndërsa ka vdekur në vitin 169. Shumë studentë kanë përfituar dije prej tij, në mesin e të cilëve edhe Imamët e dalluar, Imam Maliku dhe Imam Lejth bin Sa'di, ndërsa ata që e kanë transmetuar leximin e tij janë si më të njohur:

- Kaluni: Isa bin Sina bin Virdan bin Isa bin Abdus Samed. Kalun është nofkë që e ka marrë nga mësuesi, Nafiu, për shkak të leximit të mirë që bënte. Ishte lexuesi i Medinës. Kishte një veçori të rrallë. Ishte i shurdhër. Nuk dëgjonte asgjë tjetër pos Kur'anit. Ka vdekur në Medinë, në vitin 220h.
- Vershi: Uthman bin Seid bin Abdullah, egjiptas. Versh është nofkë që e ka marrë për shkak se ishte shumë i bardhë. Lexonte bukur dhe kishte zë të ëmbël. Në kohën e vet ishte lexuesi më i njohur dhe më i mirë në Egjipt. Ka vdekur në vitin 197 h.

2) **IBËN KETHIR MEKKIU**

Abdullah bin Ebi Kethir bin Umer bin Abdullah bin Zadhan bin Fejruz bin Hurmuz Mekkiu. Ka lindur në vitin 45 h. Leximin e ka mësuar nga Ebu Saib Abdullah bin Saib

Mahzumi, Muxhahid bin Xhebri, Derbasi, etj. Ka lexuar në prani të Ebej bin Ka'bit dhe Umerit r.a., të cilët kanë lexuar para Pejgamberit ﷺ. Ka vdekur në Mekkë, në vitin 120 h. Shumë studentë kanë mësuar prej tij, ndërsa si transmetues më të njohur të leximit të tij janë dy:

- Bezzi, emri i plotë i të cilit ishte Ahmed bin Muhammed bin Abdullah bin Kasim bin Nafië bin Ebi Bezze. Emri i Ebu Bezzes ishte Beshar. Me prejardhje ishte persian. Ka lindur në Mekkë në vitin 170 h. Ishte dijetar i respektuar. Ishte hoxhë i leximit të Kur'anit në Mekkë. Për dyzet vite ka shërbyer myezin në Qabe. Ka vdekur në vitin 250 h.
- Kunbuli: Muhammed bin Abdurrahman bin Muhammed bin Halid bin Seid. Quhet kështu sepse i përket një fisi që quheshin kanabileh¹. Ka qenë Imam në leximin e vet. Në kohën kur ka jetuar ishte më i dituri për leximet në Hioxhaz. Studentë nga vende të ndryshme vinin për të përfituar dije prej tij. Ka lindur në vitin 195 h., ndërsa ka vdekur në vitin 291 h.

3) EBU AMËR BASRIU

Ebu Amër Basriu: Zejjan bin Ala bin Ammar bin Urjan el-Mazini et-Temimi el-Basri. Thuhet edhe ndryshe se është quajtur Jahja. Ka qenë Imami i Basrasë dhe lexuesi më i njohur i saj. Krahas dijes, shquhej edhe për vlera e virtyte. Ka lindur në Mekkë, në vitin 70 h., ndërsa është rritur dhe edukuar në Basra. Pastaj është kthyer në Mekke dhe Medinë. Ka mësuar leximin tek Ebu Xhafer, Shejbe bin Nessahu, Nafi, Abdullah bin Kethiri, Asim bin Ebi

¹ Disa biografë e kanë vokalizuar ashtu siç e kemi përshkruar ne. Nëse shkohet sipas kësaj që autori ka përzgjedhur dhe që qëndron po kështu në burime të besueshme, emri duhet të vokalizohet Kanbel. Përkthyesi.

Nuxhudi dhe Ebu el-Alije. Ky i fundit leximin e ka mësuar nga Omeri r.a. dhe sahabë tjerë, e këta të fundit nga Pejgamberi ﷺ. Ka vdekur në vitin 154 h. Prej tij kanë mësuar një numër i konsiderueshëm studentësh, ndër të cilët Jahja bin Mubarek bin Mugire Jezidi. Prej tij kanë mësuar:

- Duriu: Hafs bin Umer bin Hibd el-Aziz bin Sahban bin Adij ed-Durij el-Ezdiq en-Nahvij el-Bagdadi. I besueshëm dhe i ditur. Imam i leximit në kohën e vet. Ka vdekur në vitin 246h.
- Susi: Salih bin Zijad bin Abdullah bin Ismail bin Xharud es-Susi. Vjen nga Susi, një qytet në Ahvaz, në Iran. Nofkën e kishte Ebu Shuajb. Lexues i njohur dhe i besueshëm. Ka vdekur në vitin 261 h.

4) **ABDULLAH BIN AMIR ESH-SHAMI**

Abdullah bin Amir bin Jezid bin Temim bin Rebiah el-Jahsabij. Tabi'in. Ka lindur në vitin 8 h. Ishte Imami i Shamit në lexim. Dijetar i vlerësuar për dijen. Ka shërbyer Imam në xhaminë umevite në Damask për vite. Omer bin Abdul Azizi r.a., edhe pse ishte halife, falej pas tij. Krahas shërbimit si imam, shërbente edhe si gjykatës dhe udhëhiqte me qendrën e leximit në Damask. Është pranuar unanimisht si ekspert i leximit sikur që është pranuar leximi i tij për lexim të saktë. Senedi i tij shkon deri tek Pejgamberi ﷺ. Ka vdekur në Damask, në vitin 118 h. Transmetuesit më të njohur të leximit të tij janë dy:

- Hishami: Hisham bin Ammar bin Nusajr bin Mejsere es-Sulemij. Ka lindur në vitin 153 h. Ishte Imam, ligjëruesi, myftiu, lexuesi dhe hadithologu i Damaskut. Ishte orator i madh. Edhe pse jetoi gjatë, gëzonte shëndet të mirë fizik e mendor. Kjo bëri që njerëzit nga

të katër anët e botës islame ta vizitojnë për të marrë dije prej tij.

- Ibën Dhekvani: Abdullah bin Ahmed bin Bishr. Quhet edhe ndryshe: Beshir bin Dhekvan bin Omer el-kureshij ed-dimeshkij. Ka qenë hoxhë i leixmit të Kur'anit në Sham dhe imam në xhaminë umevite në Damask. Pas Ejjub bin Temimit ai udhëhoqi me shkollën e leximit në Damask. Ka vdekur në Damask, në vitin 242 h.

5) **ASIM EL-KUFI**

Asim bin Ebi Nexhud. Është thënë se emri i babait të tij ishte Abdullah ndërsa ofiqin Nexhud. Ka qenë tabiün. Pas Ebu Abdurrahman Sulemiu, me dëshmi të Ibën Xhezeriut, ka qenë hoxhë dhe udhëheqës i qendrës për leximin e Kur'anit në Kufe. Me qëllim të mësimit të leximit të Kur'anit, njerëzit e kanë vizituar nga të katër anët e botës islame. Lexonte rrjedhshëm dhe me përpikëri. E kishte zërin më të ëmbël. Senedi i tij shkon deri tek Pejgamberi ﷺ. Ka vdekur në Kufe, në vitin 127 h. Dy transmetuesit më të njohur të leximit të tij:

- Shu'be: Shu'be bin Ajash Hanat el-Esedij en-Nehshelij el-Kufij. Ofiqin e kishte Ebu Bekir. Ka lindur në vitin 95 h. Ka qenë dijetar i madh e madje një ndër më të mëdhenjtë, i dëshmuar për dijen dhe veprat. E ka lexuar Kur'anin para Asimit dhe Ata bin Saibit. Ka vdekur, në vitin 193 h.
- Hafs: Hafs bin Sulejman bin Mugire bin Ebi Davud el-Esedij el-Kufij. Ka lindur, në vitin 90 h. Ka qenë më i dituri për leximin e Asimit. Veprimtarinë e tij prej lexuesi e zhvilluar ndërmjet dy kryeqendrave: Bagdadit dhe Mekkës. Dhebiu duke folur për të ka thënë: “Në

lexim është i besueshëm, i saktë dhe i drejtë.” Ka vdekur, në vitin 180 h.

6) **HAMZA EL-KUFI**

Hamza bin Habib bin Umare bin Ismail el-Kufi, njëri nga shtatë imamët e leximit. Pas Asimit ka qenë Imam i Kiraetit në Kufe. Ishte i dalluar për dije dhe tipare. Ishte shumë i përkushtuar në adhurim. Ka lindur në vitin 80, sipas hixhretit ndërsa ka arritur të takojë edhe disa sahabë - shokë të Pejgamberit ﷺ. Kiraeti i tij ka sened të lidhur deri tek Aliu r.a., dhe Ibën Abbasi r.a., e këta të dy e kanë marrë kiraetin nga Pejgamberi ﷺ. Ka vdekur, në vitin 156 h., në Irak. Dy transmetuesit më të njohur të leximit të tij janë:

- Halefi: Halef bin Hisham bin Tha'leb el-Esedij el-Bagdadij. Njihej me nofkën Ebu Muhammed. Ka lindur, në vitin 150 h. Kur'anin e ka memorizuar duke qenë dhjetë vjeçar. Darekutni duke folur për të ka thënë: Ka qenë i përkushtuar në adhurim, i dalluar për virtytet, i besueshëm, asket, dijetar. Ka përzgjedhur një kiraet ndryshe nga të tjerët. Së këndejmi llogaritet në mesin e dhjetë kurrave – lexuesve. Ka vdekur, në vitin 229 h.
- Haladi: Hald bin Halid Shejbani. Ka lindur në Kufe, në vitin 119 ose 130 sipas një versioni tjetër. Ka mësuar tek Selim bin Isa bin Hamza. Ka qenë studenti më i dalluar i tij. Është dalluar për mjeshtri në lexim dhe për virtyte shpirtërore. Ka vdekur në vitin 220 h.

7) **KESAIU**

Kesaiu: Ali bin Hamza bin Abdullah bin Uthman en-Nahvi. Thirrej Ebu-l-Hasen. Llagapin e kishte Kesai. Ebu Bekir Enbari duke folur për të ka thënë: Kesaiu është

dalluar për disa gjëra: ka qenë gramaticieni më i ditur, njohës më i madh i fjalëve të huaja, lexuesi më i mirë. Kur lexonte a këndonte të krijohej përshtypja se ishte ndonjë melek që lexonte, jo njeri. Leximi i tij ka sened të pashkëputur deri tek Pejgamberi ﷺ. Ka vdekur, në vitin 189 h., në moshën shtatëdhjetë vjeçare. Dy transmetuesit më të njohur të leximit të tij janë:

- Lejthi: Lajth bin Halid el-Mervezij el-Bagdadi. Ofiqin e kishte Eb-l-Harith. Ishte më i dalluari nga ndjekësit e Kesaiut. Ishte i besueshëm, i zgjuar, i saktë dhe i kujdesshëm gjatë leximit. Ka vdekur, në vitin 250 h.
- Hafs Duriu: Shih më lart biografinë e tij.

8) **EBU XHA'FER MEDENIU**

Ebu Xhafer Medeniu: Jezid bin Ka'kaë el-Mahzumi el-Medenij. Nofkën e kishte Ebu Xhafer. Njëri ndër dhjetë lexuesit e njohur të Kur'anit. I përket gjeneratës së tabiinëve. Senedi i tij është i lidhur deri tek Pejgamberi ﷺ. Ka vdekur, në vitin 130 h. Dy transmetuesit më të njohur të leximit të tij janë:

- Isa bin Virdan: Ofiqin e kishte Ebu-l-Harith. Një nga ndjekësit e vjetër të Nafiut. Imam i njohur dhe i dëshmuar. Ka vdekur, në vitin 260 h.
- Ibën Xhemmaz: Sulejman bin Muhammed bin Muslim bin Xhemmaz. Ka vdekur, në vitin 170 h.

9) **JA'KUB BASRIU**

Jakub bin Is'hak bin Zejd bin Abdullah bin Ebi Is'hak el-Hadremij el-Misrij. Ofiqin e kishte Ebu Muhammed. Njëri prej dhjetë Imamëve në kiraet. Ishte i dëshmuar për dije dhe vlera. Pas Ebu Amër bin Alaut ka qenë më i dituri i kohës së vet për kiraetin. Senedi i tij është i lidhur deri tek

Pejgamberi ﷺ. Ka vdekur, në vitin 250 h. Prej studentëve të tij dy dallohen më së shumti:

- Ruvejsi: Muhammed bin Mutevekkil el-Lu'lu' el-Basri. Ofiqin e kishte Ebu Abdullah dhe ishte më i dalluari ndër ndjekësit e Ja'kubit. Ka qenë Imam dhe i njohur për saktësinë dhe leximin e drejtë. Ka vdekur, në vitin 238 h.
- Revhi: Revh bin Abdul Mu'min el-Hudhelij el-Basri en-Nahvij. Ofiqin e kishte Ebu-l-Hasen. Ishte prej ndjekësve më të mirë dhe më besnikë të Ja'kubit. Ka vdekur, në vitin 235 h.

10) **HALEFI**

Imami i dhjetë është Halef bin Hisham Bezzari, bagdadas. Për biografinë e tij kemi folur më lart, tek biografia e Hamzait, si një prej transmetuesve të leximit të tij. Dy prej studentëve dhe transmetuesve më të dalluar të leximit të tij janë:

- Is'haku: Is'hak bin Ibrahim bin Uthman bin Abdullah el-Mervezij el-Bagdadij. Ka një version të përzgjedhur të Halefit, të cilin e ka lexuar para tij dhe e ka transmetuar më pas. Ka qenë i njohur si dijetar dhe i drejtë. Po ashtu edhe si lexues i mirë e i saktë, edhe pse nuk ka transmetim tjetër që e ka ditur përpos këtij të përzgjedhurit nga Halefi. Ka vdekur, në vitin 286 h.
- Idrisi: Idris bin Abdul Kerim Haddad Bagdadiu. Ofiqin e kishte Ebu-l-Hasen. Ka qenë dijetar i zoti dhe i shkathtë. Darkutniu kur e kishte përshkruar kishte thënë: Është i besueshëm, madje një shkallë mbi besueshmëri. Ka vdekur, në vitin 292 h., në moshën 93 vjeçare.

Nga biografitë që shpalosëm për dhjetë kuratë dhe transmetuesit e tyre mund të konstatojmë se leximet e tyre janë korrekte dhe me sened – varg të lidhur transmetuesish deri tek Pejgamberi ﷺ.¹

Imam Shatibiu në kasiden e tij të njohur Lamija i ka përmendur shtatë lexuesit e parë dhe transmetuesit e tyre.

*Allabu me të mira i shpërbleftë
Imamët,*

*që Kur'anin ëmbël e rrjedhshëm na
e përcollën.*

*Shtatë prej tyre janë sikur hëna që
midis qiellit të lartësisë e drejtësisë
kanë hedhur shtat e shkëlqejnë
dritë e madhështi.*

*Kanë yje² që prej tyre marrin dritë
e të tjerët i ndriçojnë,
errësirën e injorancës e zhdrukën
dhe largojnë.*

*Do t'i shobësh me radhë, njërin
pas tjetrit,*

*të përfaqësuar me nga dy prej
ihttarëve të tyre,*

جزى الله بالخيرات عنا أئمة

لنا نقلوا القرآن عذبا وسلسلا

فمنهم بدور سبعة قد توسطت

سماء العلا والعدل زهرا وكملا

لها شهب عنها استنارت فنورت

سواد الدجى حتى تفرق وانجلى

وسوف تراهم واحدا بعد واحد

مع اثنين من أصحابه متمثلا

¹ Për më shumë rreth biografive të tyre shih: El-Xhezeri, *Enneshru fi el-kiraat el-asbr*, 1/17-120; Ma'rifetu el-Kurra el-kibar të Dhehebiut, 1/67-187; A'lami të Zirekliut, 3/72; 4/228-366; 5/308; *It'bafu el-fudala*, 1/19-32.

² Hënat janë Imamët, yjet janë transmetuesit. Përkthyesi (duke iu referuar shpjegimeve të poezisë nga vet Imami Abdul Fettah Kadiu në Sherhu esh-Shatibijeh).

*Kritikët e tyre i përzgjedhën nga
më të mirët,
të cilët Kur'anin nuk e shndërruan
në mjet përfitimi.*

تخيرهم نقادهم كل باع
وليس على قرآنه متأكلا

*Sa i përket fisnikut me fshehtësi
misku¹ është Nafiu,
ai që Medinën për vendbanim e
zgjedhi.*

فأما الكريم السر في الطيب نافع
فذاك الذي اختار المدينة منزلا

*Kaluni, Isa², pastaj Uthmani
Vershi³ i tyre,
me shoqërinë e të cilit nderi u ngrit
e u lartësua.*

وقالون عيسى ثم عثمان ورشهم
بصحبتة المجد الرفيع تأثلا

*Mekka, vendi në të cilin qëndroi
Abdullahu.*

ومكة عبد الله فيها مقامه

*I cili është i biri i Kethirit që të
tjerëve në dije e pozitë ua tejkaloi.*

هو ابن كثير كاتر القوم معتلى

*Leximin e tij me sened e përcollën
Bezri dhe Muhammedi.*

روى أحمد البزي له ومحمد

I cili quhej Kunbul⁴.

على سند وهو الملقب قنبلا

¹ Për qëllim është ajo që autori përmend në biografi se Nafiut i vinte erë misku kudo që shkonte dhe se sekreti i kësaj nuk fshihej në përdorimin e miskut por në ëndrrën që kishte parë. Përkthyesi.

² Kalun është ofiq i marrë nga dijetarët. Emrin e vërtetë e ka Isa. Përkthyesi.

³ Për qëllim është bardhësia, për çfarë edhe është thirrur kështu. Përkthyesi.

⁴ Në biografinë e tij, kemi shpjeguar se si lexohet ky emër. Përkthyesi.

E Imam Maziniu, që familje të mirë ka,

është Ebu Amër Basriu, babai i të cilit qubej Ala,

*Jahja Jezidiut dituri i dha,
e ky me dije shtoi etjen e njerëzve kudo¹.*

*Ebu Umer Duri dhe Salihu i tyre
Shuajbi, i cili është Susi, prej tij e ka marrë.*

*Kurse sa i përket Damaskut të Shamit është trolli i Ibën Amirit,
I cili me Abdullahun² u bë vendbanim i mrekullueshëm.*

*Hishami dhe Abdullahu që nga Dhekvani është,
prej tij me sened leximin e përcollën,*

*Në Kufën e bardhë tre prej tyre,
dijen e shpërndanë, aroma e të cilës misk e karafil kudo u shpërnda,*

Ebu Bekeri, emri i të cilit Asim është,

وأما الإمام المازني صريحهم

أبو عمرو البصري فوالده العلاء

أفاض على يحيى اليزيدي سيبه

فأصبح بالعذب الفرات معللاً

أبو عمر الدوري وصالحهم أبو

شعيب هو السوسي عنه تقبلاً

وأما دمشق الشام دار ابن عامر

فتلك بعبد الله طابت محللاً

هشام وعبد الله وهو انتسابه

لذكوان بالإسناد عنه تنقلاً

وبالكوفة الغراء منهم ثلاثة

أذاعوا فقد ضاعت شذا وقرنفلاً

أما أبو بكر وعاصم اسمه

¹ Ka përcjellë dijen e marrë nga Ibën Kethiri dhe, nga aspekti i dobisë që dija e tij ka pasur, është krahasuar me atë që shuan etjen e njerëzve me ujë. Përkthyesi.

² Emri i Ibën Amirit. Përkthyesi.

*pastaj transmetuesi i tij, i dalluari
për të mirë e dije Shu'be.*

فشعبة راويه المبرز أفضلا

*Pastaj Ibën Ajjashi Ebu Bekir
Rida,*

وذاك ابن عياش أبو بكر الرضا

*dhe Hafsi, i cili në dije dallobej për
përpikëri,*

وحفص وبالإتقان كان مفضلا

*dhe Hamzai, i devotshmi i pastër
imam, durimtar në leximin e
Kur'anit,*

وحمزة ما أركاه من متورع

إماما صبورا للقرآن مرتلا

*prej tij transmetoi Halefi dhe
Haladi atë që,*

روي خلف عنه وخلاص الذي

*Selimi me përpikëri e mjeshtri e
transmetoi.¹*

رواه سليم متقنا ومحصلا

*Kurse Aliu, ofiqin Kesai e ka
sepse në ihram kishte veshur kesa²*

وأما علي فالكسائي نعته

لما كان في الإحرام فيه تسريلا

*Prej tij transmetoi Lejthi, Ebu-l-
Harith Rda,*

روي ليثهم عنه أبو الحارث الرضا

*dhe Hafsi, Duri, jetëshkrimin e të
cilit e shpalosëm.*

وحفص هو الدوري وفي الذكر قد خلا

*Ebu Umeri dhe Jabsebiu, i biri i
Amirit, arabë të kulluar,*

أبو عمرهم واليحصبي ابن عامر

صريح وباقيهم أحاط به الولا

¹ Nga Hamzai. Përkthyesi.

² Rrobë, tesha, kostum. Përkthyesi.

course të tjerët¹ nuk janë të këtillë.

*Kanë rrugë që kush i ndjek
udhëzohet,*

*E tani që janë të këtilla nga asnjë
mashtues nuk rrezikohen².*

لهم طرق يهدى بما كل طارق

ولا طارق يخشى بما متمحلا

Në këta tre Imamët që plotësojnë këtë dhjetëshe, bashkë me transmetuesit e tyre, ka aluduar edhe Imami Muhammed bin el-Xhezeri në librin *Tibetu en-neshër*.

*Pastaj Ebu Xhaferi, dijetari i
madh,*

*prej të cilit Isa dhe Ibën
Xhemmazî kanë marrë,*

*I nënti me radhë është Ja'kubi,
hadremij,*

*Ruwejsi dhe Revhi janë
transmetuesit e tij.*

*Bezzari është i dhjeti, i cili është
Halefi.*

Ishaku dhe Idrizi prej tij njihen³

ثم أبو جعفر الحبر الرضا

فعنه عيسى وابن جواز مضى

تاسعهم يعقوب وهو الحضرمي

له رويس ثم روح ينتمي

والعاشر البزار وهو خلف

إسحاق مع إدريس عنه يعرف

¹ Imamët tjerë nuk janë arabë të kulluar ose mund të kenë qenë dikur skllëvër ata ose paraardhësit e tyre. Përkthyesi.

² Përkthim duke iu referuar shpjegimeve që dr. Abdul Fettah Kadiu i ka bërë kësaj poezie. Përkthyesi.

³ El-Xhezeri, *Metnu Tibet ennesbri fi-l-kiraati el-ashri*, f. 32-33.

Kapitulli IV:

**KUNDËRPËRGJIGJET E HOXHËS ABDUL
FETTAH KADI NDAJ DYSHIMEVE DHE
GËNJESHTRAVE TË GOLDZIHERIT**

Në këtë pjesë do të trajtojmë disa dyshime shkencore dhe historike të hedhura nga lideri evropian i islamistikës, orientalisti çifut Goldziher, në librin e tij ‘Doktorinat e interpretimit të Islamit’¹, si dhe zhvlerësimin e tyre nga ana e Shejhut Abdul Fettah Kadiut. Sigurisht, për shkak të natyrës së punimit, nuk do të ndalemi në të gjitha dyshimet e tij, në fokus do të kemi vetëm disa prej tyre, e të cilat reflektojnë personalitetin e një mashtruesi, sharlatani, një njeriu që fshihte thellë në zemër çifutizmin e tij dhe urrejtjen ndaj Islamit². Vërtetë, është turp dhe humbje kohe për një personalitet të tillë, që pas gjithë atyre viteve kushtuar studimit të gjuhës arabe dhe Islamit të luajë me të vërtetat islame, t’i shtrembërojë ato dhe të refuzojë nënshtrimin ndaj të vërtetave kur’anore. Ka qenë dashur, së paku, të mos merrte këtë pozicionim, pra të mos hidhte dyshime e të mos përpiqej dhe orvatej t’i largonte njerëzit nga rruga e drejtë, por, e këtillë është metodologjia e Ithtarëve të Librit, çifutëve dhe të krishterëve, të cilët, të vërtetën e pështjellin me të kotën, e njohin të vërtetën por nuk e pranojnë!!

Përgjatë prezantimit të dyshimeve dhe kundërpërgjigjeve të hoxhës Abdul Fettah Kadi do të bëjmë disa komente dhe analiza, për t’i sqaruar gjërat më mirë.

NATYRA E KUNDËRPËRGJIGJEVE AKADEMIKE DHE IDEOLOGJIKE TË HOXHËS ABDUL FETTAH KADI

Gjatë analizimit të kundërpërgjigjeve të hoxhës Abdul Fettah Kadi, ndaj akuzave dhe dyshimeve të pabaza të kundërshtarit të tij të pa kompromis, Goldziherit, ne kemi vënë re se ato janë të ndryshme dhe në përputhje me dyshimin e bërë në lloj, cilësi e sasi. Nga kjo perspektivë, këto kundërpërgjigje mund të klasifikohen si më poshtë:

¹ Ky libër është përkthyer në disa gjuhë dhe me tituj të ndryshëm siç mund të vërehet dhe në tekst.

² Shih: Zakzuk, *El-istishrak ve el-halfijjetu el-fikrije li-s-sirai el-hadaraj*, f. 48.

- 1) Kundërpërgjigje teorike me karakter të përgjithshëm, në të cilat zhvlerësimi i dyshimeve bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë.
- 2) Kundërpërgjigje historike të cilat paraqesin argument të prerë dhe bindës për injorancën e dyshuesit.
- 3) Kundërpërgjigje shkencore në të cilat zbërthejnë kuptime të Shkencës së Kiraeteve dhe i formësojnë ato.

Tani do të merremi me dyshimet e Goldziherit dhe kundërpërgjigjet e Hoxhës sonë Abdul Fettah Kadiut.

1. KUNDËRPËRGJIGJET E HOXHËS DR. ABDUL FETTAH KADI NDAJ SHPIFJEVE DHE AKUZAVE TË GOLDZIHERIT

DYSHIMI I PARË DHE KUNDËRPËRGJIGJIA E TIJ

Në librin Doktrinat e interpretimit të Islamit, Goldziheri ka thënë:

“Nuk ka ndonjë libër legjislativ, të pranuar si pjesë besimi nga ndonjë grup fetar se është tekst i zbritur apo i shpallur (nga qielli), i cili ofron tekstin e vet në fazën më të hershme të tij me këtë formë çrregullimi dhe jostabiliteti, siç është teksti kur’anor...”¹

Kundërpërgjigjia e hoxhës Abdul Fettah Kadi:

Është e pamundur që tekstin kur’anor ta përshkojë çrregullimi², apo të shoqërohet me frikë dhe stres, ngase domethënia e çrregullimit dhe jostabilitetit në tekstin kur’anor nënkupton që teksti të lexohet në disa forma dhe ndërmjet tyre të ketë mospërputhje në kuptime dhe qëllime. Kjo, sigurisht, se nuk mund të ndodhë në Kur’an³. Transmetimet e ndryshme dhe aspektet e shumëllojshme që janë përcjellë për tekstin kur’anor nuk kanë kundërthënie as në domethënie dhe as në qëllime⁴. Nëse analizojmë hollësisht kiraetet, ato të tipit mutevatir, meshhur dhe sahih, do të vërenim se mospërputhja qëndron në njërin nga këto dy lloje:

¹ Goldziheri, *Medhabib et-tefsir el-islamij*, f.4.

² Kattan, *Nuzul e-Kur’an ala seb’ati ahrufin*, f. 30-50.

³ El-Kadi, *El-kiraat fi nadhari el-musteshbrikinë ve el-mulhidine*, f. 11-12.

⁴ Muhajsin, *El-mubedbeb fi el-kiraat el-ashr*, f. 220.

1) Dallimi i kiraeteve në tekst – shprehje por jo edhe në qëllim. Ky lloj i referohet dallimeve të gjuhëve, si p.sh., leximi i fjalës ‘siral’ në ajetin e gjashtë nga kaptina el-Fatiha:

﴿ ٦ ﴾ اِهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ

Udhëzона (përforcona) në rrugën e drejtë!”

...me ‘s’ të fortë (sad- ص) dhe me ‘s’ të butë (sin- س).

Apo, edhe leximi i fjalës ‘el-Buhl’ në ajetin 24 nga kaptina el-Hadid:

﴿ ٢٤ ﴾ الَّذِينَ يَبْخُلُونَ وَيَأْمُرُونَ النَّاسَ بِالْبُخْلِ ۖ وَمَنْ يَتَوَلَّ فَإِنَّ اللَّهَ هُوَ الْعَنِيُّ الْحَمِيدُ

Të cilët vetë bëjnë koprraci dhe me koprraci i këshillojnë njerëzit. E kush largohet prej dhënies, le ta dijë se Allahu është i begatshëm, i lavdishëm.”

...duke vokalizuar shkronjën ‘b’ me zanoren ‘u’ ndërsa ‘h’-në pa zanore fare (me sukun), pra ‘buhl’, apo duke vokalizuar që të dyja me zanoren ‘e’.

Ngjashëm është edhe puna me leximin e foljes ‘jahsebu’ në ajetin e tretë nga kaptina el-Humeze:

﴿ ٣ ﴾ يَحْسَبُ أَنَّ مَالَهُ أَخْلَدَهُ

E mendon se pasuria e tij do ta bëjë të përjetshëm.”

....respektivisht, leximin e shkronjës ‘s’ duke e vokalizuar me zanoret ‘e’ ose ‘i’.

Urtësia e shpalljes së Kur’anit edhe me këtë lloj është që njerëzve me gjuhë të ndryshme t’iu lehtësohet leximi¹. Prej këtij lloji ka edhe pjesë

¹ Imam Xhezeriu ka thënë: “Arabët, me gjuhën e të cilëve u shpall Kur’ani, kishin gjuhë (dialekte) të ndryshme. E kishin të vështirë që të kalonin nga gjuha e vet në gjuhën e tjetrit. Duke qenë se nuk dinin shkrim-lexim, kalimin nga dialekti në tjetrin, e veçmas për të moshuarit dhe gratë, ishte i vështirë dhe, rrjedhimisht, të kërkohej një gjë e tillë, do të thoshte të ngarkoheshin me atë që nuk kanë mundësi.” El-Xhezeri, *Enneshru fi el-kiraat el-asbr*, 1/22; Rraxhihi, *El-lehexhat el-arabijeh fi el-kiraat el-kur’anije*, f. 84-100.

që nuk janë si rezultat i dallimeve gjuhësore por janë vetëm pjesë të të folurit letrar, si p.sh.:

﴿نَزَلَ بِهِ الرُّوحُ الْأَمِينُ﴾ (١٩٣)

Atë e solli shpirti besnik (Xhibrili).’’ [Shuara, 193]

Folja ‘nezele’ është lexuar me dyfishimin e shkronjës ‘z’ (nezele) dhe padyfishimin e saj, sikur që emri ‘ruh’, gjegjësisht shkronja e fundit e saj, ‘h’ –ja, është lexuar me zanoren ‘u’ (err-rruhu) dhe me ‘e’ (err-rruhe)¹.

Pastaj, Shejhu sqaron, se si formë, është evidente edhe në traditën e arabëve, madje, përderisa domethënia e fjalës mbetet e pandryshueshme, nuk ka gjë të keqe në këtë përdorim².

2) Lloji i dytë është kur leximet dallojnë në shprehje dhe domethënie, por që të dy domethëniet mbesin të shëndosha dhe të pranuar; pra, as nuk përputhen dhe as nuk kundërshtohen. Këtë mund ta hasim në ajetin 259, të kaptinës el-Bekare, gjegjësisht në pjesën:

﴿وَإِنظُرْ إِلَى الْعِظَامِ كَيْفَ نُنشِزُهَا ثُمَّ نَكْسُوهَا حَمًا﴾ (٢٥٩)

...shiko se si i kombinojmë eshtrat e pastaj i veshim me mish...’’

Folja ‘nunshizuha’ (نُنشِزُهَا) është lexuar me shkronjën ‘z’, e që ka kuptimin e kombinimit, por është lexuar edhe me shkronjën ‘r’ (*nunshiruba*), e që ka kuptimin e ringjalljes pas vdekjes për të dhënë llogari³. Kuptimet –vazhdon të sqarojë Shejhu- janë të ndryshme, por ato nuk bien ndesh me njëra tjetrën, përkundrazi, ngase Allahu kur të ringjallë krijesat, urdhëron bashkimin e eshtrave e pastaj i ringjallë për llogari⁴.

Kështu qëndron puna edhe me një pjesë të ajetit 18 nga kaptina el-Hadid:

¹ El-Kadi, *El-kiraat fi nadhari el-musteshbrikine ve el-mulhidine*, f. 20-23.

² Njerëz të ndryshëm, nga fise dhe me dialekte të ndryshme, pranuan Islamin... kështu që Islami u tregua tolerant me ta dhe gjendjen e tyre...Shih: *Tefsir et-Taberi*, 1/35; *El-burban fi ulum el-Kur’an* të Zerkeshiut, 1/227.

³ Referenca paraprake, f. 24; El-Xhezeri, *Ennesbru fi el-kiraat el-ashr*, 1/50.

⁴ El-Kadi, *El-kiraat fi nadhari el-musteshbrikine ve el-mulhidine*, f. 30.

﴿ إِنَّ الْمُسْدِقِينَ وَالْمُسَدِّقَاتِ وَأَقْرَضُوا اللَّهَ قَرْضًا حَسَنًا يُضَاعَفُ لَهُمْ وَلَهُمْ أَجْرٌ كَرِيمٌ ﴾ ۱۸

S'ka dyshim se ata që japin lëmoshë (sadaka) dhe që sinqerisht japin për hir të Allahut...

Këto dy fjalë, gjegjësisht shkronja ‘s’ në to, është lexuar me dyfishim dhe pa të, në rastin e parë, ajo nënkupton ata që japin pjesë të pasurisë së tyre, qoftë kjo e obliguar (Zekati), apo edhe vullnetare, siç është lëmosha. Ndërsa në rastin tjetër, pra kur të lexohet pa dyfishim, ato nënkuptojnë besimtarët që i përkushtohen fesë, që i nënshtrohen asaj dhe dispozitave të saj. Pra, janë dy domethënie të ndryshme, por që bashkohen në karakterin dhe personalitetin e besimtarit lëmoshëdhënës¹. Urtësia e këtij lloji, shton Shejhu, është që ajeti të luajë rolin e dy ajeteve që kanë ardhur për dy domethënie bashkë².

Këto janë dy lloje të dallimeve në kiraete, ndërsa sa i përket asaj që të ketë dallime në shprehje dhe domethënie, dhe këtë me pamundësi përputhje ndërmjet tyre, kjo është e pamundur në Kur’an. Allahu i Madhëruar ka thënë:

﴿ أَفَلَا يَتَذَكَّرُونَ الْقُرْآنَ ۚ وَلَوْ كَانَ مِنْ عِنْدِ غَيْرِ اللَّهِ لَوَجَدُوا فِيهِ اخْتِلَافًا كَثِيرًا ﴾ ۸۲

A nuk e përfillin ata (me vëmendje) Kur'anin? Sikur të ishte prej dikujt tjetër, përveç prej Allahut, do të gjenin në te shumë kundërthënie.” [Nisa, 82]

Për të vërtetuar se nuk ka kundërthënie në kiraetet e Kur’anit, Shejhu citon edhe Ibni Kutejben, i cili në librin e tij të famshëm ‘Mushkilul Kur’an’ thotë: “Dallimi është dy lloje: dallim i ndryshimit dhe dallimi i mospërputhjes. Sa i përket këtij të fundit, ai, falënderuar qoftë Allahu, nuk gjendet në Librin e Tij, ndërsa i pari është i lejuar...” Pastaj solli shembuj kur’anor³ duke argumentuar lejimin e llojit të parë dhe se domethëniet e ajetit, varësisht nga leximi, ishin të sakta dhe se çdo lexim ishte pothuaj si një ajet në vete.

Si rezyme e asaj që përmendi Shejh Abdul Fettahi, mund të themi si dallimet në lexime janë dallime në lloj dhe ndryshim e jo dallime që

¹ Shih: El-Kadi, *El-budur ez-zahire fi-l-kiraat el-asbere el-mutevatire*, f. 50-55.

² El-Kadi, *El-kiraat fi nadhari el-musteshbrikine ve el-mulhidine*, f. 30-34.

³ Referenca paraprake.

shkaktojnë papërputhshmëri. Nëse kjo nuk mund t'i atribuohet një gjeniu nga njerëzit, atëherë si mund të thuhet kështu për Fjalën e Zotit?! Kështu, vërtetohet se është e pamundur që tekstit kur'anor t'i mveshet diç e tillë. Po ashtu, transmetimet e leximeve kur'anore kanë ardhur nëpërmjet rrugës më të saktë, tevaturit¹, që nënkupton se janë drejtpërdrejt nga Pejgamberi alejhi selam², prej të cilit e morën Sahabët për t'ua përcjellë më pas tabiinëve, dhe kështu brez pas brezi deri tek ne.

Allahu e di më së miri!

Po pyesim: Këto sekrete të gjuhës arabe prej nga mund t'i mësoj Goldziheri dhe orientalistët e ngjashëm me të?! Ku mund ta dijë ai urtësinë e kësaj llojllojshmërie dhe diversiteti në kiraete?!

Pengesë e hekurt para mësimit të këtyre urtësive për këta dyshues e dashakëqij është fanatizmi i tyre për hebraizmin e shtrembëruar, në një rën anë, dhe urretja e tyre e pashpjegueshme për Islamin, në anën tjetër.

Sikur t'i kuptonin këto sekrete e urtësi dhe të mos vdisnin si jomyslimanë!

Ah, sikur angazhimi i tyre shkencor t'i çonte në të vërteta islame dhe të mos çonin dëm tërë ato shuma të mëdha parash duke menduar se po veprojnë mirë, ndërsa kanë vepruar keq e gabim!

¹ Shih: Xhebel, *Vethakat nakli-n-nassi-l-kur'anij min Resulilab ila ummetihi*, f. 157.

² Dijetarët janë të një mendimi sa i përket asaj se kiraetet janë teukifije, pra mbështeten vetëm në tekste dhe citate. Imam Zerkeshiu ka thënë: "Kiraetet janë teukifije, jo alternative, me përjashtim të Zamhsherit, i cili mendon se janë të lira..." Shih: *El-burban fi ulum el-Kur'an*, 1/321; Muhammed Isa Masravi, *El-kiraat el-varideh fi-s-sunneh*, f. 42-43.

DYSHIMI I DYTË DHE KUNDËRPERGJIGJIA E TIJ

Dyshimi i dytë ka të bëjë me atë se kinse një grup myslimanësh që kanë insistuar në unifikimin e tekstit kur'anor, nuk kanë hasur në përkrahjen e të tjerëve. Tekstualisht, në librin e tij të përmendur më lart, Goldziheri thotë: “Në tërë periudhën e hershme të historisë islame nuk është vërejtur ambicia për unifikimin fetar (besimor) të tekstit, përveç raste të një përkrahje të pamjaftueshme...”¹

Sipas këtij paragrafi, kuptohet se na paska qenë një grup myslimanësh, që paskanë shfaqur ambicie për unifikim akaidor të tekstit kur'anor, por që nuk paska fituar edhe përkrahjen e publikut, me përjashtim të një pakice. Kjo është një akuzë e pabazë dhe një pohim, të cilin argumentet e zhvleftësojnë në tërësi. Nuk është vërtetuar se ndonjëri prej myslimanëve ka dashur apo të paktën ka menduar të bëjë unifikimin e teksteve të Kur'anit Fisnik. Ajo që në fakt ka bërë halifeja Uthman bin Affani r.a., nuk ka të bëjë aspak me këtë që thotë Goldziheri. Halifeja ka synuar t'i bashkojë myslimanët rreth kiraeteve të vërtetuara në mënyrën më të saktë, pra tevaturin, dhe jo se ka pasur ndonjë motiv tjetër, ndryshe, siç nënvizon Shejh Abdul Fettahu, Uthmani nuk do të lejonte që në mus'hafet e shkruara në kohën e tij të kishte dallime në disa vende, dhe kjo sipas kiraeteve të ndryshme, por do të urdhëronte që të gjitha mus'hafet të shkruheshin me një formë të vetme. Pra, shkrimi i tyre në forma të ndryshme, gjithnjë në përputhje me kiraetet e vërtetuara, është dëshmi se Uthmani nuk ka pasur për qëllim unifikimin e tekstit kur'anor...²

Pas këtij shpjegimi nuk mund të ketë shpjegim, por, siç do të shprehej hoxha ynë prof.dr. Abdul Aziz Abdul Fettah Kariu, nga ta kuptojnë perëndimorët sado që të jenë orientalizuar, veçmas këta të sojit të Goldziherit, të cilët qëllimisht përbaltin Islamin megjithqë kanë njohuri të gjera rreth tij. Kur u përkthye në arabisht, libri i tij *Doktrinat e tefsirit*, pamë të jetë hapur me akuza e përbaltje ndaj tekstit kur'anor. Libri është plot e përplot pështjellime e rrëmujë dhe, nga perspektiva jonë, shkak i shkazmës apo rrëshqitjes së tij të rrezikshme është

¹ Goldziheri, *Medhabib et-tefsir el-islamij*, f. 5.

² El-Kadi, *El-kiraat fi nadhari el-musteshbrikine ve el-mulhidine*, f. 19-20.

pamundësia për t'i kuptuar kiraetet, nga njëra anë, dhe mendjemadhësia e mohimi i qëllimshëm i të vërtetave dhe urtësive të tyre, në anën tjetër¹.

DYSHIM I TRETË DHE KUNDËRPËRGJIGJIA E TIJ

Goldziheri na e përshkruan akuzën e tij të radhës, në faqen e tetë të librit të tij 'Medhabib et-tefsir el-islamijj', ku thotë: 'Një pjesë e madhe e këtyre dallimeve i faturohet karakteristikës së shkrimit arab, struktura e të cilit ofron volume të ndryshme tingujsh, sipas dallimit të pikëve të vëna sipër ose poshtë kësaj strukture, apo sipas numrit të këtyre pikave. Po kështu, edhe në rastin kur nuk ka ndryshime (dallime) në volume tingujsh, ndryshimi i vokaleve, e që në shkrimin e vërtetë arab nuk ka diç që e përcakton (kufizon), bën që pozitat e trajtës së fjalës të pësojnë ndryshime, e rrjedhimisht të ndryshojnë edhe kuptimet e saj. Kështu, dallimi në pikësimin e strukturës së shkrimit dhe dallimi i vokaleve në kuptimin apo përmbajtjen e unifikuar, që ndryshon me ose sipas shkronjave të pazëshme, kanë qenë shkaku i parë në krijimin e lëvizjes së dallimit të kiraeteve në tekstin që, realisht, nuk ka qenë i pikësuar, apo nuk është synuar preciziteti në pikësimin dhe vokalizimin e tij...'²

Dr. Abdul Fettahu bën zhvlerësimin e kësaj akuze duke dhënë shpjegimet në vijim: "Ky, sigurisht, është një mendim i gabuar, sikurse që është një vështrim i çoroditur, pretendim i kotë dhe shpifje e urryer, gjëra për të cilat ka guxim vetëm një njeri sikur Goldziheri, dhe këtë, jo për tjetër, por vetëm që të njollosë gjënë më të shtrenjtë tek besimtarët, Kur'anin Famëlartë dhe të mbjellë dyshime dhe të shkaktojë dilema tek ata se kinse libri i tyre nuk qenka kontrolluar, respektivisht, shprehjet, leximet dhe transmetimet e tij nuk qenkanë verifikuar dhe transmetuar e bartur tek brezat e mëvonshëm me besnikëri dhe sinqeritet."

Fatbardhësisht, këtë mendim e zhvlerësojnë të vërtetat historike, sikurse që e sfidojnë dhe i mposhtin argumentet më të sakta fetare, në përgjithësi e në hollësi, të cilat dëshmojnë se kiraetet (leximet) kanë për bazë dhe burim shpalljen hyjnore (vahjin) dhe transmetimin e

¹ Referenca paraprake, f. 2.

² Goldziheri, *Medhabib et-tefsir el-islamijj*, f. 8.

vërtetë nga i Dërguari [alejhis salatu ves selam] dhe se ato, në fakt, janë një traditë e përcjellë nga i fundit prej të parit, nga pasardhësit prej paraardhësve, nga i Dërguari i Allahut ﷺ prej Xhibrilit, e nga ky i fundit prej Allahut të Madhëruar...¹

Më pas, Shejhu sjell edhe argumentet tradicionale dhe racionale, përmbajtjen e të cilave, si parafrazim, do e sjellim në vijim:

Historia është dëshmia më e mirë se si Kur'anin, me të gjitha leximet dhe transmetimet e tij, para se të jepej urdhri për shkrimin e tij në një Mus'haf nga Halifeja Uthman r.a., është ruajtur përmendsh nga sahabët [Allahu qoftë i kënaqur me ta!], madje edhe para se të bëhej shkrimi i tij në fletushka në kohën e të sinqertit, Ebu Bekrit r.a. Historia, po kështu, dëshmon se edhe leximet dhe transmetimet e Kur'anit janë të sakta dhe të vërteta, për faktin se, përveç të tjerash, edhe në të gjallë të Muhammedit ﷺ ato kanë qenë të përhapura në mesin e njerëzve dhe se askush nuk dyshon në saktësinë dhe vërtetësinë e teksteve dhe zinxhirëve të transmetuesve (senedeve) të këtyre transmetimeve.

Në vazhdim do të përmendim disa nga këto transmetime, për të dëshmuar se vërtetë njeriu nuk ka gisht në to dhe se leximet nuk janë të ndryshme, pasi kjo është karakteristikë e shkrimit arab².

Dëshmia e parë: Buhariu dhe Muslimi transmetojnë në sahihët e tyre nga Ibni Abbasi r.a., se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë:

Xhibrili alejhi selam ma lexonte (Kur'anin) në një germë (lexim), ndërsa unë e shqyrtova dhe kam vazhduar të kërkoj (më shumë lexime

¹ El-Kadi, *El-kiraat fi nadhari el-musteshrikine ve el-mulhidine*, f. 68.

² Dr. Abdul Halim Nexhari, përkthyesi i librit të Goldziherit *Doktrinat e interpretimit të Islamit*, duke u ndërlidhur me tekstin e Goldziherit, ka thënë: “Shkrimi arab nuk ka qenë shkak pse kiraetet janë të ndryshme, përkundrazi, ka qenë ndihmëtar në kuptimin e kiraeteve të vërteta në gjendjen siç kanë qenë kur është shkruar mus'hafi, pra, pa pika dhe vokale... Çështja, së këndejmi, nuk ka të bëjë me shkrimin.” F.8. Shih po kështu *Nedbarat fi ilmi el-kiraat* të dr. Semir bin Jahja Muabbir, f. 73-133.

për t'ua lehtësuar besimtarëve), ndërsa ai më shtonte, derisa mbaroi tek shtatë germat (leximet).”¹

Dëshmia e dytë: Buhariu transmeton në sahihun e tij nga Umer Ibn Hattabi r.a., i cili rrëfen:

Derisa ishte gjallë i Dërguari i Allahut ﷺ, më ra ta dëgjoja Hisham Ibn Hakim Ibn Hizamin tek lexonte nga kaptina el-Furkan sipas leximeve të shumta, që mua i Dërguari i Allahut ﷺ nuk ma pati lexuar ashtu. Gati sa nuk e rroka për koke në namaz, por bëra durim derisa dha selam, kështu që, si e kreu namazin, e kapa për pelerine dhe i thashë: - Kush ta ka lexuar këtë kaptinë që dëgjoja tash ta lexoje (në namaz)? - Ma ka lexuar i Dërguari i Allahut ﷺ, - më tha, ndërsa unë i thashë se gënjente, ngase i Dërguari i Allahut mua ma kishte lexuar ndryshe nga ajo që e kishte lexuar ai. E mora dhe e dërgova tek i Dërguari i Allahut ﷺ dhe i thashë: - E kam dëgjuar këtë njeri të lexonte kaptinën el-Furkan, jo ashtu sipas leximeve që m'i ke lexuar. I Dërguari i Allahut ﷺ më tha: - Lëshoje! - ndërsa atij i tha: - Lexo, o Hisham! Hishami ia lexoi leximin të cilin e dëgjoja më parë ta lexonte (në namaz). I Dërguari i Allahut ﷺ tha: -Kështu është shpallur! Më pastaj tha: -Lexo, o Omer! - ndërsa unë lexova leximin që ai ma pati lexuar. I Dërguari i Allahut tha: -Kështu është shpallur! Vërtetë – shtoi, - ky Kur'an është shpallur në shtatë lexime, andaj lexojeni atë që iu është lehtësuar prej tij!”

Hafidh Ibni Haxher Askalaniu, në Fet'hu-l-Bari, ka thënë:

“Shkaku pse polemizuan Omeri dhe Hishami ishte se, Omeri e kishte dëgjuar leximin e kaptinës më përpara se të dëgjonte hadithin e shpalljes së Kur'anit në shtatë germa (lexime), hadith të cilin e dëgjoi vetëm pas kësaj ndodhie.”²

Dëshmia e tretë: Ubejj Ibn Ka'bi r.a., rrëfen se: Pejgamberi ﷺ ishte tek Edati Beni Gifari ku i erdhi Xhibrili alejhis selam dhe i tha: Vërtetë, Allahu të urdhëron që t'ia lexosh Kur'anin ummetit tënd

¹ Hadithin e shënojnë Buhariu, nr. 4491, dhe Muslimi, nr. 1354.

² Hadithin e shënon Buhariu.

sipas një germe (leximi)! Pejgamberi ﷺ tha: E lus Allahun për ndjesë dhe falje, por ummeti im nuk mund ta përballojnë një gjë të tillë! Pastaj i erdhi për herë të dytë dhe i tha: Vërtetë, Allahu të urdhëron që t'ia lexosh Kur'anin ummetit tënd sipas dy germave (leximeve)! Pejgamberi ﷺ tha: E lus Allahun për ndjesë dhe falje, por ummeti im nuk mund ta përballojë një gjë të tillë! Pastaj erdhi për të tretën herë dhe tha: Vërtetë, Allahu të urdhëron që t'ia lexosh Kur'anin ummetit tënd sipas tri germave (leximeve)! Pejgamberi ﷺ tha: E lus Allahun për ndjesë dhe falje, por ummeti im nuk mund ta përballojë një gjë të tillë! Pastaj erdhi për të katërtën herë dhe tha: Vërtetë, Allahu të urdhëron që t'ia lexosh Kur'anin ummetit tënd, sipas shtatë germave (leximeve) ndërsa ata, sipas cilësdo germë (cilit do lexim) të lexojnë, ia kanë qëlluar!"¹

Shejhu Abdul Fettah sjell dhe argumente të tjera, që dëshmojnë po kështu se leximet janë çështje të përcaktuara fetarisht, që nuk ndryshojnë dotë (ar. teukifijeh) dhe se referencë për to është i Dërguari i Allahut ﷺ, i cili i transmeton ato nga Xhibrili alejhis selam e ky nga Allahu i Lartësuar.

Përveç kësaj që përmendëm, lënda el-Ikra (lexim) është përsëritur në hadithe, gjë që dëshmon se leximet janë vërtetuar sipas mënyrës tradicionale (shpalljes) dhe se ato janë marrë e transmetuar gojarisht, sikurse që sahabët -*Allahu qoftë i kënaqur me ta!*- kanë qenë jashtëzakonisht të kujdesshëm sa i përket shprehjeve të Kur'anit dhe zotërimit të fjalëve dhe shkronjave (germave) të tij. Konsideroj se argument më të mirë, për çështjen në fjalë, se sa rasti i Omer Ibn Hattabit me Hisham Ibn Hakemin nuk na duhet².

Shejh Abdul Fettahu sjell dhe argumente racionale për të zhvlerësuar teorinë e Goldziherit. Ai thotë se kur Halifeja Uthman Ibn Affani dërgoi ekzemplarët e Kur'anit nëpër vendet islame, dërgoi po kështu edhe dijetarë që t'ua mësonin njerëzve Kur'anin, sipas Mus'hafit të dërguar dhe sipas asaj që ai parasheh. Kështu, Zejd Ibn Thabitin e dërgoi lexues në Medinë, Abdullah Ibn Saibin në Mekë, Mugire Ibn

¹ Hadithin e shënon Muslimi, nr. 820.

² El-Kadi, *El-kiraat fi nadhari el-musteshbrikin ve el-mulhidine*, f. 78-120.

Shihabin në Sham, Amir Ibn Abdu Kajsin në Basra dhe Ebu AbduRrahman Selemiun në Kufe. Secili prej këtyre dijetarëve ua lexonte Kur'anin banorëve vendas sipas leximit mutavahir (më të saktë të mundshëm) të cilin e kishte mësuar nga i Dërguari i Allahut [alejhis salatu ves selam] dhe që figuronte në shkrimin e Mus'hafit, pa u ndaluar fare tek leximet e tjera, që nuk ishin vërtetuar saktësisht, edhe nëse shkrimi i Mus'hafit mund t'i përmbante figurativisht ato. Kësisoj, qëllimi i dërgimit të një lexuesi me një kopje të Kur'anit ishte, që leximi të mos dilte jashtë suazave të llojit të vërtetuar sipas mënyrës më të saktë – mutevahir, ndryshe, do të krijohesh mundësia që kushdo ta lexonte Kur'anin si të donte, pavarësisht nëse leximi i tij ishte vërtetuar apo jo. Por jo, Uthmani dërgoi lexues që t'ua mësonin njerëzve leximet, jo të vërtetuara sipas shkrimit, por sipas traditës¹.

Kundërpërgjigje e saktë dhe e detajuar shkencërisht, në të cilën prerazi dhe bindshëm dëshmohet se si kiraetet nuk kanë të bëjnë me shkrimin, por me të mësimit të tyre gojë më gojë dhe me transmetim nga njëri tek brezi tjetër.

Përgjatë shpjegimeve që ka ofruar hoxha Abdul Fettah Kadiu, ndërsa zhvlerësonte prezentimet e pabaza të Goldziherit për kiraetet, ka përmendur llojet e kiraeteve të cilat janë me probabilitet dhe mundësi leximi sipas shkrimit apo resmit Uthman. Ka thënë më saktësisht: “*Po të supozonim se mosvokalizimi i Kur'anit është shkak i llojllojshmërisë së kiraeteve dhe dallimeve ndërmjet tyre, do t'i binte se secili lexim që është i mundshëm sipas shkrimit Uthman është i saktë dhe i pranuar, por puna nuk është kështu. Leximet që janë të mundshme sipas shkrimit Uthman janë katër lloje:*

¹ El-Kadi, *El-kiraat fi nadhari el-musteshbrikin ve el-mulhidine*, f. 78-120.

Llojet e kiraeteve				
	Shembuj	Norma	Probabiliteti sipas shkrimit Uthman	Rregulli në vërtetimin e kiraetit
1.	<p>Ajeti 13 nga kaptina Isra:</p> <p>﴿وَأُخْرِجْ لَهُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ كِتَابًا يَلْقَاهُ مَنشُورًا﴾ ﴿١٣﴾</p> <p>Folja <i>nubrixhu</i> (وَأُخْرِجْ) është lexuar në tre forma:</p> <p>1) <i>Nubrixhu</i> (أُخْرِجْ) 2) <i>Jubrexhu</i> (يُخْرِجْ), dhe 3) <i>Jabruxbu</i> (يَخْرِجْ).¹</p>	<p>Të tria këto forma të leximit janë vërtetuar tevaturisht, pra sipas mënyrës më të saktë të mundshme të transmetimit.</p>	<p>Që të tria janë të mundshme sipas shkrimit Uthman.</p>	<p>Transmetimi, jo shkrimi.</p>
2.	<p>Ajeti 58 nga kaptina A'rafë:</p> <p>﴿وَالَّذِي حَبِطَ لَا يُخْرَجُ إِلَّا نَكِدًا﴾</p>	<p>Është vërtetuar nëpërmjet transmetimit ahad. Vargu i transmetuesve është i saktë duke u përcjellë nga njëri</p>	<p>Shkrimi i mus'hafit i pranon.</p>	<p>Transmetimi, jo shkrimi siç ka pretenduar Goldziheri.</p>

¹ “**Nuhrixhu**” –Ebu Xhaferi e ka lexuar *jubrexhu*, Ja’kubi e ka lexuar *jabruxbu* ndërsa të tjerët *nubrixhu*. Shih: El-Kadi, *El-budur ez-zahire fi-l-kiraat el-ashere el-mutevatire*, 1/184; Xhezeri, *Sherhu Tibeti en-neshri*, f. 262.

<p>Folja <i>jahruxbu</i> është lexuar edhe <i>jubrixhu</i> (جُخْرُج).¹</p> <p>Po kështu ajeti 19 nga kaptina Teube:</p> <p>﴿ أَجْعَلْتُمْ سِقَايَةَ الْحَاجِّ وَعِمَارَةَ الْمَسْجِدِ الْحَرَامِ كَمَنْ آمَنَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ ﴾</p> <p>Fjala <i>sikaje</i> (سِقَايَةَ) është lexuar sukat (سُقَاة)², shumës i fjalës <i>saki</i> (سَاقِي), m’u ashtu siç shumëzohet fjala <i>rami</i> (رَامِي) në <i>rumat</i> (رَمَاة).</p>	<p>tek transmetuesi tjetër i drejtë e besnik, dhe këtë nga fillimi e deri në mbarim të vargut të transmetuesve. Si forma të leximit janë të njohura tek ekspertët e kësaj fushe. Pavarësisht transmetimit ahad, ato janë pranuar nga dijetarët për shkak të senedit të saktë dhe përhapjes së tyre në mesin e lexuesve. Që të dyja këto lexime pranohen dhe konsiderohen Kur’an me të cilin e adhurojmë</p>		
---	---	--	--

¹ “La jahruxbu il-la nekida” –Ibën Virdani e ka elxuar juhrixhu ndërsa të tjerët jahruxbu. Në fakt, sipas kësaj të dytës, e ka lexuar po kështu edhe Ibën Virdani, në një version të dytë të tij. Ebu Xhaferi german kaf e ka elxuar me zanoren e (nekeda) ndërsa të tjerët me zanoren i (nekida). Shih: El-Kadi, *El-budur ez-zahire fi-l-kiraat el-ashere el-mutevatire*, 1/118. Shih edhe: *Sherh Tibeti-neshër*, f. 235.

² “*Sikajetu-l-haxhi ve imaretu*” –Ibën Virdani e ka lexuar *Sukat*, duke e fshirë *elifin* ndërsa fjalën *imare* e ka lexuar duke e vokalizuar *ajnin* me zanoren *e* dhe duke e fshirë *elifin* pas germës *mim*. Të tjerët e kanë lexuar *sikaje* dhe *imare*. Shih: El-Kadi, *El-budur ez-zahire fi-l-kiraat el-ashere el-mutevatire*, 1/.

	<p>Siç mund të shihet, përveç ndryshimit në vokalizim (nga <i>sikaje</i> në <i>sukat</i>), është fshirë dhe bashkëtingëllorja <i>j</i>.</p> <p>Po kështu fjala imareh (عِمَارَةٌ) është lexuar <i>amereh</i> (عَمْرَةٌ), pra duke e fshirë <i>elijin</i> dhe duke e lexuar si shumës të fjalës <i>amir</i> (عَامِر), ngjashëm siç shumëzohet emri <i>sanië</i> (صَانِع) në <i>saneah</i> (صِنْعَةٌ).</p>	<p>Allahun në namaz dhe jashtë tij. Së këndejmi, duhet pranuar domosdoshmërisht sepse refuzimi i tyre nënkupton kufër ose femohim.</p>		
3.	<p>Ajeti 69 nga kaptina Ahzabë:</p> <p>﴿وَكَانَ عِنْدَ اللَّهِ وَجِيهًا﴾ ﴿٦٩﴾</p> <p>Pjesa “...ve kanë inde Allahi vexhiben?” (وَكَانَ عِنْدَ اللَّهِ وَجِيهًا) është lexuar: “...ve kanë abden li-l-Labi vexhiben?”</p>	<p>Është vërtetuar sipas mënyrës <i>abad</i> të transmetimit. Ka sened të saktë por si mënyrë e leximit nuk është e njohur dhe ekspertët e kiraeteve nuk e kanë pranuar.</p>	<p>Refuzohet ky lloj leximi, qoftë gjatë namazit qoftë jashtë tij. Nuk lejohet të lexohet me qëllim adhurimi sepse nuk pranohet.</p>	<p>Transmetimi, jo shkrimi siç ka pretenduar Goldziheri.</p>

4.	<p>Ajeti 114 nga kaptina Teube:</p> <p>﴿ وَمَا كَانَ اسْتِغْفَارُ إِبْرَاهِيمَ لِأَبِيهِ إِلَّا عَن مَّوْعِدَةٍ وَعَدَّهَا إِيَّاهُ ﴾</p> <p>Fjala ijyahu (إِيَّاهُ) është lexuar <i>ebab</i> (أباه).</p>	<p>Nuk është vërtetuar dhe në fakt nuk ka fare sened. Kjo nuk kosndierohet Kur'an dhe nuk lejohet adhurimi me të. Me konsensus të diejtarëve, ndalohet leximi i Kur'anit sipas kësaj forme.</p>	<p>Lloji i tretë dhe katërt janë të mundshme sipas shkrimit Uthman.</p>	<p>Transmetimi, jo shkrimi siç ka pretenduar Goldziheri.</p>
----	---	---	---	--

Kjo ishte sa i përket asaj se cilat kiraete janë të mundshme sipas shkrimit Uthman e cilat jo. Hoxha Abdul Fettah Kadi nuk ka mjaftuar me kaq. Për t'i zhvlerësuar maksimalisht akuzat dhe dyshimet e Goldziherit, këtij injoranti dhe armiku të kiraeteve kur'anore, është zgjeruar duke sjellë shembuj të shumtë, që ta konfirmojë se kriter për kiraete është dëgjimi, mësimi i tyre gojë më gojë dhe përcjellja sipas mënyrës më të saktë të transmetimit -tevaturit, jo veçorive të shkrimit arab apo shkrimit (resmit) Uthman. Dr. Abdul Fettah Kadiu, si shembuj argumentimi, sjell fjalët në vazhdim:

Fjalë kur'anore të shoqëruara me analiza dhe shpjegime për llojllojshmërinë e leximit të tyre, nëpërmjet të cilave konfirmohet besnikëria, përpikëria dhe mjeshtëria e lexuesve të Kur'anit.				
Fjalët kur'anore me lexime të ndryshme				
1.	مَالِك ¹	مَلِك	Është përmendur në tre vende në Kur'an:	
			Fatiha, 4:	مَالِكِ يَوْمِ الدِّينِ
			Al Imran, 26:	قُلِ اللَّهُمَّ مَالِكِ الْمُلْكِ تُؤْتِي الْمُلْكَ مَنْ تَشَاءُ وَتَنْزِعُ الْمُلْكَ مِمَّن تَشَاءُ
			Nas, 2:	مَلِكِ النَّاسِ

¹ Asimi, Kesaiu, Ja'kubi dhe Halefi e kanë lexuar me *elif* (*Malik*) ndërsa të tjerët pa *elif* (*Melik*). Shih: El-Kadi, *El-budur ez-zahire fi-l-kiraat el-ashere el-mutevatire*, 1/15.

			<p>Në të tria vendet është shkruar njëjtë, pra duke e fshirë elifin pas mim-it, por lexuesit vetëm në rastin e kaptinës fatiha nuk e kanë lexuar njëjtë¹. Më saktë, disa e kanë lexuar me e disa pa elif (pra disa e kanë lexuar Maliki e disa Meliki). Ndërsa në kaptinën Nas, e kanë lexuar të gjithë pa elif: “مَلِكِ النَّاسِ” -Meliki-n-nas. Edhe po të lexohej me elif, nuk është se gjuhësisht do të ndërronte kuptim, por për shkak se nuk është transmetuar. Kjo flet se kiraetet vërtetohen sipas transmetimeve, jo sipas shkrimit, dhe, dallimet e tyre këtu nuk do të kishin të bënin vetëm me kaptinën fatiha, por edhe me dy rastet tjera në dy kaptinat që përmendëm më parë (Al Imran dhe Nas). Fakti se kuratë nuk e kanë bërë këtë flet se ata mbështeten në transmetime, jo në resm dhe shkrim².</p>
2.	غِشَاوَةٌ	عَشْوَةٌ ³	<p>Kjo fjalë është përmendur në Kur'an në dy vende: në kaptinën bekare, në ajetin 7 “وَعَلَىٰ أُبُصَارِهِمْ غِشَاوَةٌ” dhe në</p>

¹ Rreth ndikimi të kiraeteve në normat dhe shkencat fetare, shih: Al Ismail, *Ilmu el-kiraat: nesh'etubu, atvaruhu, etheruhu fi el-ulum esb-sber'ijeh*, f. 70, 223, 365. Është një nga punimet më të mira në këtë aspekt.

² El-Kadi, *El-kiraat fi nadhari el-musteshrikine ve el-mulhidine*, f. 48-53.

³ Shih: Ibën Halvejh, *Mubtesar fi shevadh el-Kur'an min kitab El-bidee*, f. 10. Shih po kështu: Kadi, *El-kiraat eshsbadbeh...*, f. 27.

			<p>وَجَعَلَ “ 23 اَیْتِیْنِ خِثَابِیْنِ، نَبِیُّنِ ۲۳ ” عَلَىٰ بَصَرِهِ عِشَاوَةٌ</p> <p>Disa e kanë lexuar <i>gashveh</i> (عِشْوَةٌ). Po të lexohej kështu në kaptinën bekarë, gjuhësisht mund të jetë e pranuar, por askush nuk e ka bërë këtë për shkak se nuk ka test që vërteton leximin në këtë mënyrë. Edhe kjo është dëshmi se kiraetet mbështeten vetëm në transmetime, jo në shkrim e resm.</p>								
3.	الصَّاعِقَةُ	الصَّعِقَةُ ¹	<p>Kjo fjalë në Kur’an përmendet e shquar dhe e pashquar në gjashtë vende:</p> <table border="1"> <tr> <td>Bekare, 55:</td> <td>فَأَخَذَتْكُمُ الصَّاعِقَةُ وَأَنْتُمْ تَنْظُرُونَ</td> </tr> <tr> <td>Nisa, 153:</td> <td>فَأَخَذَهُمُ الصَّاعِقَةُ بِظُلْمِهِمْ</td> </tr> <tr> <td>Fussilet, 13²:</td> <td>فَإِنْ أَعْرَضُوا فَقُلْ أَنْذَرْتُكُمْ صَاعِقَةً مِثْلَ صَاعِقَةِ عَادٍ وَثُمُودَ</td> </tr> <tr> <td>Fussilet, 17:</td> <td>فَأَخَذَهُمُ الصَّاعِقَةُ الْعَذَابِ الْهُونِ بِمَا كَانُوا يَكْسِبُونَ</td> </tr> </table>	Bekare, 55:	فَأَخَذَتْكُمُ الصَّاعِقَةُ وَأَنْتُمْ تَنْظُرُونَ	Nisa, 153:	فَأَخَذَهُمُ الصَّاعِقَةُ بِظُلْمِهِمْ	Fussilet, 13 ² :	فَإِنْ أَعْرَضُوا فَقُلْ أَنْذَرْتُكُمْ صَاعِقَةً مِثْلَ صَاعِقَةِ عَادٍ وَثُمُودَ	Fussilet, 17:	فَأَخَذَهُمُ الصَّاعِقَةُ الْعَذَابِ الْهُونِ بِمَا كَانُوا يَكْسِبُونَ
Bekare, 55:	فَأَخَذَتْكُمُ الصَّاعِقَةُ وَأَنْتُمْ تَنْظُرُونَ										
Nisa, 153:	فَأَخَذَهُمُ الصَّاعِقَةُ بِظُلْمِهِمْ										
Fussilet, 13 ² :	فَإِنْ أَعْرَضُوا فَقُلْ أَنْذَرْتُكُمْ صَاعِقَةً مِثْلَ صَاعِقَةِ عَادٍ وَثُمُودَ										
Fussilet, 17:	فَأَخَذَهُمُ الصَّاعِقَةُ الْعَذَابِ الْهُونِ بِمَا كَانُوا يَكْسِبُونَ										

¹ “*Essaikatu*” –Kesaiu e ka lexuar pa *elif* dhe pa mos e vokalizuar germën *ajn* fare (pra *essa’kab*) ndërsa të tjerët me *elif* dhe duke e vokalizuar germën *ajn* me *i* (pra *essâikatu*). Shih: El-Kadi, *El-budur ez-zahire fi-l-kiraat el-ashere el-mutevatire*, 1/3048.

² Siç mund të shihet, në këtë ajet kjo fjalë përmendet dy herë. Përkthyesi.

			Dharijat, 44:	فَعَتَوْا عَنْ أَمْرِ رَبِّهِمْ فَأَخَذَهُمُ الصَّاعِقَةُ وَهُمْ يَنْظُرُونَ
			<p>Ky ajet në të gjithë mus'hafët osmanë figuron pa elif, pasi lexuesit janë pajtuar se në pesë rastet e para lexohet me elif duke vokalizuar shkronjën pasuese <i>ajnin</i> me <i>kesre</i> (zanoren <i>i</i>) përderisa në rastin e gjashtë kanë mospajtime, se a duhet vepruar kështu apo duhet fshirë elifin duke mos e vokalizuar me këtë rast shkronjën <i>ajin</i> fare (pra, duke e lexuar <i>es sa'kab</i> - الصَّعَقَةُ).</p> <p>Po të ishin kiraetet sipas resmit, kuratë do të dallonin edhe në pesë rastet e para, siç dalluan në rastin e gjashtë, por nuk e bën këtë për të dëshmuar kështu se kiraetet i referohen vetëm transmetimeve, jo shkrimit dhe resmit.</p>	
4.	كُرْهًا ¹	كُرْهًا ²	Al Imran, 83 ³ :	أَفَعَيِّرُ دِينَ اللَّهِ يَتَّبِعُونَ وَلَهُ أَسْلَمَ مَنْ فِي السَّمَاوَاتِ

¹ Hamza dhe Kesaiu në kaptinat Nisa dhe Teube e kanë lexuar *kurben*, ndërsa të tjerët *kerben*. Shih: Eddani, *Ettejsir fi el-kiraat esseb'i*, f. 95.

² Hamza, Kesaiu dhe Halefi e kanë lexuar *kurhen* ndërsa të tjerët *kerhen*. Shih: El-Kadi, *El-budur ez-zabire fi-l-kiraat el-ashere el-mutevatire*, 1/137.

³ Të gjithë lexuesit e kanë lexuar *kerben* në kaptinat Al Imran, Ra'd dhe Fussilet sepse konteksti i ajeteve nuk e lejon ndryshe. Shih: *Hirx el-emani*, f. 44-47; 57-58; 62-63.

			وَالْأَرْضِ طَوْعًا وَكَرْهًا وَإِلَيْهِ يُرْجَعُونَ
			Nisa, 19: يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا يَحِلُّ لَكُمْ أَنْ تَرْتُبُوا النِّسَاءَ كُرْهًا
			Teube, 53: قُلْ أَنْفِقُوا طَوْعًا أَوْ كَرْهًا لَنْ يُتَقَبَّلَ مِنْكُمْ
			Ra'd, 15: وَلِلَّهِ يَسْجُدُ مَنْ فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ طَوْعًا وَكَرْهًا وَظِلَالُهُمْ بِالْغُدُوِّ وَالْآصَالِ
			Fussilet, 11 ¹ : ثُمَّ اسْتَوَىٰ إِلَى السَّمَاءِ وَهِيَ دُخَانٌ فَقَالَ لَهَا وَلِلْأَرْضِ ائْتِيَا طَوْعًا أَوْ كَرْهًا قَالَتَا أَتَيْنَا طَائِعِينَ
			Ahkaf, 15 ² : وَوَصَّيْنَا الْإِنْسَانَ بِوَالِدَيْهِ إِحْسَانًا حَمَلَتْهُ أُمُّهُ كُرْهًا وَوَضَعَتْهُ كُرْهًا
5.	يُحْزِنُ <i>Jahzenu</i>	يُحْزِنُ ³ <i>Juhzīnu</i>	Të përmendura në ajetet: En'amë, 33: قَدْ نَعْلَمُ إِنَّهُ لَيَحْزُنُكَ الَّذِي يَقُولُونَ

¹ Të gjithë lexuesit e kanë lexuar *kerben* sepse konteksti i ajetit nuk e lejon ndryshe.

² El-Kadi, *El-kiraat fi nadhari el-musteshrikine ve el-mulhidine*, f. 55-58.

³ “*Ve la jahzunkë*” –Nafiu e ka lexuar *juhzīnukë* ndërsa të tjerët *jahzūnukë*.
Shih: El-Kadi, *El-budur ez-zabire fi-l-kiraat el-ashere el-mutevatire*, 1/78.

			Jasin, 76:	فَلَا يَحْزُنكَ قَوْلُهُمْ
			Muxhadele, 10:	إِنَّمَا النَّجْوَى مِنَ الشَّيْطَانِ لِيَحْزُنَ الَّذِينَ آمَنُوا
			Në arabisht lexohet <i>haxzenebu</i> dhe <i>ahzenebu</i> me kuptim kur diç të brengosë.	
6.	مَدْخَالًا <i>Med'balen</i>	مُدْخَالًا ¹ <i>Mud'balen</i>	Është përmendur në kaptinat:	
			Nisa, 31:	إِن يَجْتَبِئُوا كِبَارًا مَّا تُنْهَوْنَ عَنْهُ نُكَفِّرْ عَنْكُمْ سَيِّئَاتِكُمْ وَنُدْخِلْكُمْ مُدْخَالًا كَرِيمًا
			Haxh, 59:	لِيُدْخِلْنَهُمْ مُدْخَالًا يَرْضَوْنَهُ
			Disa e kanë lexuar germën <i>mim</i> me zanoren <i>u</i> e disa të tjerë me zanoren <i>e</i> përderisa janë dakorduar që në kaptinën Isra, ajeti 80, të lexohet me zanoren <i>u</i> : “وَقُلْ رَبِّ أَدْخِلْنِي مُدْخَلَ صِدْقٍ” “وَأَخْرِجْنِي مُخْرَجَ صِدْقٍ وَاجْعَلْ لِي مِنْ لَدُنْكَ سُلْطَانًا نَّصِيرًا” Në fakt, gjuhësisht, mund të lexohet edhe këtu me zanoren <i>e</i> , sikur në dy rastet e para që mund të lexohet ashtu dhe kështu, pasi lexuesit nuk e kanë bërë në rastin e kësaj kaptine për shkak se nuk ka transmetim.	

¹ “*Mud'balen*” –Nafiu dhe Ebu Xhaferi e kanë lexuar *med'balen* ndërsa të tjerët *mud'balen*. Shih: El-Kadi, *El-budur ez-zahire fi-l-kiraat el-ashere el-mutevatire*, 1/78.

7.	¹ تُخْرَجُونَ <i>Tubrexhune</i>	² تَخْرَجُونَ <i>Tabruxhune</i>	Për shkak të hapësirës së pamjaftueshme në këtë studim, vetëm do të aludojmë në kaptinat dhe ajetet pa e përmendur tekstin. Në kaptinat A'rafë, ajeti 25, Rrum, ajeti 19, Zuhruf, ajeti 11 dhe Xhathije, ajeti 35, lexuesit kanë thënë se mund të lexohen me zanoret <i>u</i> dhe <i>e</i> , përkatësisht <i>tubrexhune</i> dhe <i>tabruxhune</i> përderisa në rastin e dytë nga kaptina Rrum, ajeti 25, kanë thënë se mund të lexohet vetëm në një variant, përkatësisht <i>tabruxhune</i> . Edhe pse gjuha e lejon edhe variantin e mëparmë, për shkak të mungesës së transmetimit, lexohet vetëm në variantin e dytë, sepse kiraetet vërtetohen sipas transmetimeve, jo sipas gjuhës dhe shkrimit.
----	---	---	---

¹ “*Ve kedhalike tubrexhunë*” –Hamza, Kesaiu, Halefi dhe Ibën Dhekvani e kanë lexuar duke e vokalizuar germën *ta* me zanoren *e* dhe germën *ra* me zanoren *u* (pra *tabruxhune*) përderisa të tjerët duke e vokalizuar germën *ta* me zanoren *u* dhe germën *ra* me zanoren *e* (pra *tubrexhune*). Shih: El-Kadi, *El-budur ez-zahire fi-l-kiraat el-ashere el-mutevatire*, 1/248.

² “*Idh entum tabruxhune*” –janë dakorduar që të lexohet duke vokalizuar germën *ta* me zanoren *e* dhe *ra*-në me zanoren *u*, pra *tabruxhune*. Shih: El-Kadi, *El-budur ez-zahire fi-l-kiraat el-ashere el-mutevatire*, 1/248.

8.	الرُّشْدُ ¹ <i>Rreshed</i>	رُشْدًا ² <i>Rushden</i>	<p>Lexuesit nuk kanë pajtuar rreth asaj se kjo shprehje a duhet të lexohet me vokalizimin e germës <i>ra</i> me zanoren <i>u</i> dhe mosvokalizimin fare të germës <i>shin</i> apo të vokalizimit të të dyja germave me zanoren <i>e</i>, dhe këtë pavarësisht se kjo fjalë është apo jo e shquar. Fjala është për rastet në kaptinat A'rafë, ajeti 146, Kehf, ajete 10, 24 dhe 66, dhe Xhin, ajetet 10, 14, 21.</p> <p>Të dyja versionet e leximit janë të praktikuara ndër arabët. Lexuesit kanë pajtuar që në disa vende të lexohen vokalizimet e germave <i>ra</i> dhe <i>shin</i> me zanoren <i>e</i> ndërsa në vende tjera nuk kanë pajtuar. Ajo që u tha për shembujt paraprakë se kriter mbetet transmetimi, jo resmi thuhet edhe këtu.</p>
9.	ضَرًّا <i>Darren</i>	ضُرًّا <i>Durren</i>	<p>Ajo që është thënë për shembujt e mëparshëm thuhet edhe këtu. Janë dy variante gjuhësore të përdorura nga arabët dhe të transmetuara po kështu.</p>

¹ “*Sebil err-rrushd*” – Hamza, Kesaiu dhe Halefi e kanë lexuar duke i vokalizuar gërmat *ra* dhe *shin* me zanoren *e* (*rashed*) ndërsa të tjerët duke e vokalizuar gërmën *ra* me zanoren *u* ndërsa gërmën *shin* me *sukun*, pra *rrushd*. Shih: El-Kadi, *El-budur ez-zabire fi-l-kiraat el-ashere el-mutevatre*, 1/124.

² “*Resbeden*” – basriasisit (Ebu Amri dhe Ja’kubi) e kanë lexuar *resbeden* përderisa të tjerët *rushden*. Shih: El-Kadi, *El-budur ez-zabire fi-l-kiraat el-ashere el-mutevatre*, 1/153.

10.	حَزْنًا <i>Haznenen</i>	حُزْنًا <i>Huznenen</i>	Kjo shprehje, e shquar apo e pashquar qe, është përmendur në pesë vende në Kur'an. Ka ardhur në dy variante me një kuptim. Më saktë, ka ardhur duke qenë germa <i>ha</i> e vokalizuar me zanoren <i>u</i> ndërsa germa <i>zaj</i> e pavokalizuar (<i>huznenen</i>). Po kështu ka ardhur edhe me germat <i>ha</i> dhe <i>zaj</i> të vokalizuara me zanoren <i>e</i> (<i>haznenen</i>). Por, lexuesit vetëm në rastin e kaptinës <i>Kasas</i> nuk kanë një mendim, nëse duhet të lexohet sipas versionit të parë ose të dytë përderisa në katër vendet tjera janë dakord sa i përket një forme të vetme të leximit.
11.	فَعِمَيْتَ ¹ <i>Fe-amijet</i>	فُعُمَيْتَ <i>Fe-ummijet</i>	Në kaptinën Hud, ajeti 28, është lexuar duke e vokalizuar germën <i>ajn</i> me zanoren <i>u</i> si dhe duke e dyfishuar germën <i>mim</i> përderisa në kaptinën <i>Kasas</i> , ajeti 66, është lexuar duke e vokalizuar germën <i>ajn</i> me zanoren <i>e</i> ndërsa germën <i>mim</i> me zanoren <i>i</i> . Të dy versionet janë të sakta dhe të përdorura nga arabët dhe të mundshme sipas resmit osman por lexuesit, edhe nëse në rastin e kaptinës Hud e kanë lexuar ndryshe, në rastin e kaptinës <i>Kasas</i> e kanë

¹ “*Fe-amijet*” – Hafsi, Hamza, Kesaiu dhe Halefi e kanë lexuar duke e vokalizuar germën *ajn* me zanoren *u* dhe duke e dyfishuar germën *mim* (pra *ummijet*), përderisa të tjerët e kanë lexuar *ajn*-in me zanoren *e* ndërsa *mim*-in nuk e kanë dyfishuar (pra *amijet*). Shih: El-Kadi, *El-budur ez-zahire fi-l-kiraat el-ashere el-mutevatire*, 1/153.

			lexuar njëjtë të gjithë për shkak të transmetimit.
12.	نَسْقِيهِ <i>Neskijehu</i>	نُسْقِيهِ ¹ <i>Nuskijehu</i>	Në kaptinat Nahël, ajeti 66 dhe Mu'minunë, ajeti 21, është lexuar duke e vokalizuar germën <i>nun</i> me zanoren <i>e</i> (<i>neskikum</i>) por është lexuar edhe duke e vokalizuar germën <i>nun</i> me zanoren <i>u</i> (<i>nuskikum</i>). Është lexuar edhe duke e zëvendësuar germën <i>nun</i> me germën <i>ta</i> (<i>teskikum</i>). Ndërsa sa i përket ajetit 49 nga kaptina Furkan (وَنُسْقِيهِ بِمَا خَلَقْنَا أَنْعَامًا وَأَنْآسِيَّ كَثِيرًا) janë dakorduar të lexohet vetëm me germën <i>nun</i> edhe pse resmi lejon të lexohen të tri leximet (<i>neskikum</i> , <i>nuskikum</i> , <i>tesikum</i>) për shkak të mospikësimit të mus'hafit por këtë nuk e kanë bërë lexuesit për shkak se i janë referuar transmetimeve ku ky leximi i fundit nuk qëndron.
13.	كِسْفًا <i>Kisfen</i>	كِسْفًا ² <i>Kisfen</i>	E përmendur në kaptinat Isra, ajeti 92, Shuara, ajeti 187, Rrum, ajeti 48, Sebe', ajeti 9, Tur, ajeti 44.

¹ “*Nuskikum*” – Nafiu, Shamiu, Shu’be dhe Ja’kubi e kanë lexuar germën *nun* me zanoren *e* (pra *neskikum*) ndërsa të tjerët e kanë lexuar me zanoren *u* (pra *nuskikum*). Shih: El-Kadi, *El-budur ez-zabire fi-l-kiraat el-ashere el-mutevatre*, 1/180.

² “*Kisfen*” – janë pajtuar të gjithë që në kaptinën Tur të lexohet pa mos e vokalizuar fare germën *sin* (pra *kisfen*). Shih: El-Kadi, *El-budur ez-zabire fi-l-kiraat el-ashere el-mutevatre*, 1/306. Ndërsa Nafiu, Ebu Xhaferi, Ibën Amiri dhe Asimi e kanë lexuar duke e vokalizuar germën *sin* me zanoren

			Lexuesit nuk kanë një mendim sa i përket leximit të kësaj fjale në katër rastet e para. Disa e kanë lexuar germën <i>sin</i> të vokalizuar me <i>e</i> e disa fare të pavokalizuar. Ndërsa në rastin e pestë të gjithë njëzëri kanë pohuar se germa <i>sin</i> lexohet e pavokalizuar pavarësisht që gjuha arabe dhe konteksti i ajetit do ta lejonin edhe ndryshe por lexuesit nuk e kanë bërë duke i mbetur besnikë transmetimeve.
14.	يُنْفَعُ <i>Junfebu</i>	نَنْفَعُ <i>Nenfubu</i>	E përmendur në tre kaptina: Taha, ajeti 102; Nemël, ajeti 87, dhe Nebe', ajeti 1. Në kaptinën Taha është lexuar me gerrat <i>nun</i> dhe <i>ja</i> përderisa lexuesit për dy kaptinat tjera, Nemël dhe Nebe', njëzëri janë deklaruar se lexohet vetëm me germën <i>ja</i> edhe pse konteksti në të cilin ka ardhur fjala në këto dy kaptina do ta lejonte të lexohej edhe me germën <i>nun</i> por lexuesit nuk e kanë bërë ngase nuk ka transmetim.
15.	سُحْرِيًّا <i>Subrijjen</i>	سِحْرِيًّا <i>Sibrijjen</i>	Është përmendur në kaptinat Mu'minunë, ajeti 110 dhe Sad, ajeti 63, ku është lexuar duke e vokalizuar germën <i>sin</i> me zanoren <i>u</i> (<i>subrijjen</i>) në

e (pra *kisefen*). Të tjerët e kanë lexuar germën *sin* me sukun, pra të pavokalizuar. Hafsi e ka lexuar me vokalin *e* në dy rastet, në kaptinën shuara dhe atë sad ndërsa Ibën Dhekrvani dhe Ebu Xhaferi në kaptinën Rrum, ndryshe nga ajo që përmendëm, e kanë lexuar me sukun. Shih: *Sherhu Tibeti-n-nesbri*, f. 266.

			<p>kaptinën e parë dhe me zanoren <i>i</i> (<i>sibrijjen</i>) në kaptinën e dytë (Sad). Lexuesit janë dakorduar se në kaptinën Zuhruf, ajeti 32, ajo lexohet vetëm me zanoren u edhe pse gjuhësisht do të kishte të njëjtin kuptim dhe po të lexohej me i, për shkak të kuptimit të njëjtë që kanë. Po të mos varej kiraeti nga transmetimi, edhe këtu mund të mos kishin pajtuar lexuesit, por nuk e kanë bërë, duke na lënë kështu të kuptojmë se leximi i saktë është vetëm ai që mbështetet në transmetim, jo shkrim e resm.</p>
<p>Fjalë tjera në Kur'an që nuk janë të pikësuara dhe as të vokalizuar e që sipas resmit mund të lexohen në disa forma, duke mos u ndeshur me rregullat e arabishtes, por megjithatë, kuratë nuk i kanë lexuar ashtu por vetëm sipas një leximi për të cilin ka transmetim.</p>			
16.	<p>يَخْطَفُ <i>Jabtafu</i></p>	<p>يَخْطِفُ <i>Jahtifu</i></p>	<p>Lexohet në dy forma: <i>hatife</i> (حَطِفَ) dhe <i>batafe</i> (حَطَفَ). Lexuesit janë të një mendimi se në kohën e kaluar lexohet e vokalizuar me zanoren <i>i</i> (<i>hatife</i>) dhe në të tashmën me <i>e</i> (<i>batafe</i>), siç qëndron në ajetet 20 nga kaptina bekare: “يَكَادُ الْبَرْقُ يَخْطَفُ أَبْصَارَهُمْ” dhe 10 nga kaptina safat: “إِلَّا مَنْ خَطِفَ الْخَطْفَةَ فَأَتْبَعَهُ شِهَابٌ ثَائِبٌ”.</p>
17.	<p>فُكِّثَ</p>	<p>Askush nuk e ka lexuar</p>	<p>Të gjithë njëzëri kanë pohuar se kjo fjalë në ajetin kur'anor 106, nga</p>

	<i>Mukth</i>	mekth dhe as mikth	kaptina Isra: “وَقُرْآنًا فَرَقْنَاهُ لِتَقْرَأَهُ عَلَى النَّاسِ عَلَىٰ تَنْزِيلًا” ¹ , lexohet duke vokalizuar germën <i>mim</i> me zanoren u dhe duke mos vokalizuar germën <i>kaf</i> fare. Gjuhësisht kjo fjalë mund të lexohet në tre variante: <i>mukth</i> , <i>mekth</i> dhe <i>mikth</i> , sepse resmi e jep një mundësi të tillë, por përderisa nuk ka tekst që e vërteton një gjë të tillë, atëherë ajo lexohet vetëm sipas variantit të parë: <i>mukth</i> .
18.	الرِّضَاعَةُ <i>Rreda'ah</i>	¹ الرِّضَاعَةُ <i>Rrida'ah</i>	Germa r në fillim të fjalës reda'ah lexohet e vokalizuar me e dhe me i, por lexuesit janë pajtuar ta lexojnë vetëm me e për shkak se kështu përcillet. Fjala është për ajetin 233 nga kaptina bekare: “وَالْوَالِدَاتُ يُرْضِعْنَ” ² . “أَوْلَادَهُنَّ حَوْلَيْنِ كَامِلَيْنِ لِمَنْ أَرَادَ أَنْ يُنِمَّ الرِّضَاعَةَ”.
19.	² وَصَّى <i>Vessá</i>	أَوْصَى <i>Evsá</i>	Gjuhësisht mund të lexohet në dy varianta: <i>juvessikum</i> (يُوصِيكُمْ) dhe <i>jevsikum</i> (يُوصِيكُمْ). Të dyja këto forma janë përmendur në Kur'an. E para është në kaptinën bekare, ajeti 132: “وَوَصَّىٰ بِهَا إِبْرَاهِيمُ بَنِيهِ وَيَعْقُوبُ يَا بَنِيَّ إِنَّ اللَّهَ اصْطَفَىٰ

¹ Xharodi dhe Ebu Rexha e kanë lexuar duke e vokalizuar germën *ru* me zanoren *i*. Nga Muxhahidi përcillet se ai e ka lexuar *rredeah* (رِضَاعَةُ). Shih: El-Kadi, *El-kiraat esh-shadbeh ve texhibuha fi lugati el-arab*, f. 36.

² “*Ve vessá*” –Nafiu, Ebu Xhaferi, Shamiu e kanë lexuar *ensa* përderisa të tjerët e kanë lexuar pa elif por duke e dyfishuar germën sad, pra *vessa*. El-Kadi, *El-budur ez-zahire fi-l-kiraat el-ashere el-mutevatire*, 1/40.

			<p>”لَكُمْ الدِّينَ فَلَا تَمُوتُنَّ إِلَّا وَأَنْتُمْ مُسْلِمُونَ“ lexuar edhe ndryshe: <i>evsa</i> (وأوصى بها) (إبراهيم بنيه ويعقوب).</p>
<p>Fjalë tjera në Kur’anin Fisnik, me të cilat disa kurra kanë vepruar ndryshe nga të gjithë mus’haët osmanë vetëm e vetëm për t’i qëndruar besnikë transmetimet dhe për ta ndjekur sunnetin.</p>			
20.	<p>الصِّرَاطِ <i>Sirat</i></p>	<p>السِّرَاطِ <i>Sirat</i>¹</p>	<p>Kështu qëndron në kaptinat: Bekare, ajeti 245²: “وَاللَّهُ يَفِضُّ وَيَبْسُطُ وَإِلَيْهِ تُرْجَعُونَ” A’rafë, ajeti 69: “وَرَادَكُمْ فِي الْخَلْقِ بَسْطَةٌ” Tur, ajeti 37: “أَمْ عِنْدَهُمْ خَزَائِنُ رَيْكَ أَمْ هُمْ الْمَصِيطِرُونَ” Gashijeh, ajeti 22: “لَسْتَ عَلَيْهِمْ مُصِيطِرٌ” Në të gjithë mus’hafët osmanë këto fjalë janë shkruar me germën <i>sád</i> ndërsa janë lexuar nga disa kurra me germën <i>sín</i>, sepse janë të transmetuara me tekste të sakta.</p>
21.			<p>Kjo fjalë është përmendur në disa vende në Kur’an, si:</p>

¹ Siç shqiptohet fjala Abduladhim në të folmen popullore (Abdulazim), pra nëse shqiptohet ashtu i bie që germa *sad* të shndërrohet në *şaj*.

² “*Jebсуту*” –Nafiu, Bezzi, Shu’beja, Kesaiu, Revhi dhe Ebu Xhaferi e kanë lexuar me germën *sad* ndërsa Kanbeli, Ebu Amri, Hishami, Hafsi, Ruvejsi dhe Halefi nga Hamza e kanë lexuar me *sin*. Ibën Dhekvani dhe Haladi e kanë lexuar me të dyja gerrat, *sad* dhe *sin*. El-Kadi, *El-budur ezşahire fi-l-kiraat el-ashere el-mutevatire*, 1/52.

	ثمود ¹ <i>Themud</i>		Hud, ajeti 68: أَلَا إِنَّ ثَمُودَ كَفَرُوا رَبَّهُمْ ۗ أَلَا بُعْدًا لِثَمُودَ
			Furkan, ajeti 38: وَعَادًا وَثَمُودَ وَأَصْحَابَ الرَّسِّ
			Ankebut, ajeti 38: وَعَادًا وَثَمُودَ وَقَدْ تَبَيَّنَ لَكُمْ مِّنْ مَّسَاكِينِهِمْ
			Nexhm, ajeti 51: وَثَمُودَ فَمَا أَتْبَقَىٰ
			Në të gjithë mus'hafët osmanë kjo fjalë pas shkronjës <i>dal</i> është shkruar edhe me <i>elif</i> por megjithatë lexuesit, duke e ndjekur sunnetin, e kanë lexuar pa të.
22.	الْأَيْكَةَ ² <i>El-ejkeh</i>	لَيْكَةَ <i>Lejkeh</i>	Në të gjithë mus'hafët figuron pa <i>elif</i> para germës <i>lam</i> (lejkeh - لَيْكَةَ), si p.sh., në kaptina shuara, ajeti 176 “كَذَّبَ أَصْحَابُ الْأَيْكَةِ الْمُرْسَلِينَ” dhe sad, ajeti 13: “وَثَمُودَ وَقَوْمَ لُوطٍ وَأَصْحَابَ الْأَيْكَةِ ۗ أُولَٰئِكَ ۗ الْأَخْرَابُ” Disa lexues e kanë lexuar duke fshirë hemzen lidhëse para germës <i>lam</i> (pra

¹ “*Themud*” –Hafsi, Hamza dhe Ja’kubi e kanë lexuar pa tenvin (dyfishin të zanores) ndërsa të tjerët me tenvin. Këta të fundit janë ndalur tek elifi (pra e kanë lexuar *Themude*) ndërsa ata që nuk e kanë lexuar me tenvin janë ndalur tek germa *dal* (pra e kanë lexuar *Themud*). El-Kadi, *El-budur ez-zahire fi-l-kiraat el-ashere el-mutevatire*, 1/227.

² “*As’habu-l-ejkeh*” –dy mediansit, Nafiu dhe Ebu Xhaferi, si dhe Mekkiu dhe Shamiu, e kanë lexuar *Lejkeh* (لَيْكَةَ) ndërsa të tjerët *El-ejkeh*.

		<p><i>lejkeh</i>). Ky lexim është në përputhje me resmin. Ndërsa disa të tjerë e kanë lexuar duke e lidhur hemzen dhe duke mos e vokalizuar germën lam, siç qëndron p.sh., në kaptinat hixhër, ajeti 78: “ وَإِنْ كَانَ أَصْحَابُ الْأَيْكَةِ ” وَأَصْحَابُ الْأَيْكَةِ ” dhe kaf, ajeti 14: “ وَقَوْمٌ يُبْعِ كُلُّ كَذَّبِ الرُّسُلِ فَحَقَّ وَعِيدِ ”</p> <p>Ky lloj leximi nuk përputhet me asnjë resm, por me tekst mutevatir është vërtetuar në këto dy vende.</p>
--	--	--

Transmetimet mutevatire dhe tekstet me senede të sakta janë referencë e kiraeteve, jo resmi dhe shkrimi.

Pas llogaritjes së këtyre fjalëve kur'anore me lexime të ndryshme dhe pas shqyrtimit e analizimit të tyre si dhe pas vërtetimit të burimit të tyre hyjnor, dr. Abdul Fettah Kadiu bën një përmbyllje, e cila në vete paraqet një kundërpërgjigje të fuqishme shkencore ndaj shpifjeve dhe akuzave të Goldziehrit dhe të ngjashmëve me të: “Pas kësaj që shpjeguar na bëhet e qartë se kiraetet e ndryshme nuk janë produkt i harresës për të vokalizuar apo pikëzuar germat, porse e tërë çështja ka të bëjë me transmetimet mutevatire, tekstet e sakta dhe senedet e fuqishme, duke mos i lënë absolutisht asfare hapësire këtu resmit dhe shkrimit...”¹

Ky është mbase argumenti më i fuqishëm se mbështetja për kiraete bëhet në transmetime e citate fetare, jo në shkrim e

¹ El-Kadi, *El-kiraat fi nadhari el-musteshbrikine ve el-mulhidine*, f. 52-82.

resm, siç pretendonte Goldziheri, ndryshe, po të ishin dallimet në kiraete produkt i këtyre të fundit kuratë nuk do të dallonin në lexim në këto vende. Së këndejmi, e tërë kjo tregon fuqishëm se mbështetja për vërtetimin e kiraeteve bëhet vetëm në transmetime të sakta dhe jo në gjëra tjera. Kjo ua bën të qartë të gjithëve, atyre që dinë e atyre që nuk dinë, se lexuesit nuk i kanë duart e lira të veprojnë si të duan në leximet e Kur'anit, pasi ata duhet ta ndjekin atë, të përcillet besnikërisht nga gjeneratat e para. Analogjia, siç ka thënë Imam Shatibiu, nuk ka asfarë qasje në kiraete¹. Bëhet fjalë për saktësi, përpikëri dhe besnikëri të transmetuesve në pranimin dhe përcjelljen e kiraeteve, ose ashtu siç ka thënë dr. Abdul Fettah Kadiu: "...janë tekstet dhe transmetimet ato që paraqesin bazën referuese të kiraeteve, ndërsa mosvokalizimi i mus'hafit nuk ka asnjë ndërhyrje në këtë aspekt..."; "burimi i kiraeteve është teukifi², telkini³, marrja (mësimi) dhe dëgjimi."⁴

Dijetarët dhe ekspertët e kiraeteve të gjithë njëzëri kanë deklaruar se burim i tyre janë vetëm transmetimet e sakta dhe përcjellja nga njëri tek brezi tjetër nëpërmjet mësimit direkt nga mësuesit apo dëgjimit prej tyre.

Dr. Abdul Fettah Kadiu ka plotësuar kundërpërgjigjet e tij, me disa referime që ua ka bërë disa prej përgjigjeve që kanë dhënë dijetar të mëdhenj të këtyre fushave, si Imami Ebu Shameh në *Sherhu esh-Shatibijje*, Imami Sehavi nxënësi i Imam Shatibiut, Imami Ebu Ubejd el-Kasim bin Selam, Imam Kurtubiu, Ibën Atijje, Kadi Ebu Bekir bin Ebi Tajjib, Ibën Xhezeriu, Ibën

¹ Shatibiu, *Hirz el-emani*, f. 29.

² Përkufizimi vetëm në atë që është e transmetuar dhe që angazhimi logjik e shkencor i njeriut nuk ka asnjë qasje në të. Përkthyesi.

³ Mësimi, marrja nga të tjerët. Përkthyesi.

⁴ Referenca paraprake, f. 58.

Subki, që të gjithë këta kanë dëshmuar se për kiraete duhet referuar vetëm teksteve dhe transmetime, jo resmit dhe shkrimit.

Edhe gjuhëtarët dhe gramaticientët kanë pohuar njëzëri se vetëm në transmetime të sakta duhet mbështetur për kiraetet.

Duke cituar gjuhëtarët më të mëdhenj, si Ebu Hamzan, Ebu Amër bin Alaun, Imam Kesaiun, dr. Abdul Fettah Kadiu mbështet shpjegimin e vet se kiraetet merren vetëm nga transmetimet për faktin se, krahas konstatimit që i kanë bërë kësaj të vërtete, praktikisht ata nuk janë refuzuar, kiraetet e këtilla edhe atëherë kur ato mund të mos jenë përputhur me rregullat e tyre gjuhësore.

Kundërpërgjigje logjike dhe analitike: i tërë Kur’ani është vërtetuar me tevatur.

Përgjigje tjetër që ofron Shejhu e me të cilën demanton pretendimet e Goldziherit është e Kur’ani, i tëri, është i vërtetuar në mënyrën më të saktë të mundshme – tevatur. Kjo për arsye se nëse Kur’ani, si tërësi, është vërtetuar me tevatur, atëherë dhe pjesët e tij janë të vërtetuara me tevatur. P.sh., leximi i fjalës *sirat* në dy forma (الصراط والسراط) është vërtetuar me të njëjtën mënyrë kështu që secila prej tyre konsiderohet kur’an. Ndërsa po të konstatojmë se njëri prej leximeve është mutevatir e tjetri jo do të ishte konstatim i gabuar dhe aspak i saktë, do të ishte vlerësim pa kriter dhe rrjedhimisht i gabuar¹.

¹ Referenca paraprake, f. 62.

Dr. Abdul Fettah Kadiu ka thënë tërë atë që mund të thuhet për akuzat e këtij dashakeqi Goldziherit.

Ndërsa po lexonim dhe analizonim përgjigjet e hoxhës sonë, dr. Abdul Fettah Kadiu, bërë akuzave dhe dyshimeve të Goldziherit, betohemi në Zot, nuk kemi gjetur hapësirë e cila nuk është mbuluar sa duhet, dyshim që nuk ka marrë përgjigjen e duhur. Kemi bërë përpjekje të gjejmë ndonjë boshllëk dhe ta mbulojmë me fjalë e shpjegime të dijetarëve tjerë, por nuk kemi gjetur. Madje, nuk kemi ditur as çfarë të shtojmë më shumë.

Allahu e mëshiroftë profesorin tonë, hoxhën Mahmud Abdul Halik Xhadu, i cili në Medinën e Pejgamberi ﷺ ndërsa na ligjëronte angazhohej për t'i shpjeguar sa më mirë që ishte e mundur e pastaj në fund thoshte: Nuk ka shpjegim përtej shpjegimeve të hoxhës Abdul Fettah.

Allahu i mëshiroftë që të dy dhe i lartësotë në Xhennet me Kur'an!

Demaskimi i librit të shpifur

Dr. Abdul Fettah Kadiu ka arritur ta shpërfaq personalitetin e vet si dijetar i madh në këtë fushë, kur ka bërë demaskimin e lojës së ndyrë, falsifikimeve, kundërthënieve, pretendimeve dhe transmetimeve të rreme, që Goldziheri ka bërë ndërsa i ka plasuar në librin e vet ato dyshime dhe akuza përkitazi me kiratetet e Kur'anit. Goldziheri shpik terme dhe nocione si “lexuesit besnikë”, të cilëve ua atribuon leximet shadhe apo të refuzuara. Kështu ka bërë kur i është referuar Dahhak bin Muzahimit (vd. 105 h.) për dy lexime, njërin në kaptinën Enbija

(ajeti 112¹) dhe tjetrin në kaptinën Jusuf (ajeti 110²), e të cilat janë shadhe dhe të papranuara. Në Kur'an, siç ka shtuar dr. Abdul Fettah Kadiu, nuk ka lexime bazë dhe lexime dytësore. Me këtë koncept, Goldziherit konsiderohet të ketë shfaqur në të vërtetë fytyrën e tij prej një dinaku e armiku të fshehtë, prirjen e tij ateiste dhe papjekurinë e tij në hulumtim. Kjo për arsye se, sipas leximeve që ka mbështetur, akuzon pejgamberët se kanë gënjyer³. I pastër është Allahu nga të metat që ia mveshin injorantët e zullumqarët!

Në përmbyllje të përgjigjeve që iu dha akuzave të pabaza të Goldziherit, dr. Abdul Fettah Kadiu thotë: “Këtu mbarojmë me kundërpërgjigjet tona ndaj pretendimeve të Goldziherit, përkritazi me kiraetet e publikuara në librin e tij Doktrinat e interpretimit të Islamit. Kjo që kemi shkruar i mjafton çdokujt që e dëshiron të vërtetën dhe angazhohet për të. Falënderuar qoftë Allahu, shpjegimet tona kanë demaskuar qëllimet e ulëta të këtij libri, idetë e tij të marra, mendimet e tij të pabaza dhe qasjet e tij të gabuara. Me ndihmën dhe mirësinë e Allahut, argumentet dhe dëshmitë që kemi ofruar për librin e Goldziherit e shndërrojnë thjeshtë në një përmbledhje broçkullash absolutisht të padobishme. Allahu i madhëruar thotë:

¹ Ajetin “قَالَ رَبِّ احْكُم بِالْحَقِّ” - **O Zoti im, gjyko me drejtësi!**, e kanë lexuar: “رَبِّي أَحْكُم بِالْحَقِّ” - Zoti im, e di më mirë dhe gjykon më mirë me drejtësi.

² Ajetin “وَوَظَنُوا أَنَّهُمْ قَدْ كُذِّبُوا” - (Dhe, kur të dërguarit gati e humbën shpresën) **dhe menduan se do të shpalleshin gënjeshtarë...**” e kanë lexuar: “وَوَظَنُوا أَنَّهُمْ قَدْ كُذِّبُوا” - dhe menduan se ata kanë gënjyer...”

³ El-Kadi, *El-kiraat fi nadhari el-musteshrikine ve el-mulhidine*, f. 82.

﴿ فَأَمَّا الزَّبَدُ فَيَذْهَبُ جُفَاءً ۗ وَأَمَّا مَا يَنْفَعُ النَّاسَ فَيَمْكُثُ فِي الْأَرْضِ ۗ كَذَلِكَ يَضْرِبُ اللَّهُ الْأَمْثَالَ ﴾
﴿١٧﴾

“... Mbeturinat hidhen, ndërsa ajo që u shërben njerëzve mbetet në tokë. Kështu, Allahu i shpjegon shembujt.” [R’ad: 17]

﴿ رَبَّنَا لَا تُرِغْ قُلُوبَنَا بَعْدَ إِذْ هَدَيْتَنَا وَهَبْ لَنَا مِنْ لَدُنْكَ رَحْمَةً ۗ إِنَّكَ أَنْتَ الْوَهَّابُ ﴾ ﴿٨﴾

“O Zoti ynë! Mos lejo që zemrat tona të shmangen (nga e vërteta), pasi na ke udhëzuar në rrugën e drejtë, dhe jepna mëshirë prej Teje; vërtetë, Ti je Dhuruesi i Madh!” [Al Imran: 8]

﴿ يُبَيِّنُ اللَّهُ لَالَّذِينَ آمَنُوا بِالْقَوْلِ الثَّابِتِ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَفِي الْآخِرَةِ ۗ وَيُضِلُّ اللَّهُ الظَّالِمِينَ ۗ وَيَفْعَلُ اللَّهُ مَا يَشَاءُ ﴾ ﴿٢٧﴾

“Allahu i forcon besimtarët me fjalë të qëndrueshme në këtë botë dhe në botën tjetër, kurse keqbërësit i shpie në humbje; Allahu bën ç’të dojë.” [Ibrahim: 27]¹

Allahu e mëshiroftë boxbën dhe imamin tonë, dr. Abdul Fettah Kadiun, për këtë kontribut të çmuar dhe të jashtëzakonshëm që ka bërë! Kur’ani qoftë ndërmjetësues i tij në Ditën e Llogarisë dhe lartësues i tij në Xhennet! Përsëritet qofshin mbi Muhamedin, familjen dhe shokët e tij! Lutja jonë e parë dhe e fundit është: Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve!

¹ Referenca paraprake, f. 201.

PËRFUNDIME

Në përmbyllje të studimit do të përshkruajmë disa prej rezultateve më të spikatura të tij:

- 1) Studimi ka vërtetuar pozitën e lartë dhe meritore të hoxhës dr. Abdul Fettah Kadiut në Shkencën e Kiraeteve të Kur'anit dhe në flakjen e dyshimeve të Goldziherit dhe dashakëqijve të ngjashëm me të. Allahun e lusim, që hoxhën tonë ta shpërblejë me të mira, ashtu siç Ai i shpërblen robërit dhe besimtarët e mirë!
- 2) Studimi ka pasqyruar më së miri personalitetin e shtrembëruesit dhe mashtruesit të profesor Goldziherit. Dëshmi për këtë kemi, përveç tjerash, krahasimin ndërmjet çështjeve të shtruara për diskutim ose thënë më mirë vëllimin e meseleve në të cilat ka hedhur dyshime dhe periudhën e shkurtër të qëndrimit të tij në vendet arabe, gjë që ia pamundëson zotërimin e arabishtes e aq më pak thellimin në të që të mund të del dhe të ngrit çështje madhore për diskutim siç ka bërë.
- 3) Pavarësisht se Goldziherit i ishin bërë të qarta të vërtetat islame, ai kishte vazhduar me qëndrimin e tij armiqësor karshi islamit. Nga kjo perspektivë, studimi ka vënë në pah urrejtjen e madhe të tij ndaj Islamit dhe metodologjinë e shthurur, e devijante në trajtimin e meseleve dhe çështjeve fetare. Goldziheri nuk ndoqi rrugën e të vërtetës. Në vend të kësaj ai zgjodhi t'i pasojë pararendësit e devijuar dhe devijues. Në këtë përfundim kemi arritur duke studiuar terminologjinë dyshuese dhe devijante të përdorur në librin *Doktrinat e interpretimit islam*.

- 4) Kiraetet (leximet) nuk janë çështje alternative dhe as produkt i ixhtihadit njerëzor (punës shkencore). Pra, ato nuk kanë të bëjnë me përzgjedhjen e lexuesit dhe lirinë e tij në pranimin ose refuzimin e tyre.
- 5) Po kështu, as diversiteti i tyre nuk është për shkak të shkrimit dhe formës. Përkundrazi, është sipas sunnetit, shpalljes nga Allahu xh.sh., transmetimit të saktë dhe bartjes gjeneratë pas gjenerate.
- 6) Sigurisht, shpifjet dhe akuzat e orientalistëve e humbin kredibilitetin shkencor përpara këtij realiteti shkencor dhe objektiv të të vërtetave islame, përpara transmetimit të përcjellë me saktësi e besnikëri, përpara senedit të lidhur të transmetuesve deri tek Pejgamberi ﷺ. Studimi me kompetencë ka vërtetuar se dyshimet e Goldziherit nuk janë tjetër pos shpifje të pabaza dhe të pambështetura në asnjë burim të besueshëm.
- 7) Studimi ka konfirmuar angazhimin e pashoq të dr. Abdul Fettah Kadiut në lëmin e studimeve kur'anore, e veçmas në këtë të leximeve, si një pionier dhe autoritet i pakontestueshëm në studimet kur'anore dhe si një mjeshtër i cili përballë një dashakeqi dhe qëllimkeqi arrin ta mbron më së miri fjalën e Zotit.
- 8) Kur'ani është libri që Allahu ia shpalli njerëzimit. Ai vazhdon të ruhet nga Zoti. Sfida e tij, e hapur tash e më shumë se njëmijë vite, vazhdon ende; askush nuk mund të sjellë diç të ngjashme me të e aq më pak ta sfidojë atë. Askush nuk mund ta mohojë saktësinë e tij madje edhe nëse njerëzit dhe xhinët do të bëheshin bashkë për këtë qëllim.
- 9) Studentët e shkencave islame, e veçmas të profilizuarit në studime kur'anore, duhet ta ndjekin këtë metodologji të fuqishme shkencore, të cilën e ka ndjekur hoxha dhe

mësuesi ynë, dijetari dr. Abdul Fettah Kadiu -*Allahu e mëshiroftë!*

- 10) Propozoj që emri i hoxhës dr. Abdul Fettah Kadi, të përjetësohet duke emërtuar institute apo qendra studimore dhe kërkimore, duke i trajnuar studentët sipas metodës së tij si dhe duke bërë librin e tij libër mësimi apo referencë të parë në fakultet të Kur'anit Fisnik. Propozimi ynë është që libri mësimor të thirret *Qëndrimi i orientalistëve karshi kiraeteve të Kur'anit* apo emërtime të ngjashme.

E lusim Allahun e madhëruar që këtë mund tonin ta pranojë si vepër, me të cilën e synojmë kënaqësinë e Tij, ta bëjë të dobishme për studentët dhe hulumtuesit, dhe neve, për çdo gabim a lëshim të na falë e arsyetojë. Përshëndetjet tona me salat e selam ia dërgojmë zotërisë sonë, Muhamedit a.s., familjes dhe shokëve të tij! Lutja jonë e fundit është: Falënderimi i përket Allahut, Zotit të botëve!

BURIMET DHE REFERENCAT

Kur'ani Fisnik.

Kur'ani i madhërishtëm, përktheu kuptimet e tij në shqip Hasan I. Nahi, (Tiranë: Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, 2006).

1. REFERENCAT

1. Al Hamid, Sa'd. *Ehdaf el-istishrak ve vesailuhu*. Universiteti Mbreti Suud.
2. Al Ismail, Nebil bin Muhammed bin Ibrahim. (1419 h.). *Ilm el-kiraat: neshetuhu ve atvaruhu ve etheruhu fi elo-ulum esh-sher'ijeh*. Rijad.
3. Bazemul, Muhammed bin Umer bin Salim. (1996). *El-kiraat ve etheruha fi et-tefsir ve el-abkam*. Rijad: Dar el-hixhreh li-n-neshr ve-t-teuzië.
4. Bejli, Ahmed. *El-ihtilafu bejne el-kiraat*. Berjut: Dar el-xhebel.
5. Benna, Ahmed bin Muhammed. (1987). *It'haf fudalai el-besher bi-l-kiraaat el-erbeati asher*. Bejrut: Mektebetu el-kullijat el-ezherije.
6. Buhari, Muhammed bin Ismail. (1410 h.). *Sahib el-Buhari*. Bot. 3. Bejrut: Dar el-fikr.
7. Daba', Ali Muhammed. *It'haf el-berere bi-l-mutun el-ashere fi el-kiraat ve err-rresm ve el-aj ve et-texhvid*. Egjipt: Matbaatu Mustafa el-Halebi.
8. Ebu el-Ajnejn, Vefa bint Muhamemd Mensur, *Esh-Shejh el-Al-lameh Abdul Fettah bin Abdul Gani el-Kadi ve xhubuduhu fi ed-dirasat el-keur'anije*, (2018). Tezë

- magistrature. Kuala Lumpur: Fakultas Dar el-ulum, Universiteti Ndërkombëtar El-Medina.
9. Ebu Shameh, Abdurrahman bin Ismail bin Ibrhaim. (1990). *Ibraḡ el-emani min hirḡ el-emani fi el-kiraat es-seb'i li el-Imami esh-Sbatibij*. Ver. Mahmud Abdul Halik Xhadu. Medine Munevvere: Universiteti Islamik.
 10. Ebu Shehbeh, Muhammed. (1989). *Difaun an es-Sunneti ve reddu shubehi el-musteshbrikine ve el-kuttab el-muasirine – ve jelibi Err-rreddu ala men junkiru buxh-xbijjete es-sunneh*. Medine Munevvere: Mektebetu es-Sunneh.
 11. El-Fadli, Abdul Hadi. (1985). *El-kiraat el-kur'anije – tarih ve ta'rif*. Bot. 3. Bejrut: Dar el-kalem.
 12. El-Kadi, Abdul Fettah. (1408 h.). *El-kiraat fi nadhri el-musteshbrikine ve el-mulhidine*. Medine Munevvere.
 13. El-Kadi, Abdul Fettah. (1981). *El-budur ezḡahire*. Bejrut: Dar el-kitab el-arabij.
 14. Goldziher, Ignaz. (1992). *Medhabibu et-tefsir el-islamij*. Përktheu: Dr. Abdul Halim Nexhar. Bot. 5. Bejrut: Dar Ikre.
 15. Ibën el-Xhezeri, Ebu el-Hajr Muhammed bin Muhammed bin Muhammed. (1985). *En-nesbru fi el-kiraat el-asbr*. Bot. 2. Dar el-kutub el-ilmije. Bejrut.
 16. Ibën el-Xhezeri, Ebu el-Hajr Muhammed bin Muhammed bin Muhammed. (1999). *Munxhid el-mukri'ine ve murshid et-talibine*. Bot. 1. Dar el-kutub el-ilmije. Bejrut.
 17. Ibën el-Xhezeri, Ebu el-Hajr Muhammed bin Muhammed bin Muhammed. (1994). *Metnu Tibeti-n-nesbr fi el-kira'at el-asbr*. Përgatiti për botim: Muhammed Temim Za'bi. Bot. 1. Mektebetu el-Huda. Medine Munevvere.
 18. Ibën Halevejhi, *Mubtesar fi shevadhi el-Kur'an min kita bel-bide'*, Mektebetu el-Mutenebbi, Kajro.

19. Ismail, Sha'ban Muhammed. (1992). *El-kiraat – ahkamuha ve mesadiruha*. Mekke Mukerreme.
20. Kattan, Mennaë. (1991). *Nuzul el-Kur'an ala seb'ati ahruf*. Mektebetu Vehbe.
21. Masravi, Ahmed Isa. (2006). *El-kiraat el-varideh fi es-sunneh*. Kajro: Dar es-salam.
22. Mersafi, Abdul Fettah Axhemi. (1400 h.). *Hidajetu-l-kari'i ila texhvidi kelami el-Bari*. Bot. 2. Medine Munevvere: Mektebetu Tajjibe.
23. Muabbir, Semir bin Jahja. (2005). *Nedharat fi Ilmi el-kiraat*. Bot. 2. Xhidde: Dar Hafidh.
24. Muhajsin, Muhammed Salim. (1978). *El-muhedheb fi el-kiraat el-sbr ve tevxbihuha*. Dar en-nevadir, Mektebetu el-kul-lijat el-ez'herije.
25. Mukrim, Abdul Al Salim dhe të tjerë. *Mu'xbem el-kiraat el-kur'anije*.
26. Musa, Abdurrezzak Ali Ibrahim. (1989). *Sherbu el-Imam ez-Zubejdi ala metni ed-durreh fi el-kiraat eth-thelathe el-mutemmieh li-l-ashreb*. Bejrut: El-mektebetu el-asrije.
27. Nejsaburi, Muslim bin Haxhaxh. (2006). *Sabihu Muslim bi sherhi en-Nevevi*. Bot. 2. Dar el-fikër.
28. Rraxhihi, Abduhu. (1999). *El-lehexhat el-arabije fi-l-kiraat el-kur'anije*. Rijad: Mektebetu el-mearif.
29. Sasi, Salim el-Haxh. (2002). *Nakd el-hitab el-istishrakij: edh-dhahiretu el-istishrakijetu ve etheruha fi eddirasat el-kur'anijeh*. Bengazi: Dar el-medar el-islamij.
30. Shatibi, Kasim. (1990). *Metnu esh-shatibije hirz el-emani ve vexhb ettehani fi el-kiraat es-seb'i*. Medine Munevvere: Dar el-matbuat el-hadithe.
31. Sixhistani, Ebu Bekir Abdullah bin Ebi Davud Sulejman bin Esh'ath. (1936). *Kitab el-mesabif*. Ver. Arthur Xhaferi. Egjipt: El-matbaatu err-rrahmanije.
32. Taberi, Muhammed bin Xherir. (1420 h.). *Xhamiu el-bejan fi te'vili aji el-Kur'an*. Mektebetu el-ulum ve el-hikem.

33. Taviil, Sejjid Rizk. (1985). *Fi ulumi el-kiraat – med’halun ve dirasetun ve tahkik*. Mekke: El-mektebetu el-fejsaliye.
34. Vezan, Adnan Muhammed. (1404 h.). *El-istisbrak ve el-musteshbriku, vixhbetu nadhr*. Rabitatu el-alem el-islamij, nr. 24, v. 3.
35. Xhebel, Muhammed Hasan Hasan. (2002). *Err-rreddu ala el-musteshbriki el-jebudij Goldziber fi metainihi ala el-kiraat el-keur’anijeh*. Bot. 2. Universiteti i Az’harit: Kul-lijetu el-Kur’ani el-Kerim.
36. Zakzuk, Mahmud Hamdi. (1404 h.). *El-istisbrak ve el-halfijetu el-fikrijeh li essirai el-hadarij*. Katar: Kitab el-ummeh.
37. Zerkeshiu, Bedruddin Muhammed bin Abdullah. (1983). *El-burhan fi ulumi el-Kur’an*.
38. Revista Dija, Arabi Saudite, nr. 9, Shaban 1433 – qershor 2012.
39. Revista e Fakultetit të Kur’anit Fisnik dhe Studimeve Islame në Universitetin islamik në Medinë, nr. 1, v. 1403 h.

4. Portale

www.mediu.edu.my

<http://ojs.mediu.edu.my/index.php/IISJ/article/view/1903>

<https://www.youtube.com/watch?v=sCdnVw3xbrA>

<http://www.uqu.edu.sa>

<https://shatiby.edu.sa/afk-all/>

<https://www.haaretz.com/jewish/.premium-this-day-islamic-studies-pioneer-dies>